

1 E hënë, 25 nëntor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar i
6 seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Faleminderit, të nderuar
11 Gjykatës.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
13 procesverbal, të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në
14 sallë sot.

15 Përpara sesa të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit të
16 Prokurorisë 03873, ka disa çështje paraprake që Trupi Gjykses
17 dëshiron t'i trajtojë.

18 Së pari, më 18 nëntor 2024, Mbrojtësi për z. Veseli
19 kërkoi që një pjesë e transkriptit të Dëshmitarit 04679 që
20 është dëgjuar në seancë private dhe që kishte të bënte me
21 Dëshmitarin 03873 të klasifikohet si publik. Trupi Gjykses
22 pajtohet që pjesët përkatëse mund të riklasifikohen si
23 publike. Kështu që, urdhëron që pjesët përkatëse të provës
24 P22340, rreshti 1, deri në faqen 22343, rreshti 15 i
25 transkriptit të datës 18 nëntor që janë në seancë private të

1 mund të klasifikohen si publike.

2 Ky përfundon urdhrin gojor të Trupit Gjykses.

3 Së dyti, Ekipi i Mbrojtjes së Thaçit kundërshton
4 pranueshmërinë e disa dokumenteve që Prokuroria dëshiron që të
5 përdorë me Dëshmitarin 03873, me arsyetimin që ato janë
6 paragjykuese dhe efekti paragjykues dhe cenues i tyre e zhbën
7 relevancën ose vlerën provuese të tyre: Materiali vjen nga një
8 libër që ka informacion që lidhet me Dëshmitarin 04583 dhe për
9 këtë ZPS-ja ka nxjerrë nga lista e dëshmitarëve të vet, sa i
10 takon përmbajtjes së këtij libri dhe është objekt i një
11 mocioni për të cilin ende nuk është se ka marrë, nuk ka marrë
12 vendim Trupi Gjykses.

13 ZPS-ja përgjigjet që nuk ka arsye që pse të mos pranohet
14 dhe të mos përdoren faqe të këtij libri me këtë dëshmitar dhe
15 kërkon që të pranohen fragmentet përkatëse nga SITF00245112
16 deri në 00245115 përmes Dëshmitarit 03873 në qoftë se
17 përmbushen kriteret e rregullës 138: Autori i SITF00245112 dhe
18 00245415 nuk është Dëshmitari 04583, por është Bedri Islami,
19 po ashtu procesi që është ndjekur më përpara është rutinë në
20 kuptimin që përderisa dëshmitarët nuk do të thërriten
21 drejtpërdrejt për të dhënë dëshmi përpara Trupit Gjykses
22 atëherë informacioni mund të nxirret përmes dëshmitarëve të
23 thirrur prej Prokurorisë sipas kriterëve të rregullës 138, po
24 ashtu, Dëshmitari 03873 do të flasë sa i takon lidhjes
25 ndërmjet LPK-së dhe KLA-së.

1 Pasi ka trajtuar parashtrimet e Mbrojtjes së z. Thaçi,
2 Trupi Gjykses e kundërshton kundërshtimin e Mbrojtje së
3 Thaçit. Më konkretisht, Trupi Gjykses kujton se pranueshmëria
4 e provave të propozuara parashikohet nga rregulli 138. Në këtë
5 aspekt, Trupi Gjykses vëren se librat dhe artikujt mund të
6 pranohen pa nevojën e autorëve të tyre që të vijnë dhe që të
7 japin dëshmi në qoftë se përmbushen kriteret *prima facie* sipas
8 rregullës 138.

9 Për rrjedhojë Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja mund të
10 përdorë dokumentet me këtë dëshmitar dhe pranueshmëria e
11 këtyre faqeve do të trajtohet më vonë në momentin kur ato të
12 paraqiten për pranim në prova gjyqësore.

13 Ky është fundi i urdhrorit të dytë gojor të Trupit Gjykses.

14 Z. Sekretar i seancës, ju lutem, na kaloni në seancë
15 private.

16 [Seancë private]

17 [Seancë private teksti i fshirë]

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25 [Seancë e hapur]

1 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
2 jemi në seancë publike.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
4 Tani do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të
5 Prokurorisë 03873.

6 Znj. Asistente, ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.
7 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
9 Dëshmitar. Mirëmëngjesi, Dëshmitar. A e dëgjoni përkthimin,
10 Dëshmitar?

11 DËSHMITARI: Po. Po, e dëgjoj.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
13 procesverbal, dua të them që Mbrojtësi Kujdestar është i
14 pranishëm, është Mbrojtësi Kujdestar i Dëshmitarit 03873.

15 Ju lutem, Avokat, prezantohuni për procesverbal.

16 Z. KOCI: Mirëmëngjes, të gjithëve. Unë jam Arianit Koci,
17 avokat nga Prishtina.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
19 z. Koci.

20 Z. KOCI: [Përkthim] Mirëmëngjes, të gjithëve. Unë jam
21 avokati nga Prishtina.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
23 Asistentja ose Sekretarja jonë do t'ju japë tekstin e
24 deklaratës solemne që duhet të lexoni. Ju lutem lexojeni
25 deklaratën që është betimi solemn me zë për të gjithë ne.

1 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime
2 dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të
3 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe
4 nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

5 DËSHMITARI: HALIL QADRAKU

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
7 Dëshmitar. Tani mund të uleni.

8 Z. Koci, do kaloj disa materiale paraprake më herët dhe
9 pastaj do të thoni juve se cilat janë arsyet pse jeni në
10 sallën e gjyqit sot.

11 Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj që
12 parashikohet që të zgjasë dy deri në tre ditë. Sikurse mund ta
13 dini, e para do t'ju bëj pyetje Prokuroria. Pas Prokurorisë,
14 Ekipet e Mbrojtjes kanë të drejtë që t'ju bëjnë pyetje, po
15 ashtu edhe anëtarë të Trupit Gjykses, të cilët mund të kenë
16 pyetje për ju.

17 Prokuroria ka vlerësuar se i duhen katër orë për t'ju
18 marrë në pyetje. Ekipet e Mbrojtjes kanë vlerësuar që ju duhen
19 rreth 7.5 orë. Si në rastet e tjera për vlerësime të ngjashme,
20 neve shpresojmë që ekipet do të përdorin me efikasitet kohën e
21 tyre. Trupi Gjykses do të lejojë pyetje plotësuese në qoftë se
22 përmbushen kriteret për këtë gjë.

23 Dëshmitar, ju lutem përgjigjuni pyetjeve me fjali të
24 shkurtra dhe të qarta. Në qoftë se nuk e kuptoni një pyetje,
25 lirisht mund t'i tregoni palës përkatëse që ta përsërisë dhe

1 një herë pyetjen ose ta shpjegoj më tej atë për ju. Po ashtu,
2 ju lutem na thoni se cila është baza e njohurive, fakteve dhe
3 rrethanave për të cilat do të pyeteni.

4 Në rast se Prokuroria ju kërkon që të vërtetoni dhe të
5 thoni që janë të drejta disa korigjime dhe disa saktësime që
6 keni bërë në deklaratat e mëhershme, ju lutem, bëjeni këtë
7 gjë.

8 Flisni pranë mikrofonit, bëni një pauzë prej pesë
9 sekondash përpara se të t'i jepni përgjigje pyetjes dhe flisni
10 me një ritëm të ngadaltë për hir të përkthyesve.

11 Gjatë ditëve kur do të jepni dëshmi në sallën e gjyqit,
12 nuk lejoheni që të flisni me askënd lidhur me përmbajtjen e
13 dëshmisë suaj jashtë sallës së gjyqit. Në qoftë se ndonjë
14 person vjen për t'ju bërë pyetje lidhur me dëshminë nga jashtë
15 sallës së gjyqit, këtë duhet të na e bëni me dije menjëherë.

16 Në qoftë se ju kërkoj që të ndërprisni së foluri, duhet
17 të ndërprisni së foluri, në qoftë se më shikon që unë kam
18 ngritur dorën po ashtu duhet të mos flisni më. Sepse kjo do të
19 thotë që duhet t'ju jap disa udhëzime.

20 Në qoftë se vlerësoni se keni nevojë për pushime, mund të
21 na e thoni këtë gjë e dhe ne do të bëjmë organizimet e
22 nevojshme.

23 Ne e dimë që keni një avokat kujdestar dhe në qoftë se
24 avokati që është caktuar ka shqetësim për sa i takon
25 vetinkriminimit, ai do t'ju japë këshillat e nevojshme.

1 Dëshmitar, dua t'ju kujtoj se në pajtim me betimin solemn
2 që sapo lexuat, ju jeni të detyruar që të thoni të vërtetën.
3 Sipas rregullave tona, rregullores tonë, ju këshilloheni që të
4 mos i përgjigjeni pyetjeve të cilat ju fajësojnë ose ju
5 inkriminojnë ju dhe deri në momentin që Trupi Gjykses ju
6 detyron që të jepni përgjigje këtyre pyetjeve. Kjo është në
7 pajtim me rregullën 151(2) i rregullave tona dhe ne do t'ju
8 japim garancitë e nevojshme sipas këtij rregulli.

9 Z. Koci, ju dhe klienti juaj a keni pas mundësi që të
10 diskutoni çështjen e vetinkriminimit në dëshminë e tij që do
11 filloj tani përnjëherë?

12 Z. KOCI: [Përkthim] Po.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A kërkon
14 garanci siç parashikohet në rregullën 151(3) i Rregullores
15 tonë?

16 Z. KOCI: [Përkthim] Po.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ia keni
18 shpjeguar këtë situatë klientit?

19 Z. KOCI: [Përkthim] Po.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A i keni
21 shpjeguar klientit tuaj që në qoftë se ne e miratojmë këtë
22 garanci, ai më pas duhet që të japë përgjigje për të gjitha
23 pyetjet?

24 Z. KOCI: [Përkthim] Po.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ju

1 kujtoj që këtu duhet të jepni dëshmi dhe të thoni të vërtetën.
2 Në qoftë se nuk thoni të vërtetën, mund të merren masa ndaj
3 jush. Por sikurse e thashë edhe më përpara, në qoftë se ju
4 besoni se një përgjigje ndaj një pyetjeje të caktuar ju
5 inkriminon ose ju fajëson ju, atëherë mund të konsultoheni me
6 avokatin. Në qoftë se urdhëroheni nga Trupi Gjykses për t'ju
7 përgjigjur pyetjeve, pasi të merrni garancitë përkatëse, ju
8 jeni të detyruar që t'i përgjigjeni pyetjeve. Në qoftë se nuk
9 i përgjigjeni pyetjeve pasi udhëzoheni për ta bërë këtë nga
10 Trupi Gjykses, atëherë mund të merren masa ndaj jush.

11 Juve ju kanë caktuar një avokat Trupi Gjykses dhe dua
12 t'ju pyes, Dëshmitar, në qoftë se keni marrë këshillim të
13 plotë ligjor nga avokati juaj, nga Z. Koci? A jeni konsultuar
14 dhe a keni marrë këshillim të plotë nga z. Koci, Dëshmitar?

15 DËSHMITARI: Po.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Avokati juaj
17 ka thënë që ju kërkon garanci sipas rregullës 151.

18 Trupi Gjykses vëren se në parashtrimin konfidencial
19 F02715, ZPS-ja ka informuar Trupin Gjykses sepse nëse mendohet
20 e domosdoshme nga Trupi Gjykses, ZPS-ja nuk ka kundërshtim që
21 ju t'ju miratohen garancitë në pajtim me Rregulloren tonë, më
22 konkretisht me rregullën 151(20 dhe (3) i kësaj Rregulloreje.
23 Për rrjedhojë, Trupi Gjykses nuk do të kërkojë pikëpamjet ex
24 parte të Prokurorisë së Specializuar sipas rregullës 151(3)
25 dhe nuk i konsideron ato si të domosdoshme për të dhënë

1 vendim.

2 Megjithatë, Trupi Gjykues kërkon parashtrime nga ZPS-ja
3 lidhur me mënyrën se si dhe nëse dëshmitë që dëshmitari do të
4 japë dhe që mund të detyrohet që të japë janë dëshmi unike në
5 pajtim me rregullën 151(2)(b).

6 Z. PACE: [Përkthim] Shkurtimisht dhe sa për shembull, sa
7 i takon arsyeve të pyetjes për së cilat juve pyetët, përfshirë
8 këtu, domethënë, dëshmitari do të japë dëshmi sa i takon
9 periudhës sa i takon janarin e 1999-s që ka qenë pjesë e
10 sektorit G2 në Zonën Operative të Pashtrikut, ne mendojmë që
11 dëshmia e tij është unike dhe ka rëndësi shumë të madhe.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtjet
13 kanë ndonjë koment për të bërë lidhur me këtë?

14 Z. Koci, a keni ndonjë korrigjim për të bërë sa i takon
15 pozicionit tuaj dhe këshillimit që i keni bërë klientit tuaj?

16 Z. KOZI: Për momentin, jo, Gjykatës të nderuar. Jo, nuk
17 kam. Faleminderit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pasi dëgjuam
19 parashtrimet e palëve, përfshirë këtu edhe pikëpamjet e ZPS-së
20 në parashtrimin F02715, Trupi Gjykues konstaton se, duke marrë
21 parasysh rëndësinë e dëshmisë së parashikuar të dëshmitarit,
22 si dhe relevancën unike për këtë çështje gjyqësore, si dhe
23 natyrën e kufizuar të mundësisë për vetinkriminim dhe sa i
24 takon masave mbrojtëse të disponueshme të cilat konsiderohen
25 të domosdoshme, elementët e renditur në rregullën 151(2)

1 përmbushen.

2 Kështu që si rezultat Trupi Gjykues e detyron dëshmitarin
3 të japë dëshmi.

4 Në pajtim me rregullën 151(3), Trupi Gjykues e siguron
5 dëshmitarin që dëshmia e dhënë në përgjigje të pyetjeve
6 përkatëse:

7 “(b) nuk do përdoret as në mënyrë të drejtpërdrejtë as në
8 mënyrë të tërthortë ndaj një personi të caktuar si dhe nuk do
9 të përdoret për asnjë arsye tjetër përveç arsyeve të cilat
10 parashikohen në nenin 15(2) të ligjit edhe rregullit 65.”

11 Në këtë aspekt, Trupi Gjykues e paralajmëron dëshmitarin
12 që refuzimi për të dhënë dëshmi mund të sanksionohet me një
13 gjobë.

14 Tani do të kalojmë në seancë të mbyllur, çfarë do të
15 thotë që nuk do transmetohet përmbajtja e dëshmisë së
16 dëshmitarit për asnjë nga palët.

17 Z. Koci, a dëshiron këtë dëshmitari apo klienti juaj?

18 Z. KOCI: Gjykatë e nderuar, nëse më lejoni, kisha pas
19 nevojë një minutë me bisedu me klientin tim.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër.
21 Patjetër mund ta bëni këtë.

22 [Avokati i caktuar kryesisht dhe dëshmitari
23 këshillohen]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, z.
25 Koci.

1 Z. KOÇI: [Përkthim] Gjykatë e nderuar, instruksionet i
2 kam të qarta prej klientit. Klienti po dëshiron që të shkojmë
3 në seancë të hapur apo seancë publike, nëse është e mundshme.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A e di
5 klienti që kjo do të përcillet dhe do ta ndjekin të gjithë, i
6 gjithë publiku do ta ndjekë dëshminë e tij?

7 Z. KOÇI: [Përkthim] Po. Po. Të gjitha ia kam spjegue dhe
8 më herët dhe sot. Kështu që ne kërkojmë që të shkojmë në
9 seancë të hapur.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A e kuptoni
11 plotësisht këtë, Dëshmitar? Dëshmitar, e kuptoni këtë që sapo
12 u tha?

13 DËSHMITARI: Po, e kuptoj.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
15 Atëherë do të vazhdojmë në seancë të hapur.

16 Z. Pace, mund të filloni me pyetjet për dëshmitarin.

17 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

18 Pyetje nga z. Pace:

19 Z. PACE: [Përkthim]

20 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar.

21 PË. Mirëmëngjes.

22 PY. Jemi takuar bashkë dhe më herët, megjithatë për
23 procesverbal do të prezantohem dhe një herë. Jam James Pace,
24 jam prokuror me ZPS-në. Sikurse e tha dhe Gjykatësi Smith, unë
25 do t'ju bëj pyetje në orët në vijim.

1 Përpara sesa t'ju pyes për disa hollësi personale, ashtu
2 siç ju kemi shpjeguar dhe në seancën përgatitore, në vend që
3 t'ju bëjmë pyetje për çdo çështje që trajtohet në deklaratat
4 tuaja dhe për të cilat ju mund të keni informacion, është e
5 mundur që të pranohen si prova gjyqësore disa prej deklaratave
6 tuaja të mëhershme. Për ta bërë këtë gjë, duhet që të
7 përmbushen disa hapa proceduralë të cilët unë do t'i përmbushë
8 pasi të kemi konstatuar hollësitë tuaja.

9 Si e keni emrin dhe mbiemrin, Dëshmitar?

10 PË. Unë quhem Halil Qadraku.

11 PY. A keni pasur ndonjë nofkë në vitin 1998 apo në vitin
12 1999?

13 PË. Nofka ime ishte Fatosi.

14 PY. Kur keni lindur ose cila është ditëlindja juaj?

15 PË. Unë kam lindur më 15 korrik 1964 në Sarajevë.

16 PY. Çfarë shtetësie keni ose çfarë, domethënë, në njëjës apo
17 në shumës, një shtetësi apo disa shtetësi?

18 PË. Unë e kam vetëm një shtetësi dhe atë kosovar, shqiptar
19 nga Kosova.

20 Z. PACE: [Përkthim] Dëshiroj që të paraqitet në ekran
21 dokumenti 000970955-TR-AT, Pjesa 1 E Rishikuar 1 dhe përbri të
22 vendoset edhe versioni në shqip. Këto dy dokumente do kërkoja
23 që të paraqiten në ekran.

24 PY. Dëshmitar, faleminderit. Në ekran besoj që keni dy
25 dokumente, apo jo, në të majtë është një dokument në shqip dhe

1 në të djathtë është një dokument në anglisht. A mund të
2 konfirmoni që keni këto dy dokumente në ekranin përpara jush,
3 Dëshmitar?

4 PË. Po.

5 PY. Dokumentet janë intervista juaj me ZPS-në në dhjetor të
6 vitit 2019. A ju kujtohet që jeni takuar me ZPS-në në dhjetor
7 të 2019?

8 PË. Po, më kujtohet.

9 Z. PACE: [Përkthim] Për procesverbal, dua të them që kjo
10 është një intervistë e cila ka gjashtë pjesë. Për momentin ta
11 heqim nga ekrani intervistën.

12 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet që javët e fundit ju është dhënë
13 mundësia që të rishikoni deklaratat e mëhershme dhe të jepni
14 sqarime dhe të bëni korrigjime, përfshirë këtu edhe dëshminë
15 që i keni dhënë ZPS-së në dhjetor të vitit 2019.

16 PË. Po.

17 PY. A ju kujtohet që ju bëtë disa sqarime të intervistës që
18 keni dhënë për Prokurorinë?

19 PË. Më kujtohen disa.

20 PY. A mbani mend që këto sqarimet dhe korrigjimet që bëtë ju
21 i hodhëm në një shënim dhe atë shënimin më pas ua lexuam
22 sërish ju?

23 PË. Po.

24 PY. Tani duke marrë parasysh korrigjimet që u hodhën tek ai
25 shënimi, përmbajtja e intervistës suaj për Prokurorinë, a

1 është e saktë dhe e vërtetë me aq sa besoni dhe keni ju
2 dijeni?

3 PË. Përmbajtja e asaj që lexuam në përfundim të atyre
4 procedurave, unë i kam nënshkruar dhe i pranoj si të miat.

5 PY. Që ta sqarojmë, sa i takon atij shënimit sepse shënimin e
6 kam nënshkruar vetëm unë, që të mos kemi konfuzion.

7 Sidoqoftë po vazhdojmë. Tani duke marrë parasysh
8 korrigjimet në atë shënim, intervista që dhatë ju për ZPS-në a
9 pasqyron saktësisht dëshminë tuaj lidhur me ngjarjet që janë
10 pasqyruar në të ose që janë hedhur në të?

11 PË. Për mendimin tim po, nga ana ime.

12 Z. PACE: [Përkthim] Kërkoj pranimin e gjashtë pjesëve të
13 intervistës me ZPS-në dhe provave materiale shoqëruese, ERN
14 përkatëse të cilave i kemi hedhur në Shtojcën 1 të Shënimit
15 Përgatitor 1. Kërkojmë po ashtu pranimin e Shënimit Përgatitor
16 numër 1 që mban numrin 123823-123831. Dhe sikurse ua shpjegova
17 në shënimin përgatitor në një post elektronike pak më herët,
18 vërej se Pjesa 1 e intervistës së ZPS-së, pra, versioni që ne
19 kërkojmë të pranohet është versioni që ka një korrigjim
20 përkthimi.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
22 kundërshtim?

23 PËRKTHYESJA: Ekipet e mbrojtjes nuk kanë kundërshtime.

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Përveç kundërshtimeve që kemi
25 paraqitur më herët, nuk kemi kundërshtime të tjera.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

2 Materiali 070955-TR-ET, gjashtë pjesët përkatëse, REV RED

3 bashkë me përkthimin në gjuhën shqipe, pranohet.

4 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

5 numrat që u lexuan për procesverbal e më konkretisht Pjesa 1

6 që ka korrigjim dhe mban numrin 070955-TR-ET Pjesa 1 *Revised 1*

7 Korrigjuar Përkthimi RED, do të marrë numrin e provës

8 materiale P01854.1 si në shqip dhe anglisht. Pjesa 2, në të

9 dyja gjuhët, do të marri numrin e provës P01854.2. Pjesa 3 do

10 të marri numrin e provës P01854.3. Pjesa 4 do të marrë numrin

11 e njëjtë po me prapashtesën .4. Pjesa 5 me prapashtesën .5.

12 Pjesa 6 me të njëjtin numër dhe prapashtesën .6. Kjo vlen për

13 të dyja gjuhët dhe klasifikimi i materialeve është

14 konfidencial.

15 Faleminderit.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

17 Shënimi përgatitor që mban numrin 123823-123831 pranohet.

18 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Numri që do të marrë ky

19 material është P01855, me klasifikimin konfidencial.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Provat

21 materiale shoqëruese po ashtu pranohen.

22 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Materiali 070949 deri në

23 070954 e më konkretisht faqja 070949 deri në 070950, si në

24 anglisht dhe në shqip, do të marri numrin e provave P01856 dhe

25 klasifikimi është konfidencial. Faleminderit.

Dëshmitari: Halil Qadraku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 19

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, z.
2 Pace.

3 Z. PACE: [Përkthim] Prova materiale shoqëruese mund të
4 riklasifikohet si publike ndërsa materialet e tjera për
5 momentin duhet të mbeten konfidenciale dhe ta rishikojmë këtë
6 në të ardhmen.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
8 Provat materiale shoqëruese riklasifikohen si publike.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull.

10 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më 20 nëntor, ne
11 kemi dorëzuar një përmbledhje për këtë dëshmitar që është
12 pranuar tashmë sipas rregullës 154. Dhe me lejen tuaj do të
13 doja ta lexoja këtë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

15 Z. PACE: [Përkthim] Kjo është një përmbledhje e
16 Dëshmitarit me numër W03873.

17 Dëshmitari W03873 është shqiptar i Kosovës që ka qenë
18 anëtar i LPK-së dhe është kyçur në UÇK rreth marsit 1998.
19 Gjatë kohës me UÇK-në, Dëshmitari 03873 ka pasur pozita të
20 ndryshme në vende të ndryshme dhe ka qenë kreu i G2 në Zonën
21 Operative të Pashtrikut që nga janari 1999.

22 Dëshmitari 03873 jep dëshmi për LPK-në, krijimin e UÇK-
23 së, rolin dhe përgjegjësitë që ka pasur ai në UÇK, përfshirë
24 faktin që ka siguruar armatime dhe ka marrë pjesë në luftime
25 të UÇK-së, në betejat e UÇK-së. Dëshmitari W03873 jep po ashtu

1 dëshmi lidhur me strukturën dhe organizimin e UÇK-së dhe rolin
2 dhe autoritetin që kanë pasur anëtarët e UÇK-së mes të cilëve
3 anëtarët e Zonës Operative të Pashtrikut dhe Shtabin e
4 Përgjithshëm të UÇK-së.

5 Dëshmitar W03873 jep dëshmi për takimet që ka pasur me
6 Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin në 1998-n dhe 1999-n, kur
7 Dëshmitari W03873 ka shoqëruar Hashim Thaçin, Kadri Veselin
8 dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së drejt Shqipërisë. Në 1999,
9 Dëshmitari W03873 është takuar me Kadri Veselin në Nishor dhe
10 në prill të 1999-s, Kadri Veseli i ka kërkuar këtij dëshmitari
11 të vizitonte të gjitha pikat mbrojtëse rreth shtabit të UÇK-së
12 gjatë luftimeve në Kleçkë.

13 Dëshmitari W03873 jep dëshmi për njohuritë që ka ai sa i
14 takon mënyrës së raportimit, vijave të raportimit mes
15 brigadave, zonave operative dhe Shtabit të Përgjithshëm të
16 UÇK-së, përfshirë sa i takon çështjeve që lidhen me zbulimin
17 dhe kundërzbulimin.

18 Dëshmitari W03873 po ashtu jep dëshmi për mënyrën se si
19 mbaheshin shënimet dhe dijeninë që ka ai për dokumentet e UÇK-
20 së, përfshirë disa nga këto dokumente ai i ka përpiluar vetë.
21 PY. Dëshmitar, gjatë intervistës keni folur për faktin që
22 keni qenë në LPK gjatë kohës që keni qenë në Zvicër dhe se
23 keni hyrë në Kosovë, në mars të 1998, për t'u kyçur në UÇK. A
24 mund t'i thoni Trupit Gjykues kur e keni konsideruar për herë
25 të parë veten ju si anëtar të UÇK-së?

1 PË. Për herë të parë e kam konsideruar veten si anëtar i UÇK-
2 së ato ditë kur kam hyrë në Kosovë, që do të thotë që është
3 marsi i vitit 1998. Kurse moralisht, shpirtërisht e kam
4 konsideruar veten qysh nga fillimet e daljes së grupeve të
5 para, sepse kam qenë me përkrahjen morale të tyre edhe
6 shpirtnore. Pra, veten e konsideroj anëtar i UÇK-së nga marsi
7 i 1998-s.

8 PY. Thatë që moralisht dhe shpirtërisht e keni konsideru
9 veten anëtar qysh prej krijimit, qysh kur kanë dalë grupet e
10 para. Kur kanë dalë për herë të parë këto grupe?

11 PË. Grupet e para të rezistencës kanë filluar qysh në vitin
12 1990, 1991, 1992, 1993, domethënë, duke pas parasysh ato
13 luftimet në Prekaz të Adem Jasharit, disa luftime të çetës së
14 Llapit në krye me Zahir Pajazitin. Dhe këto, krejt këto për
15 neve si mërgimtarë ishte një ushqim shpirtnor me të cilin
16 mburrehim dhe e përkrahim në të gjitha format që ne kemi pas
17 mundësi me i përkrah. Dhe shpirtërisht kam qenë gjithmonë me
18 ta.

19 PY. Kur, sipas jush, kur konsideroni ju se është themeluar
20 për herë të parë UÇK-ja?

21 PË. Më duket që e kemi diskutuar çka nënkuptojmë ma së pari
22 për "UÇK-në". Ju kam thënë, z. Prokuror, se UÇK, anëtar i UÇK-
23 së për mua ka qenë edhe Tahir e Nehbi Meha që janë vra në
24 vitin 1981. Ju kam thënë që për mua anëtar i UÇK-së kanë qenë
25 edhe Rexhep Mala e Nuhi Berisha që janë vra në 1984. Ju kam

1 thënë që për UÇK kanë qenë edhe Afrim Zhitia, Fahri Fazlliu që
2 janë vra në vitin 1998. Tash në vazhden e luftës kundrejt
3 okupatorit, të gjithë këta njerëz në vite, në dekada, kanë
4 qenë një lloj UÇK-je.

5 E tash nëse e flasim se kur është krijuar dhe formuar
6 UÇK-ja atëherë këtu ka data kur është bë bashkimi i të gjitha
7 grupeve, kur është bë emërtimi i kësaj i organizatës Ushtria
8 Çlirimtare e Kosovës, që gjithmonë mirret 17 nëntori i vitit
9 1994. Dhe nga ajo datë mund të flasim për emër si Ushtri
10 Çlirimtare e Kosovës. Kurse deri në atë datë, të gjithë ata
11 heronj që kanë ra kundrejt armikut i kemi konsideruar
12 gjithmonë si pjesëtarë të ushtrisë, po jo të emetuar Ushtria
13 Çlirimtare e Kosovës.

14 PY. A ka pasur ndonjë lidhje mes faktit që ju keni qenë në
15 LPK dhe faktit që e keni konsideruar veten anëtar të UÇK-së
16 nga fillimet e viteve 1990, të paktën siç shpreheni ju?

17 PË. Lëvizja Popullore e Kosovës ka qenë një organizatë
18 politiko-ushtarake nga viti 1993. Edhe si anëtar i saj, si
19 anëtar i saj edhe pak vetë si një njeri me hiperaktivitet si
20 unë, gjithmonë e kam konsideruar veten se jam pjesë përbërëse
21 nga larg e UÇK-së.

22 PY. Cili ka qenë organi më i lartë apo autoriteti më i lartë
23 brenda UÇK-së, niveli më i lartë hierarkik brenda UÇK-së --
24 LPK-së - më falni - cili ka qenë?

25 PË. Brenda LPK-së ka qenë kryesia e LPK-së.

1 PY. Kjo ishte struktura më e lartë që kishte vetë LPK-ja?

2 PË. Struktura më e lartë që kishte LPK-ja ishte kryesia e
3 saj.

4 PY. Kur u kyçët ju në LPK, kush ishte kryetar i kësaj
5 kryesie?

6 PË. Unë ju kam thënë që unë kur jam -- kyçja ime nuk ndodhur
7 ashtu si me konkurs. Mirëpo kur jam bashkuar Lëvizjes
8 Popullore të Kosovës edhe kur kam pasur mundësi që të jem në
9 kontakt si anëtar i saj, që nga ditët e para, unë e di që
10 kryetar i LPK-së ka qenë Fazlli Veliu.

11 PY. Dëshmitar, që ta sqarojmë, unë nuk po them që ju kishit
12 konkurs, po e kuptoj përgjigjen tuaj. Po pas Fazlli Veliut, ka
13 pasur ndonjë kryetar tjetër LPK-ja?

14 PË. Pas Fazlli Veliut, kryetar i Lëvizjes Popullore të
15 Kosovës ka qenë Bedri Islami.

16 PY. Mesa keni ju dijeni, për sa kohë e ushtroi këtë detyrë
17 Bedri Islami?

18 PË. Unë nuk mund të them për sa kohë, sepse në 1998-n unë kam
19 ardh në Kosovë. Po besoj se deri në fund të qershorit apo
20 fillim të korrikut të 1999-s deri në mbledhjen e pestë të
21 përgjithshme, mendoj se ai ka qenë kryetar i Lëvizjes
22 Popullore të Republikës së Kosovës, që i bie ndoshta nga 1994
23 deri në 1999, që i bie për një kohë prej pesë vjet. Po mund të
24 jem gabim.

25 PY. A e njihni Bardhyl Mahmutin?

1 PË. Bardhyl Mahmutin e njoh sepse ishim afër njeri-tjetrit
2 gjatë qëndrimit tim në Zvicër. Dhe e njoh si anëtar të LPK-së,
3 e njoh si shok, e njoh edhe sot, vazhdojmë të njihemi.

4 PY. Çfarë roli ka pasur z. Mahmuti në LPK?

5 PË. Së pari, ka qenë anëtar i LPK-së sikur të gjithë ne. Edhe
6 besoj që ka qenë anëtar i këshillit të përgjithshëm të
7 Lëvizjes Popullore të Kosovës.

8 PY. Ju keni përmendur një këshill të përgjithshëm. Kur thoni
9 këshilli i përgjithshëm ju, a bëhet fjalë për të njëjtin organ
10 që përmendët me herët që ishte kryesia apo janë dy gjëra të
11 ndara kryesia me këshillin e përgjithshëm?

12 PË. Kryesia dhe këshilli i përgjithshëm janë dy gjëra të
13 ndara. Kryesia përbëhet nga prej nja shtatë ose deri në nëntë
14 anëtarë, kurse këshilli i përgjithshëm e di që ka pasur 36, 37
15 anëtarë, organ pak më i ulët se kryesia.

16 PY. Mesa keni ju dijeni, z. Mahmuti ka pasur ndonjë rol brenda
17 UÇK-së ose tërthorazi po në lidhje me UÇK-në?

18 PË. Bardhyl Mahmuti brenda UÇK-së, mendoj, se ka pas një rol
19 shumë të rëndësishëm, duke qenë pjesë e trupës diplomatike që
20 fliste me ndërkombëtarët në emër të UÇK-së. Dhe ka qenë një
21 punëtor, një përfaqësues shumë i denjë i cili me përkushtimin
22 e tij dhe me punën e tij na ka ndihmuar shumë neve që ishim
23 poshtë në luftë.

24 PY. Pak më herët përmendët mbledhjen e përgjithshme. Më duket
25 se 1998 thatë. Ju keni qenë i përfshirë personalisht në

1 organizimin e takimeve të tilla?

2 PË. Pak më parë unë përmenda 1999, 1999 ka qenë mbledhja e
3 pestë e përgjithshme, mendoj, unë nuk kam qenë pjesë direkte e
4 saj sepse si delegat po, po jo, jo si ndonjë përfaqësues i
5 këshillit të përgjithshëm apo i kryesies. Mbjaj mend se, atë
6 kohë, nga Bardhyli dhe nga disa shokë më është kërkuar që të
7 teknikisht, teknikisht t'i kryej të gjitha punimet për
8 mbarëvajtjen e asaj mbledhjeje që u mbajt në Prizren. Edhe jam
9 munduar në ato kushtet e mia, sepse ishim menjëherë mbas
10 luftës, brenda katër javëve mbas luftës, tri javëve, jam
11 munduar që të ketë, bile teknikisht, të ketë një rregull të
12 mirë ajo mbledhje.

13 PY. Që ta kuptojmë më qartë për datat më së paku, a mund të
14 na thoni dhe një herë kur është mbajtur mbledhja e pestë e
15 përgjithshme në cilin muaj dhe në cilin vit?

16 PË. Unë mendoj se ka qenë fundi i qershorit ose fillimi i
17 korrikut, nuk jam tani i sigurtë, i 1999.

18 PY. Kjo është ajo mbledhja për të cilin ju kërkoj ndihmë z.
19 Mahmuti?

20 PË. Po.

21 PY. A ju kujtohet se çfarë u vendos në atë takim ose në pika
22 të përgjithshme se çfarë u vendos në atë takim?

23 PË. Në atë takim janë bërë shumë raporte, raporte të punës,
24 domethënë, çfarë është punuar mes këtyne dy mbledhjeve. Po
25 mendoj se pika kyçe e kryesisë së punës ka qenë që a do të

1 transformohet LPK-ja në parti politike, sepse ishte krijuar
2 një klimë e re në Kosovë, ishte krijuar një formë e re e jetës
3 politike dhe mendohej që do ishte më së miri që LPK-ja të
4 transformohej në një subjekt politik legal.

5 PY. Pas kësaj mbledhjeje, a u transformua vërtetë LPK-ja?

6 PË. Unë mendoj se në atë mbledhje shumica kanë qenë pro edhe
7 pse kishte anëtarë që ishin të frustruar, dikush nuk donte,
8 dikush po. Anëtarët e LPK-së e kanë pas këtë të drejtë
9 demokratike që ta zgjedhin secili në dojn apo të vazhdojnë apo
10 dojn të transformohen. Kështu që një pjesë e madhe, besoj unë,
11 një pjesë e madhe e asaj nomenklature që ishte atëherë brenda
12 LPK-së e ka pranuar dhe kanë qenë pjesë e ndryshimit që partia
13 e parë që është formuar atëherë ka qenë PBDK, Partia e
14 Bashkimit Demokratik të Kosovës apo Progresi Demokratik të
15 Kosovës, diçka kam harru emrin e parë. Se veç tri javë apo tre
16 muaj ka zgjat.

17 PY. Që të jemi të qartë dhe një herë ishte FPBDK apo vetëm
18 PBDK?

19 PË. Kujtoj se ishte PBDK.

20 PY. Kur u krijua PBDK-ja, kë kishte kryetar për herë të parë?

21 PË. Kur është krijuar PBDK-ja, kryetar i parë ka qenë Bardhyl
22 Mahmuti.

23 PY. A e ndryshoi ndonjëherë PBDK-ja më emërtimin, pra, pasi u
24 ndryshua nga LPK në PBDK a e ndryshoi më emrin?

25 PË. Po, subjekti PBDK pas një kohe e mori emërtimin PDK. Edhe

1 më vjen keq, ndoshta sepse unë atëherë kam qenë në strukturë e
2 uniformuar. Jam marrë shumë më pak me politikë. Mirëpo këto
3 janë ato që i kam pa si një njeri nga anash. Nuk kam qenë
4 pjesë direkte e formimit të partive politike. Por, normalisht,
5 se na ka interesu gjithmonë fati ynë dhe më këtë vazhdë po
6 flas ato njohuritë e mia çka unë e di për këtë subjekt edhe për
7 këto ndodhi.

8 PY. Xhavit Halitin e njihni?

9 PË. Xhavit Halitin sot e njeh tërë Kosova. Po edhe atëherë e
10 kam njohur Xhavit Halitin. E kam njohur gjatë veprimtarisë
11 tonë në Zvicër. E kam, se tash ishim tu fol për te mbledhja e
12 pestë e përgjithshme, deri tek kjo mbledhja e pestë e
13 përgjithshme me Xhavit Halitin jemi takuar edhe në Shqipëri.
14 Po, e njof Xhavit Halitin.

15 PY. Mesa keni ju dijeni, Xhavit Haliti a ka pas ndonjë rol
16 konkret pranë LPK-së?

17 PË. Xhavit Haliti gjithmonë ka pas një rol më konkret në LPK.

18 PY. Çfarë roli ka pasur?

19 PË. Unë mendoj se ai me vite ka qenë dhe anëtar i kryesies së
20 LPK-së. Edhe kur anëtarët, domethënë, anëtar kryesie veç ka
21 qenë mjaftueshëm i nderuar.

22 PY. Gjatë intervistës me ZPS-në, ju keni përmendur dhe Ali
23 Ahmetin si një nga personat me të cilin keni punuar bashkë në
24 LPK fillimisht. Mesa keni ju dijeni, Ali Ahmeti a ka pasur
25 ndonjë rol konkret pranë LPK-së?

Dëshmitari: Halil Qadraku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 28

1 PË. Edhe Ali Ahmeti është njëri ndër njerëzit më të spikatur,
2 më punëtor që kanë kontribuar shumë edhe në LPK, po edhe në
3 formimin e grupeve çlirimtare që kanë rezultue me Ushtrinë
4 Çlirimtare të Kosovës dhe me Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare.

5 PY. Mesa dini ju, si ka kontribuar ai në atë që u transformua
6 më pas në UÇK, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës?

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Kam një kundërshtim me këtë
8 pistë pyetjesh. A mund të na japi edhe burimin sidomos duke
9 marrë parasysh faktin që dëshmitari ka pasur rol të caktuar në
10 LPK dhe nivelin e tij dhe Prokurori po i kërkon të flasë këtij
11 dëshmitari për gjëra që s'janë relevante për të dhe nuk janë
12 pjesë e nivelit të tij.

13 Z. PACE: [Përkthim] E kundërshtoj dhe unë këtë. Ai ka
14 thënë që e ka takuar Ali Ahmetin gjatë intervistës dhe na ka
15 treguar se çfarë roli ka pasur Ali Ahmeti pranë LPK-së.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.
17 Mund ta trajtoni vetë këtë gjatë kundërpyetjeve tuaja, sepse
18 dëshmitari duket se ka njohuri të mjaftueshme për të dhënë
19 këtë dëshmi.

20 Vazhdoni, z. Pace.

21 Z. PACE: [Përkthim]

22 PY. Dëshmitar, pyetja ime ishte kjo: Çfarë kontributi ka
23 dhënë Ali Ahmeti për krijimin e Ushtrisë Çlirimtare të
24 Kosovës, siç thatë ju?

25 r. Z. Gjykatës, unë dhe pajtohem edhe me reagimin e Mbrojtjes

1 sepse është shumë e vërtetë që niveli im -- unë kam qenë vetëm
2 një anëtar i LPK-së i thjeshtë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

4 Z. PACE: [Përkthim] Mikrofonin e patët të fikur.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkojmë
6 ndjesë.

7 Dëshmitar, përpiguni me aq sa të keni mundësi. Nëse ju
8 nuk e keni përgjigjen, thjesht thoni që unë nuk kam përgjigje
9 për këtë. Se është krejt në rregull dhe kjo gjë. Mirë?

10 DËSHMITARI: Unë e njoh Ali Ahmetin, e kam njohur Ali
11 Ahmetin edhe mendoj se Ali Ahmeti ka qenë krycial. Ka qenë një
12 pjesë e madhe, një pjesë e mirë, është një pjesë e punës deri
13 në formimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

14 Z. PACE: [Përkthim]

15 PY. A mund të na shpjegoni, të paktën me aq sa dini ju, çfarë
16 bëri ai konkretisht, si luajti rol?

17 PË. Mendoj se është e pamundur për mua që ta shpjegoj këtë,
18 mirëpo e di që ka qenë, tani më vonë, domethënë, kemi mësuar,
19 që ai ka qenë në atë grupin për veprimet e veçanta, i cili
20 ishte i caktuar nga LPK-ja për të ndërmjetësuar me grupet e
21 armatosura brenda vendit. Ka qenë pjesë përbërëse e bashkimit
22 të atyne grupeve. Ka qenë pjesë përbërëse e asaj ekipës që ka
23 bërë emërtimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ka qenë pjesë
24 përbërëse e shumë aktiviteteve tjera që kanë ardh. Kështu që
25 për mu Ali Ahmeti gëzon një respekt shumë të madh në këtë

1 drejtim, si edhe e tërë LPK-ja.

2 PY. Si e keni, si e mësuar ju këtë lidhur me Ali Ahmetin?

3 PË. Tani nuk mund të jap atë -- jo që nuk dua, po nuk e di të
4 jap se si e mësuar, sepse edhe ne anëtarët e thjeshtë kishim
5 të drejtë të kërkonim edhe nga këshilli i përgjithshëm edhe
6 nga kryesia që të na -- të informohem për disa gjëra çka po
7 ndodh me fatin tonë dhe çka po ndodh me fatin e Kosovës.
8 Mirëpo, nuk mund të them saktësisht se ku dhe si e mësova këtë
9 sepse nuk është një proces që mësohet brenda një ore, po është
10 një proces që ka zgjatë me vite.

11 PY. A keni dëgjuar për një person që e ka emrin Sabri
12 Kiçmari, Dëshmitar?

13 PË. Po, Sabri Kiçmarin, ndoshta e kam takuar dy herë kështu
14 figurativisht. Mirëpo si emër e di që ka qenë pjesë e LPK-së
15 në Gjermani. Ka qenë pjesë e trupës diplomatike si përfaqësues
16 i UÇK-së gjatë luftës në Gjermani dhe në atë rrethinë ku ka
17 jetuar ka qenë një pjesë e pandashme e të gjithave atyne
18 aktiviteteve që kanë ndodhë në Kosovë brenda LPK-së dhe UÇK-
19 së.

20 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk e di në
21 qoftë se mund të di do bëjmë pushim tani apo jo?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
23 pushim për dhjetë minuta, Dëshmitar, do kthehemi për dhjetë
24 minuta. Ju lutem mos e diskutoni me askënd dëshminë tuaj me
25 askënd përtej këtyre që janë në seancën gjyqësore.

Dëshmitari: Halil Qadraku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 31

1 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam një çështje
2 të shkurtër për të ngritur përpara sesa të largohet dëshmitari
3 që nuk ka të bëjë në fakt me dëshmitarin. Megjithatë bëhet
4 fjalë për një dokument që ju na autorizuat që të mund ta
5 shtonit tek lista e provave. Ne i kemi nxjerrë ato, nuk e di
6 në qoftë se mund të na ndihmojë Zyra Administrative, ZMMD-ja,
7 jo, Zyra Administrative në mënyrë të tillë që këto dokumente
8 të mund të renditen në listën e dokumenteve tona për këtë
9 dëshmitar. Është e mundur kjo?

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

11 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
13 pushim dhjetë minuta.

14 --- Seanca ndërpritet në orën 10.04

15 --- Seanca rifillon në orën 10.14

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
17 silleni dëshmitarin në sallë.

18 [Dëshmitari vijon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace, mund
20 të vazhdoni me pyetjet.

21 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

22 PY. Dëshmitar, kur keni qenë në Zvicër përpara sesa të
23 ktheheshit në Kosovë në mars 1998, a keni qenë në dijeni të
24 ndonjë luftimi të UÇK-së ose operacioneve të UÇK-së në Kosovë?

25 PË. Sa -- gjatë qëndrimit tim në Zvicër, sa kam qenë atje,

1 për të gjitha akcionet që janë ndërmarrë në Kosovë kemi mësuar
2 nga organi i ynë, organi i Lëvizjes Popullore të Kosovë,
3 kishim një gazetë aty, Gjykatës, në emër të Lëvizjes Popullore
4 të Kosovë, quhej Zëri i Kosovës dhe përmes atij organi
5 mundoheshim që të gjitha format, sado të vogla, të rezistencës
6 ndaj okupatorit serb t'i shkruajmë edhe të propagandojmë
7 përmes saj. Pra, kam lexuar, kam mësuar, por jo që kam qenë
8 pjesë e tyre. Kam mësuar vetëm nga gazeta jonë dhe nga
9 informacioni që kishim përmes saj.

10 PY. A ju kujtohet se në çfarë viti keni filluar që të merrni
11 informacion lidhur me luftimet ose aksionet e UÇK-së në Kosovë
12 përmes gazetës?

13 PË. Aksionet, aksionet e UÇK-së si UÇK normalisht që nuk kemi
14 mundur që t'i dëgjojmë para se të bëhet edhe emërtimi i saj.
15 Emërtimi i saj ka ndodhur në nëntor të vitit 1994. Mirëpo të
16 gjitha, të gjitha ato akcionet ç'ka, ç'ka janë propaganduar
17 mendoj që i kemi lexuar gjatë vitit 1996, 1997, 1998. Ndoshta
18 ka pas ndonjë akcion që ka qenë edhe i organizuar edhe më
19 herët, por nuk e ka pas emërtimin akcion i UÇK-së, po ka qenë
20 emërtimi, akcion i grupeve çlirimtare apo grupeve që ishin në
21 rezistencën kundër okupatorit serb.

22 Z. PACE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit që të
23 paraqesë në ekran dokumentin SPOE00131752 deri në
24 SPOE00131823, versionet në anglisht dhe në shqip. Përkthimi në
25 anglisht ka të njëjtin numër ERN-je, por përfundon me ET në

Dëshmitari: Halil Qadraku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 33

1 fund. Në të dyja dokumentet dua që të paraqitet në ekran faqja
2 SPOE00131754.

3 PY. Dëshmitar, në ekran keni një dokument në të majtë në
4 shqip dhe përkthimi i këtij dokumenti në të djathtë. Ky është
5 printimi i një interviste i Blerim Shalës me Xhavit Halitin. A
6 e ke parë këtë dokument përpara sesa t'jua tregoja unë në
7 seancën përgatitore, Dëshmitar?

8 PË. Jo, nuk e kam parë përpara.

9 PY. Do t'ju lexoj një pjesë të këtij dokumenti dhe pastaj do
10 t'ju bëj disa pyetje.

11 Z. PACE: [Përkthim] Për këtë i kërkoj Sekretarit që të
12 kalojmë tek faqja 00131770. Do të lexoj nga paragrafi i dytë i
13 kësaj faqeje. Sikurse e thashë, do të lexoj nga paragrafi i
14 dytë. I kërkoj Sekretarit të kalojmë pak më sipër në faqe, në
15 paragrafin e dytë, ndërkohë që në versionin në shqip është në
16 rregull.

17 PY. Dëshmitar, ose mund të lexoni përkthimin ose mund të na
18 ndiqni përmes përkthimit:

19 "Askush nuk e mohon kontributin e LPK-së sa i takon
20 furnizimit të UÇK-së me armë, rolin e LPK-së në furnizimin e
21 LPK-së me mjete monetare dhe rolin e LPK-së për mbrojtjen
22 politike dhe për përfaqësim politik në Kosovë dhe jashtë
23 Kosove, kontribut të cilin askush nuk mund ta mohojë."

24 A pajtoheni që askush nuk e mohon dot kontributin e LPK-
25 së për sa i takon furnizimit të UÇK-së me mjete materiale, me

1 pajisje të tjera, me armë, për sa i takon mbrojtjes së
2 Kosovës? A pajtoheni me këtë pjesë që sapo lexova, Dëshmitar?
3 PË. Po, pajtohem me këtë pjesë edhe kështu është. Askush nuk
4 mund ta mohojë punën, veprimtarinë e LPK-së në organizimin, në
5 rritjen, në konsolidimin e të gjitha formacioneve të UÇK-së.

6 PY. Do të vazhdoj të lexoj më tej:

7 "Adem Jasharia, Zahir Pajaziti, Mujë Krasniqi, Rexhep
8 Selimi, Sokol Bashota, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Lahi
9 Brahimaj e të tjerë që kanë vepruar për konsolidimin e UÇK-së
10 janë pjesë e një strukture të përbashkët."

11 Pyetja që kam për ju, Dëshmitar, është kjo: A është i
12 saktë ky informacion?

13 PË. Unë e mendoj se ky informacion është i saktë.

14 Z. PACE: [Përkthim] Do kaloj te paragrafi i parafundit
15 tek e njëjta faqe. Mund të ulemi pak më poshtë në të njëjtën
16 faqe në shqip.

17 PY. "Në vitin 1993, në mbledhjen e kryesisë së LPK-së që
18 është mbajtur në Zvicër, kam propozuar se për të dalë nga
19 kriza duhej krijuar një mekanizëm i veçantë ushtarak. Ne
20 kishim biseduar për shumë gjëra me Xhavit Hazirin. Kryesia e
21 LPK-së në Kosovë të cilës i printe Xhavit Haziri kishte marrë
22 një vendim përmes të cilit kishte autorizuar Xhavit Halitin që
23 të merrej me procesin e organizimit ushtarak në Shqipëri dhe
24 në diasporë."

25 Mekanizimi i veçantë ushtarak, a është i njëjti -- e

1 njëjta strukturë të cilët ju iu referuat ose përmendët kur
2 dhatë informacion për Ali Ahmentin?

3 PË. Po, mendoj se këtu bëhet fjalë për atë grupin e veprimeve
4 të veçanta, si është quajtur nga LPK-ja edhe në të cilin ka
5 qenë edhe Xhavit Haliti, puna e të cilit gjatë vitit 1997-1998
6 në Shqipëri ka bërë që të ketë një mbarëvajtje më të mirë
7 organizimi apo sa më i mirë, në atë kohë, që ishte i mundshëm.

8 PY. A jeni në dijeni për vendimin e marrë në mbledhjen e
9 kryesisë së LPK-së që ka autorizuar Xhavit Hazirin që të
10 merrej me procesin e organizimit ushtarak në Shqipëri dhe në
11 diasporë?

12 PË. Kur po flasim jam në dijeni. Pas luftës kam qenë në
13 dijeni. Por, në atë kohë në vitin 1993, kur ata, kryesia, kanë
14 marrë një vendim të tillë që të punojnë në këtë drejtim me
15 grupin për veprimet e veçanta që të organizojnë grupet e
16 armatosura në Kosovë, në atë kohë kjo ka qenë shumë e
17 distancuar nga ne, ose e ruajtur nga ne për shkak që duhej të
18 ruhej me fanatizëm puna, të ruhen njerëzit në Kosovë, sepse
19 çdo vit kishim arrestime, çdo vit kishim humbje të shokëve
20 tanë.

21 Domethënë në atë kohë nuk e kam ditur çfarë është
22 biseduar, por më vonë e kam mësuar këto nga shokët dhe nga
23 informimet.

24 PY. Këta shokët, nga të cilët e mësuar ju këtë gjë, ishin
25 pjesëtar apo anëtar të LPK-së apo të UÇK-së?

1 PË. Shogërimi i im nga, nga -- në dekadën e fundit të
2 shekullit të kaluar ka qenë kryesisht, kryesisht me shokët nga
3 Lëvizja Popullore e Kosovës, sepse kam menduar se ata janë,
4 edhe sot mendoj, se ata ishin djemtë më të mirë, ishin djemtë
5 më të besueshëm, ishin djemtë, ishin djemtë më guximtarë,
6 ishin djemtë që u munduan t'ja kthejnë dinjitetin dhe shpresën
7 popullit tonë, gjë të cilën edhe ja kanë arritur me çlirimin e
8 Kosovës.

9 PY. Dëshmitar, do ju kërkoja që të përqendroheshit tek pyetja
10 dhe përgjigjuni pyetjes që ju bëra unë, se nuk mendoj që iu
11 përgjigjes pyetjes. Atëherë, shokët që ju përmendët nga të
12 cilët ju e mësuat këtë informacion, a ishin pjesëtarë të LPK-
13 së apo të UÇK-së?

14 PË. Gjithmonë kanë qenë pjesëtarë ose të LPK-së ose të UÇK-
15 së.

16 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që të
17 pranohen në prova gjyqësore dy fletët që ia treguam
18 dëshmitarit. Pra, janë faqet që përfundojmë 131754 dhe 131770.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
20 kundërshtim.

21 Z. DIXON: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës.
22 Kundërshtojmë pranimin e këtyre dy fletëve. Ka bërë minimumin
23 e mundshëm, ka lexuar thjesht disa rreshta për dëshmitarin dhe
24 i ka thënë në qoftë se informacioni është i saktë apo jo dhe
25 nuk ka shkuar përtej kësaj.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem na
2 thoni cili është kundërshtimi.

3 Z. DIXON: [Përkthim] Kundërshtimi është që ky dëshmitar
4 nuk ka mundësi që të vërtetojë në mënyrë të përnjëmendtë që
5 informacioni është i saktë dhe nuk ka bazë, nuk ka themel për
6 sa i takon vërtetimit të informacionit këtu.

7 Nuk është në gjendje ky dëshmitar që të vërtetojë
8 saktësinë e këtij informacioni. Mund të thërrasë dëshmitar
9 tjetër Prokuroria për këtë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
11 kundërshtimi.

12 Ndonjë kundërshtim tjetër?

13 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Edhe ne e mbështesim
14 kundërshtimin e kolegut. [REDAKTUAR]
15 [REDAKTUAR].

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është në
17 procesverbal. E thashë edhe unë që herët që sot në fillim të
18 seancës.

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Atëherë, Trupi Gjykses mbase
20 duhet të marrë parasysh vetë atë çfarë ka thënë vetë [REDAKTUAR]
21 lidhur me këtë intervistë konkrete.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, ju lutem,
23 thjesht bëni kundërshtimin. Mos shkoni më tej. Pra, ju thjesht
24 dhatë një përkufizim të shkollave juridike të asaj çfarë
25 përbën një kundërshtim, apo jo? Kështu që për këtë arsye, ju

1 lutem, thjesht thoni cili është kundërshtimi dhe kaq.

2 [Mikrofoni çaktivizuar].

3 Në rregull, atëherë. Dokumenti pranohet. Pranohet
4 dokumenti SPOE00131754 dhe SPOE00131770.

5 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
6 Gjykatës. Këto dy faqe, në versionin në shqip dhe në anglisht
7 do të marrin numrin e provës P01857 dhe do të klasifikohen si
8 publike.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ju ftoja
10 të dy avokatëve që të lexoni rregullat në urdhrin për
11 zhvillimin e procesit gjyqësor kur flitet për pjesën e
12 kundërshtimit të qëndrimeve të caktuara të Prokurorisë.

13 [Mikrofoni çaktivizuar].

14 Z. PACE: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit. Tani do
15 kërkoj nga Sekretaria që të paraqesë në ekran dokumentin
16 SITF00245151 [Sipas përkthimit] deri në 00245415, do shikojmë
17 vetëm versionin në shqip. Do fillojmë me faqen e parë që ka
18 numrin 245112. Faleminderit.

19 PY. Dëshmitar, keni një dokument përpara në ekran.

20 Z. PACE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit që të kalojmë
21 tek faqja tjetër që është 245113. Ta zvogëlojmë pak faqen në
22 mënyrë të tillë që ta shohim të plotë atë.

23 PY. Dëshmitar, këtë libër a e kishe parë t'i më përpara sesa
24 t'ja u tregoja përpara seancës përgatitore që patëm bashkë?

25 PË. Këtë libër unë nuk e kam parë më përpara.

1 Z. PACE: [Përkthim] Në shqip le të kalojmë tek faqja
2 SITF00245167 dhe përbri kësaj faqe do kërkoj që të paraqitet
3 përkthimi i faqes në anglisht që mban numrin SITF00245167 deri
4 në SITF00245169-ET e Rishikuar, në faqen e parë në anglisht.
5 Do filloj të lexoj në të dyja faqet, në fakt, do lexoj nga
6 anglishtja, po nga paragrafi i parafundit në shqip dhe pastaj
7 do kalojmë te faqja tjetër.

8 PY. Sikurse ju thashë, Dëshmitar, do lexoj një pjesë për
9 juve, pastaj kam disa pyetje.

10 "Gjithmonë e kam respektuar profesor Fazli Veliun. Më pas
11 kur ngjarjet sollën tek unë pjesë të arkivit të Lëvizjes
12 Popullore të Kosovës, pashë se shumë prej gjërave që kishin
13 rrjedhë përmes tij, kishin qenë jo vetëm të dobishme, por edhe
14 të domosdoshme. Secila prej tyre përbënte në atë kohë një të
15 fshehtë të madhe e cila duhej mbajtur në vete.

16 "Le të themi vetëm njëërën prej tyre: krijimin e 'sektorit
17 të veçantë' ose më saktë sektorit ushtar të Lëvizjes Popullore
18 të Kosovës."

19 Z. PACE: [Përkthim] Do të vazhdojmë tek faqja tjetër dhe
20 do të vazhdoj leximin.

21 PY. "Ky sektor i cili nuk ishte as më shumë e as më pak veçse
22 bërthama e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, do të krijohej
23 me një vendim të posaçëm, tepër të brendshëm të kryesisë së
24 Lëvizjes Popullore të Kosovë dhe vetëm ajo, pra vetëm kryesia,
25 kishte të drejtë të dinte për punën dhe aktivitetin e këtij

1 grupi. Përmes sektorit të veçantë janë organizuar deri në
2 detaje struktura të veçanta të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
3 është bërë lëvizja e mjeteve dhe e njerëzve, janë ngritur
4 mjete -- rrjete logjistike, është marrë kontakti me njerëzit,
5 janë bërë shumë gjëra të tjera që asaj kohe kishin rëndësi
6 jetime.”

7 “Xhavit Haliti, drejtues i ‘Sektorit të Rëndësisë së
8 Veçantë’ (ushtarake) do të saktësojë.”

9 Dhe pastaj jepet citimi:

10 “Në mbledhjen e kryesisë së LPK-së ... në emigracion në
11 Zvicër më 1993, kam propozuar që për të dalë prej krize duhej
12 krijuar një mekanizëm i veçantë ushtarak... Në mbledhjen e
13 Zvicrës, të mbajtur në banesën e një shoku nga Kosova, kam
14 propozuar se ç'ka dhe si mund të veprohej, si duhej të
15 organizohej LPK-ja, përfshirë këtu dhe strukturën ushtarake
16 dhe mënyrën e funksionimit të saj. Propozimi im i parë ka qenë
17 që të krijohet sektori ushtarak ose sektori që do të merrej me
18 çështjet ushtarake në kuadër të LPK-së, gjegjësisht në kuadër
19 të kryesisë së LPK-së i cili do t'i jepte llogari vetëm
20 kryesisë dhe askujt tjetër. Dhe në këtë rast, të gjitha
21 përparësitë e trajtimit të mjeteve materiale dhe vendimmarrjes
22 për gjithçka ishin në kompetencë të sektorit të rëndësisë së
23 veçantë.

24 “Në sektor fillimisht ishim vetëm unë dhe Ali Ahmeti, dhe
25 më pas u bashkua dhe Jashar Salihu dhe pas mbërritjes të Azem

1 Sylës prej Kosove, ai u bë pjesë e tij.

2 "Kjo ishte dëshmia e drejtuesit ose udhëheqësit të
3 'sektorit veçantë', më konkretisht sektorit ushtarak të LPK-së
4 që bashku me strukturat në Kosovë mori përsipër që të krijonin
5 UÇK-në."

6 Pyetja që kam për ju, Dëshmitar, është kjo: Ky mekanizimi
7 i veçantë që përmendet këtu, a është i njëjti si struktura që
8 ju e përmendët edhe pak më herët në dëshminë sot, Dëshmitar?
9 PË. Po.

10 Z. PACE: [Përkthim] Tani le të kalojmë në versionin në
11 shqip në faqen që përfundon me 24579 ndërkohë që në anglisht
12 do të duhet që të paraqitet një përkthim i pjesshëm që ka
13 numrin SITF00235724 [Sipas përkthimit] deri në SITF00245296-ET
14 Rishikuar, dhe do të jetë në të njëjtën faqe, domethënë në
15 245279.

16 Për ta sqaruar, këto materiale janë publike dhe mund të
17 përcillen për gjithë publikun. Do ta informojmë ne Sekretarinë
18 në qoftë se ka nevojë që të mos transmetojmë për publikun
19 diçka të caktuar.

20 PY. Dëshmitar, po lexoj që në krye të faqes dhe më pas do
21 t'ju bëj disa pyetje.

22 "Hyrja e tretë në Kosovë ka ndodhur në vitin 1993, me
23 vendim të kryesisë së organizatës. Udhëtimin e ka organizuar
24 Atdhetar Labinishti. Detyra jonë ishte organizimi i
25 konferencës së Lëvizjes. Konferencën e mbajtëm në fshatin

1 Kollar të Kërçovës dhe e quajtmë Mbledhja Konsultative. Në
2 këtë konferencë u nxor konkluzë për përgatitjen e kryengritjes
3 së armatosur meqë mjetet paqësore nuk po jepnin më fryte. Kjo
4 konkluzë do orientojë Lëvizjen për formimin e njësive të
5 armatosura të cilat gjatë organizimit u përfshinë në Ushtrinë
6 Çlirimtare të Kosovës. Koordinimin e formimit dhe organizimit
7 të UÇK-së e udhëhoqte 'Sektori i Rëndësisë së Veçantë', i
8 formuar nga kryesia e LPK-së ... sipas kompetencave që ja
9 kishte caktuar Këshilli i Përgjithshëm i organizatës sonë.
10 Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin përpos të tjerëve, Ahmet
11 Haxhia, Xhavit Haziri, Ramadan Avdia, Gafurr Elshani, Azem
12 Sylja, Hashim Thaçi, Bajrush Xhemajli, Hulusi Beqiri, Atdhetar
13 Labenishti e të tjerë. Organizimin teknik dhe sigurinë e kësaj
14 konference e ka udhëhequr Beqir Limani. Konferenca që mbajtur
15 në shtëpinë e Zeqir Zeqirit. Kjo konferencë që parapërgatitje
16 për mbajtjen e mbledhjes së përgjithshme në Kosovë të vitit
17 1994. Në këtë mbledhje morën pjesë shumë personalitete."

18 Dëshmitar, pyetja ime është kjo: A keni dijeni ju për
19 këtë konferencë, ose e thënë ndryshe këtu, mbledhje
20 konsultative në shtëpinë e Zeqir Zeqirit? Keni ndonjë dijeni
21 lidhur me këtë?

22 PË. Në atë kohë kur është mbajtur kjo mbledhje konsultative kjo
23 ka qenë shumë sekret. Sot, sot kam informacion aq sa dhe ju,
24 duke i lexuar të gjitha dëshmitë e shokëve që kanë qenë aty
25 pjesëmarrës, po jo më shumë.

1 PY. Si i keni mësu këto informatat, Dëshmitar?

2 PË. Si anëtar i Lëvizjes Popullore të Kosovës gjatë
3 mbledhjeve tona gjithmonë kemi pasur ndoshta dhe ndonjë
4 mysafir që na ka ardh edhe nga këshilli i përgjithshëm apo nga
5 kryesia edhe na kanë mujt, kanë mundur të na informojnë edhe
6 për këtë mbledhje konsultative, por jo me të gjitha, me të
7 gjitha detajet e asaj mbledhjes se disa gjëra duhet të ruhen
8 edhe sekret, mirëpo nuk e di datën e saktë, nuk e di edhe
9 mënyrën e saktë. Mirëpo e kam marrë gjithmonë nga, nga shokët,
10 nga anëtarët tanë të LPK-së si informacion, po sigurisht që më
11 vonë se kjo datë.

12 PY. Dëshmitar, kur thoni "shumë ma vonë" për cilën periudhë
13 kohore e keni fjalën konkretisht?

14 PË. Për ndofta për të njëjtin vit, por më vonë, pasi që është
15 kryer mbledhja konsultative, pasi që janë kthyer shokët tanë
16 nga ajo mbledhje, pasi që është zhdukur rrezikshmëria e të
17 qenurit mbrena vendit në këtë.

18 PY. A mund ta sqaroni, a bëhet fjalë për personat që kanë
19 qenë në këtë mbledhje, pra këta persona ju kanë treguar ju
20 çfarë ka ndodh në këtë mbledhje, po pa ju treguar hollësi?

21 PË. Jo të gjithë këta persona kanë mund të takohen me
22 këshillat e përgjithshëm nëpër komuna apo nëpër kantone ku
23 ishim, po ndonjëri nga ata sigurisht që po. Ose ka qenë
24 Gafurri ose ka qenë Ramadani, Ramadan Avdyli.

25 PY. Të jemi të qartë, Gafurri dhe Ramadani që përmendët ju

1 kanë qenë në këtë takim vetë personalisht, në këtë mbledhje
2 dhe më pas brenda të njëjtit vit ju kanë informuar për
3 takimin?

4 Z. DIXON: [Përkthim] Është orientuese.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ishte
6 orientuese. Ju lutem riformulojeni pyetjen.

7 Z. PACE: [Përkthim]

8 PY. Gafurr Elshani dhe Ramadan Avdyli, mesa dini ju, kanë
9 marrë pjesë personalisht në këtë mbledhje, në mbledhjen që u
10 përmend, kjo mbledhja konsultative?

11 PË. Në atë kohë ata kurrë nuk e kanë cekur që ndofta edhe
12 vetë kanë qenë pjesëmarrës të kësaj mbledhje konsultative,
13 mirëpo si informacion kur na kanë sjellë, na kanë sjellë se
14 është mbajt, domethënë, ata janë në dijeni për mbajtjen e
15 kësaj mbledhjeje edhe na kanë ofruar neve anëtarëve të tjerë
16 si një informacion, por jo si vetë pjesëmarrës i asaj, i asaj
17 mbledhje konsultative.

18 PY. Dëshmitar, a e mban mend që gjatë seancës përgatitore kur
19 e lexuam këtë pjesë të librit thuhej që kanë qenë delegatët që
20 shkuan në Zvicrës pas mbledhjes në shtëpinë e Zeqir Zeqirit në
21 1994-n, pra këta delegatë të treguan ty dhe të tjerëve lidhur
22 me këtë mbledhje? E mban mend që e diskutuam këtë?

23 PË. Unë e mbaj mend që e kemi diskutuar, mirëpo nuk mbaj mend
24 që të kem thënë që delegatët më kanë treguar mua. Po na kanë
25 informuar sigurisht të gjithë anëtarësinë në Zvicër, sepse

1 Zvicra në 26 kantone ka në secilin kanton ka një këshill
2 rrethi edhe nuk kanë mujt të takohen me të gjithë ata, po kanë
3 dhënë si një informacion, si një informacion brenda
4 organizatës. Tash se si ka ardh informacion tani, tani nuk më
5 kujtohet se është 31 vjet pas, mirëpo e di që kanë qenë në
6 dijeni të mbajtjes së kësaj mbledhjes konsultative pas
7 mbajtjes së saj. Po që është mbrenda vitit 1993.

8 PY. Çfarë ka ndodh në 1993-shin edhe një herë, ju lutem? Në
9 93-shin apo 98-n?

10 PË. Kjo mbledhje konsultative është mbajtur në vitin 1993,
11 edhe ne si anëtarë të këshillit të LPK-së e kemi marrë si
12 informacion në vitin 1993, mirëpo pas mbledhjes pasi janë
13 kthyer anëtarët nëpër shtëpitë e veta, ku kanë qenë, dikush ka
14 qenë në Gjermani, dikush ka qenë në Zvicër, dikush në Kosovë
15 apo dikush në Shqipëri, pas mbajtjes së asaj mbledhjes ne kemi
16 marrë informacione nga strukturat e larta, nga këshillimi i
17 përgjithshëm nga dokush prej këtyne se me Gafurrin kemi qenë
18 edhe afër me jetë, ku kemi jetu në Zvicër. Me Ramadan Avdiun
19 kemi qenë afër, ai ishte në Gjenevë, unë isha në Lozanë,
20 kështu që kemi mund ta diskutoj, kemi mund ta marrim këtë
21 informacion në një mënyrë apo tjetër. Por tani se si ka ardh
22 ai informacion t'ju them me saktësi, nuk mund ta përcaktoj.
23 Nuk mund ta jap.

24 Z. TULLY: [Përkthim] Përpara se të vijojmë, do lutesha që
25 të na jepnin edhe referencën për atë diskutim që është mbajt

1 gjatë seancës përgatitore që përmendi Prokurori në faqen 38,
2 rreshti 18.

3 Z. PACE: [Përkthim] Patjetër, është Shënimi Përgatitor
4 numër 2, me numër 12382-123859, paragrafi 13.

5 I nderuar Gjykatës, do të doja të pranoheshin si provë
6 gjyqësore materialet që i tregova dëshmitari.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e kapa
8 numrat, ju lutem mi jepni edhe një herë.

9 Z. PACE: [Përkthim] Po, janë dy ballinat që janë me numër
10 245112-245113, më pas ne kaluam te 245167 dhe 245168. Dhe
11 fragmenti i fundit ishte shkëputur nga materiali 245279.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
13 Ju kërkoj ndjesë.

14 Z. DIXON: [Përkthim] Po. Duhet ta diskutojmë në praninë e
15 dëshmitarit, sepse nuk dua të bëj sugjerime të panevojshme.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
17 [Përkthim] Nuk e di çfarë do të thoni. Vlerësojeni vetë
18 nëse duhet ta thoni në prani të dëshmitarit apo jo.

19 Z. DIXON: [Përkthim] Është një kundërshtim ligjor.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni
21 atëherë.

22 Z. DIXON: [Përkthim] Kundërshtimi është ky. Dëshmitari
23 nuk është në gjendje të na thotë nëse është autentik ky
24 dokument dhe fragmentet përkatëse. Dëshmitarit mund t'i bëhen
25 pyetje për kujtesën e tij sigurisht, por Prokuroria nuk po

Dëshmitari: Halil Qadraku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 47

1 trajton një pikë të rëndësishme që lidhet me autenticitetin,
2 ç'ka do të thotë që dëshmitari nuk mund të thotë me konkretësi
3 çfarë është diskutuar në atë mbledhje.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po kjo
5 s'është argument juridik. Ju po flisni për fakte të dëshmisë,
6 për pjesë të dëshmisë, tani.

7 Z. DIXON: [Përkthim] Po ngre një kundërshtim ligjor sa i
8 takon autenticitetit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. E
10 kuptuam.

11 Z. DIXON: [Përkthim] Po ju them që nuk mund të pranohen
12 këto materiale përmes këtij dëshmitari, po me një dëshmitar
13 tjetër që ka qenë i pranishëm.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më duket e
15 bëra të qartë sot paradite me urdhrin me gojë që materialet
16 janë të pranishme. Dëshmitari mund të flasë për autenticitetin
17 e materialeve për faktin që ka ndodhur një mbledhje. E kuptoj
18 që është provë dytësore. Do të marri të njëjtën peshë që
19 marrin provat e dyta gjyqësore, dhe e vendos Trupi Gjyqësor
20 çfarë peshe do t'i japi kësaj dëshmie. Megjithatë, e marr
21 parasysh kundërshtimin tuaj. Faleminderit.

22 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Mbështes parafolësin, z. Dixon,
24 dhe përsërisim dhe ne kundërshtimin që kemi paraqitur përmes
25 postës elektronike më datë 18 nëntor 2024.

1 Z. TULLY: [Përkthim] Ne nuk kemi asnjë kundërshtim
2 përveçse atyre që u përmendën tashmë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
4 Materiali SITF00245167 pranohet.

5 [Trupi Gjygues dhe Sekretari i Gjykatës
6 këshillohen]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po i përmend
8 të gjithë numrat. Atëherë, bëhet fjalë për materialet
9 SITF00245112 dhe 113. SITF00245279.

10 Z. PACE: [Përkthim] Është dhe një tjetër. Është materiali
11 245168. Dhe unë vazhdova të kaloja pastaj dhe tek pra,
12 fillonte me 167 dhe unë kalova më pas te 168.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohen.

14 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull. Materialet
15 pranohen, me numrin P01858, në anglisht edhe në shqip.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
17 Vazhdoni z. Pace.

18 Z. PACE: [Përkthim] Materialet janë publike dhe ndërkohë
19 mund të hiqen nga ekrani.

20 Dhe ju lutem tani të vendosni në ekran --

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

22 Riklasifikojini dokumentet si publike.

23 Tani vazhdoni, z. Pace.

24 Z. PACE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpreva.

25 Ju lutem, vendosim në ekran materialin P0075 përkrah

1 materialit P0075-ET dhe tek të dyja këto materiale është
2 nevoja të shohim faqen U001-9249. Faleminderit.
3 PY. Dëshmitar, në ekran, ja presim sa të dali faqja e duhur.
4 Në të djathtë mund ta shihni që është një dokument në gjuhën
5 angleze, dhe në të majtë është shqipja.

6 Ja të presim edhe anglishten tani.

7 Z. PACE: [Përkthim] Jo, nuk është kjo faqja. Është faqja
8 që përfundon me numër 9249. Në fakt, as shqipja nuk është e
9 saktë. Na duhet faqja që ka numrin 9249. Dokumenti në fakt nuk
10 është sipas radhës, prandaj është e vështirë për ta gjetur. Në
11 PDF është faqja 61 e një materiali prej 68 faqe. Ju kërkoj
12 ndjesë, duhet ta kisha thënë këtë që në fillim. Në rregull.

13 PY. Dëshmitar, në të majtë është në shqip me shkrim dore, në
14 të djathtë është në anglisht e shtypur. Materiali që është në
15 të majtë, përpara se tua tregoja unë gjatë seancës
16 përgatitore, e kishit parë ju ndonjëherë?

17 PË. Jo.

18 Z. PACE: [Përkthim] Zmadhojmë dhe shqipen dhe anglishten
19 në të majtë, ju lutem. Ju lutem që faqen ta shohim të plotë,
20 kështu që ta zvogëlojmë pak. Anglishtja është në rregull. Ju
21 lutem shqipen kështu.

22 PY. Dëshmitar, fokusohuni në të majtë të shqipes. Shohim që
23 këtu thotë "Kompania e 3-të" në krye të faqes, edhe ka një
24 listë me objekte dhe emra. Dhe dikund në fund të faqes shohim
25 emrin tuaj. Thotë "Halil Qadraku" dhe thotë "Jaguar ose

1 Jaguar", nuk është e qartë, dhe ka numrin, shifrat 985/40226.

2 Çfarë janë këto shifra?

3 PY. Mendoj se kjo fletë në tërësi flet për njësitin tonë, të
4 fshatit tim, të Malësisë së Vogël, të fshatit Radoste. Mendoj
5 se flet për sasinë e armatimit dhe sasinë e municione që
6 kishim në ato ditët e para të organizimit. Emrat e fundit,
7 duke përfshirë edhe emrin tim këtu, janë për armët e tona të
8 brezit. Domethënë, nuk di a mund të cek emrat?

9 PY. E kuptoj.

10 PË. Domethënë, është Emri Binak Gashi, e kishim ma vonë
11 komandant të kompanisë tonë; është Sali Salteku, është
12 bashkëfshatar i imi; është Dervish Qadraku, është kushëri i
13 imi; jam unë; është Adem Krasniqi, një bashkëluftëtar i jonë;
14 është Ismail Zena, këtu shkrun Rena, po është Ismail Zena
15 normalisht me mbiemër. Këta janë me çfarë arme si kanë në
16 pronësi. Kurse te unë shkruan Jaguar. Mendoj që ka qenë një
17 gabim shtypi. Ka qenë dasht të shkruajë SIG-Sauer apo diçka në
18 atë drejtim. Mendoj që është një gabim.

19 PY. Thatë që bëhet fjalë për një njësi në fshatin tuaj
20 Radostë, ose në Malësi e Vogël. Ky njësi vetë kishte ndonjë
21 emër?

22 PË. Njësi i jonë i Malësisë së Vogël kishte emrin Kodra.

23 PY. Në këtë faqe shohim që përmenden disa persona 131, thotë.
24 Mesa keni ju dijeni, ka pasur ndonjëherë 131 persona njësi
25 Kodra, ose përafërsisht këtë numër personash?

1 PË. Njësitë Kodra në maksimumin e tij kishte 175 apo 6
2 anëtarë, pjesëtarë. Kurse në atë kohë kur kjo faqe është
3 shkruar, sigurisht që ka pasur 131 pjesëtarë të Ushtrisë
4 Çlirimtare të Kosovës.

5 PY. A ju kujtohet në cilin muaj apo cilët muaj ka pasur rreth
6 131 anëtarë?

7 PË. Kjo ka mundur të jetë në -- meqë ne aty jemi instaluar në
8 maj të '98-s, kjo ma mund të jetë menjëherë në fund maji apo
9 në qershor të vitit 1998.

10 Z. PACE: [Përkthim] Zmadhojmë pak të djathtë, në të
11 djathtë, faqen edhe në anglisht edhe në shqip. Faleminderit.

12 PY. Dëshmitar, është e njëjta faqe, thjesht e djathta. Këtu
13 shohim që përmendet kompania e 1-rë. Dhe ka një listë që në
14 pamje të parë duket sikur janë emra vendesh. I njihni këto
15 emrat që janë poshtë titullit "Kompania e 1-rë"?

16 PË. Po.

17 PY. A ju kujtohet se pjesë e cilit njësit të UÇK-së ishin
18 këto vende?

19 PË. Kompania e 1-rë është pjesë e njësitit të kompanisë -- të
20 fshatit Drenovc, fshatit Senovc, Pastasellë, Polluzhë, Sapniq,
21 Qifllak dhe Dobidol. Kështu shkrun këtu, edhe këta kanë mund
22 të jenë pjesë e këtij, kësaj kompanies së 1-rë që ka operuar
23 në Drenovc.

24 PY. Mesa dini ju, a ka qenë pjesë e kompanisë së 1-rë në
25 1998?

1 PË. Mesa di unë që atëherë nuk janë quajtur kështu me
2 kompani, ka qenë njësitit. Po me sa mbaj mend unë në Drenovc
3 edhe në Zatriq, në Zatriq, maja e Zatriqit ka pasur emrin
4 Kurrizi, Kurrizi, që do të thotë pjesa më e lartë e asaj pjese
5 te ne.

6 PY. Ju thatë që nuk njiheshin me emër kompanitë, po njiheshin
7 si njësi. Po ata njësoj si njësitit juaj që e kishte emrin
8 Kodra, kishin ndonjë nofkë, ndonjë pseudonim, ndonjë emër?

9 PË. Po unë e mendoj, unë mendoj dhe kujtoj se si pjesë
10 gjeografike e kishin emrin Kurrizi. Kurse si pjesë
11 organizative Drenovci ka qenë me një shifër 500-shi. 500-shi
12 duke iu referuar më shumë dëshmorit, apo atëherë që ishte
13 ushtaraku, e pjesë e shtabit, Mensur Zyberaj.

14 PY. Ju thatë që njësitit Kurrizi dhe e përmendët dhe njësitin
15 Kodra. Po ishit pjesë e një grupi të përbashkët apo ishin dy
16 njësite të ndara veçmas nga njëri-tjetri?

17 PË. Ne ishim të ndarë se ne ishim në fshatin tim, Malësia e
18 Vogël të Radostës, ata ishin në Drenovc dhe në Zatriq, mirëpo
19 ishim në tërësi ishim një pjesë, një pjesë e komunës së
20 Rahovecit, domethënë një pjesë e brigadës më vonë që u bë 124.

21 PY. Mund të jeni pak më konkret sa i takon kësaj Brigadës
22 124. Këto dy njësite u bënë pjesë e Brigadës 124 ose të një
23 brigade që më pas mori këtë emër?

24 PË. Po.

25 PY. Cila brigadë ishte kjo?

Dëshmitari: Halil Qadraku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 53

1 PY. Brigada 124, Gani Paqarizi.

2 PY. Po batalione kishte kjo brigadë?

3 PË. Pas dhjetorit të '98-s mendoj që janë arritur që të
4 formohen dhe batalionet dhe kompanitë edhe të gjitha njësitet
5 përcjellëse, por në fillim fare ishim të emërtuar kështu siç
6 thashë unë. Apo unë kaq kisha njohuri.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace,
8 është koha për pushimin.

9 Z. PACE: [Përkthim] Ja të mbaroj dhe këtë dokumentin.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

11 Z. PACE: [Përkthim]

12 PY. Dëshmitar, ju përmendët njësitin Kodra dhe Kurrizi. Këtu
13 përmendet dhe kompania e dytë te kjo faqe. Keni ndonjë dijeni,
14 kjo kompania e 2-të çfarë është?

15 PË. Unë mendoj se kompania e 2-të ka qenë më shumë e
16 koncentruar në fshatin Ratkovc. Ajo kishte më shumë ushtarë,
17 ishte fshat më i madh edhe mendoj se brenda saj ka përfshi
18 vetëm fshatin Ratkovc, ku komandant ka qenë Smajl Latifi.

19 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Tani mund ta heqim
20 dokumentin edhe mund të bëjmë pushimin.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
22 tani do të bëjmë gjysmë ore pushim. Mund të largoheni nga
23 salla e gjyqit. Ju lutem mos bisedoni me askënd për dëshminë
24 tuaj. Do të rishihemi bashkë në orën 11.30.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushim
2 deri në orën 11.30.

3 --- Pauza fillon në orën 11.03

4 --- Seanca rifillon në orën 13.32

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
6 silleni dëshmitarin në sallë, Sekretar.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

10 PY. Dëshmitar, me sa dini ju, çfarë roli ka pas Jakup

11 Krasniqi në UÇK?

12 PË. Simbas njohurive të mia, nga qershori i vitit 1998, Jakup

13 Krasniqi ka qenë zëdhënës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

14 PY. Kur e keni mësuar ju lidhur me këtë, domethënë, këtë

15 rolin që sapo na e përshkruan të z. Krasniqi, kur e keni

16 mësuar, Dëshmitar?

17 PË. Unë mendoj që ka qenë një publikim, një publikim në media

18 ose përmes gazetës ose përmes televizionit, se Jakup Krasniqi

19 është përzgjedhur si zëdhënës i Ushtrisë Çlirimtare të

20 Kosovës. Por data e saktë nuk më kujtohet, as mënyra e saktë

21 nuk më kujtohet.

22 PY. Me sa dijeni keni ju, çfarë roli ka luajtur Sokol Bashota

23 në UÇK?

24 PË. Unë Sokol Bashotën nuk e kam njohur gjatë luftës. Ato çka

25 kam dëgjuar pas luftës, ka qenë se ai ka qenë një pjesë

1 përbërëse e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të
2 Kosovës. Këtë po e them jo nga njohuritë e mia që kam gjatë
3 luftës me shokët e mi, por e kam mësuar pas luftës.

4 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet që gjatë seancës përgatitore
5 keni thënë që ju besoni se keni mësuar që Sokol Bashota ka
6 qenë në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së në vitin 1998?

7 Z. PACE: [Përkthim] Për kolegët e mi, kjo jepet në
8 Shënimin Përgatitor numër 2, në paragrafin 15.

9 PY. Ju kujtohet kjo?

10 PË. Më kujtohet, mund të jetë edhe ashtu. Mund të jetë, por
11 personalisht nuk e kam njohur Sokol Bashotën.

12 PY. A jeni në dijeni në qoftë se z. Bashota është njohur me
13 ndonjë emër tjetër gjatë 1998 ose 1999?

14 PË. Tani jam në dijeni që ai më duket ka pas nofkën
15 Njimbëdhjetëshi. 11.

16 PY. A ju kujtohet se kur e keni dëgjuar për herë të parë këtë
17 nofkën Njimbëdhjetëshi për të?

18 PË. Jo.

19 PY. Në intervistën me ZPS-në ju keni diskutuar që ju keni
20 kaluar në Shqipëri, domethënë, keni shkuar në Shqipëri së
21 bashku me Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe të tjerët më datën
22 16 nëntor 1998. A mund t'i tregoni anëtarëve të Trupit Gjykses
23 përpara këtij rasti, a ke qenë, e ke takuar ndonjëherë Hashim
24 Thaçin përpara se sa të shkonit në Shqipëri?

25 PË. Unë mendoj, unë mendoj se gjatë atyre ecejakeve të mia që

1 kam dalë shpesh nga Kosova në Shqipëri edhe nga Shqipëria në
2 Kosovë, mund edhe ta kem takuar Hashim Thaçin, pa e ditur, pa
3 e njohur se kush është dhe çfarë është brenda UÇK-së.

4 PY. A ju kujtohet se çfarë mund të ketë ndodhur në një rast
5 të tillë që mbase ju e keni takuar z. Thaçi pa e ditur se kush
6 ishte ai në atë kohë?

7 PË. Po. Mendoj që ju kam treguar një insert të një udhëtimi
8 që ka qenë data 30 maj e vitit 1998, datë kjo kur në Kosovë
9 nga Shqipëria kanë hyrë 7 eprorët profesionistë të ish-Armatës
10 Jugosllave. Më kujtohet që në atë udhëtim njëri nga
11 bashkëluftëtarët ka pas nevojë për ndihmë sepse e vrau këmbën
12 dhe e kanë ndihmuar, ia kemi marrë ato armatimet nga krahu.
13 Edhe ma andej më vonë, shumë ma vonë, nuk e di kur, e kam
14 kuptuar se ai ka qenë Hashim Thaçi. Në atë udhëtim ju kam
15 treguar ka qenë edhe Adem Grabovci, që atë e njihja, edhe nga
16 viti 1990. Ka qenë ndoshta edhe Kadri Veseli edhe këta, por që
17 është ai person, Hashim Thaçi, e kam mësuar më vonë.

18 PY. Sikurse përcaktohet në shënimin përgatitor që tani është
19 pranuar në provë gjyqësore, ju keni thënë, Dëshmitar, që në
20 mars të 1998 një person që u vetëprezantua si Dhjetëshi, që më
21 pas ti e mësove që ishte Rexhep Selimi, të tha ty që të shkoje
22 në Drenovc në Rahovec që të takoheshe me Mensur Zyberin, që
23 njihej si Pesëqindëshi, me të cilin ju keni organizuar punën
24 atje.

25 Pyetja ime është kjo, Dëshmitar: A e dini ju në qoftë se

1 Mensur Zyberi, Pesëqindëshi, e njihte Hashim Thaçin?

2 PË. Është e vërtetë. Unë kur kam ardhur nga Zvicra unë nuk
3 kam dit as ku të orientohem, as ku të shkoj. Së bashku me
4 shokun tim Selim Gashin, kemi shkuar, jemi drejtuar për në
5 Drenicë. Edhe pse nuk e njihja Drenicën mirë, nuk e njihja
6 Kosovën mirë, sepse unë shumë pak kam jetuar në Kosovë. Unë
7 kam jetuar në të gjithë, në Kroaci, në Bosnje, në Zvicër,
8 mirëpo në Kosovë shumë pak. Duke pyetur kemi shkuar deri në
9 Likovc. Jemi prezentuar se kush jem, që kemi ardh nga Zvicra,
10 jemi anëtarë të Lëvizjes, që duam të takohemi disa shokë që të
11 mobilizohemi që të punojmë bashku.

12 Edhe mendoj se unë në atë kohë edhe pse nuk e njihja,
13 mendoj se unë jam takuar me Rexhep Selimin, i cili është
14 prezantuar si Dhjetëshi.

15 PY. Po. Edhe një herë, Dëshmitar, do ju kërkoj që të
16 përgjigjeni në pyetjen time. Dëgjoni me vëmendje pyetjen.

17 Pyetja ime konkrete ishte kjo: A e dini në qoftë se Mensur
18 Zyberi, Pesëqindëshi, e njihte Hashim Thaçin?

19 PË. Saktësisht, në atë kohë, a e njihte Mensur Zyberaj Hashim
20 Thaçin, unë nuk e kam kuptuar apo nuk e kam ditur. Mirëpo,
21 vetë fakti se nga Shtabi i Përgjithshëm më thanë që "ti mund
22 të shkosh në Rahovec, atje është Pesëqindëshi dhe veç kërko
23 Pesëqindëshin". Më ka lënë të nënkuptoj se dikush nga ata e ka
24 njohur, por për këtë lidhje direkte e njef Hashim Thaçi Mensur
25 Zyberajn në atë kohë, unë nuk e dija atëherë. Se nuk e njifja

1 as Hashim Thaçin e as Mensur Zyberajn.

2 PY. A e mësove ti ndonjëherë në qoftë se Mensur Zyberaj ishte
3 shok me Hashim Thaçin? E ke marrë vesh ndonjëherë një gjë të
4 tillë?

5 PË. Po përflitej. Mandej ne kemi qëndruar shumë, kemi
6 bashkëjetuar gati me Mensur Zyberajn sepse na lidhte, na
7 lidhte i njëjti terren. Flitej se janë njohur, se kanë qenë së
8 bashku në studime, kaq. Ndoshta dhe ai më ka treguar vetë. Nuk
9 e mbaj mend.

10 PY. A e dini në qoftë se Kadri Veseli e njihte apo ishte shok
11 me Mensur Zyberajn, me Pesëqindëshin?

12 PË. Besoj, mendoj, që është e njëjta gjë si me Hashim Thaçin,
13 si me Kadri Veselin në raport me Mensur Zyberajn. Mendoj se
14 kanë qenë një gjeneratë. Mendoj se edhe organizimi ka shku në
15 bazë të besueshmërive dhe kjo të len të kuptoj se ata i kanë
16 besuar Mensurit në bazë të njohurive që kishin.

17 PY. Përveç përmendjes së takimit me Rexhep Selimin në mars të
18 vitit 1998, në seancën përgatitore që tani është pranuar si
19 provë gjyqësore, ju keni thënë gjithashtu që jeni takuar me të
20 më datë 26 prill 1998 kur keni diskutuar për pritën në afërsi
21 të Prizrenit që ka ndodhur më herët në atë ditë. Dhe keni
22 diskutuar me të lidhur me UÇK-në për të bërë publike në
23 Drenovc. Pyetja që kam për juve është kjo: A ju kujtohet në
24 qoftë se jeni takuar ose në qoftë se keni parë Rexhep Selimin
25 në një rast tjetër përveç këtyre dy rasteve që unë ju përmenda

1 në 1998 apo 1999. E keni takuar Rexhep Selimin ndonjëherë
2 përveç këtyre dy rasteve?
3 PË. Mua më duket se e kam takuar Rexhep Selimin një apo dy
4 raste duke hyrë nga Shqipëria në Kosovë, ju kam thënë se unë
5 nga Kosovë-Shqipëri kam udhëtuar mbi 35-36 herë në orientimin
6 e grupeve për armatosje. Edhe një herë e mbaj mend që ishte
7 ose qershori ose korriku. Jemi nisur nga Shqipëria,
8 përkatësisht nga Dobruna, me një grup jo shumë të madh, por në
9 atë grup ka qenë edhe Rexhep Selimi, e mbaj mend edhe
10 Xhelajdin Gashi, Plaku, i cili për shkak se, unë mbaj mend,
11 domethënë, që i cili, gjatë rrugëtimit, është lodhur edhe pati
12 nevojë për ndalim.

13 E mbaj mend se jemi ndaluar. Domethënë, e mbaj mend se
14 jemi takuar edhe gjatë rrugëtimeve Shqipëri-Kosovë, një apo
15 dy, apo më shumë raste.

16 PY. Për të qenë të qartë, Dëshmitar, kur flisni për qershorin
17 apo korrikun, qershor, korrik e keni fjalën për vitin 1998,
18 apo jo?

19 PË. Po. Gjithmonë qershori dhe korriku përcaktojnë 1998 sepse
20 në 1999 ishte liria.

21 PY. Përveç Xhelajdin Gashit, që njëhej ndryshe si Plaku, a ju
22 kujtohet ndonjë person tjetër që ka qenë me Rexhep Selimin në
23 këtë rast kur e keni parë duke kaluar?

24 PË. Nuk mund, nuk mund të kujtoj, nuk mund të kujtoj. E di që
25 kanë qenë disa djem të rinj që ishin në Tiranë, që kanë

1 ndihmuar si pjesë e UÇK-së, kanë ndihmuar logjistikën atje.

2 Nuk u mbaj mend as emrat e atyre djemve, por -- se zakonisht
3 nuk pyesnim shumë, por me ndonjërin na bënte vetë situata të
4 flisnim apo të njiheshim.

5 PY. A ju kujtohet në këtë rast ose këto raste kur e keni
6 takuar ose e keni parë z. Selimi, pra, a ju kujtohet se nga ku
7 po vinte ai ose në çfarë drejtimi po shkonte konkretisht në
8 këto raste kur e keni parë?

9 PË. Jo, zotëri. Unë nuk kam pas të drejtë askënd ta pyes se
10 nga vjen edhe ku shkon, por detyra ime ka qenë që të shkoj nga
11 Kosova në Shqipëri në Cahan apo Krumë. Edhe mbas një dite të
12 kthehem nga Cahani prapë në Kosovë. Kaq ka qenë e imja në atë
13 kohë.

14 PY. A keni pasur ndonjë zëvendës, një zëvendës ose disa
15 zëvendës kur ju keni marrë pozicionin e drejtuesit të G2
16 brenda zonës operative të Pashtrikut në vitin 1999, në janar
17 të këtij viti?

18 PË. Po. Unë kam qenë shef i të dy sektorëve, sektorit të
19 zbulimit dhe sektorit të kundërzbulimit. Shef i sektorit të
20 zbulimit ka qenë deri më 2 maj Xhavit Bajraktari. Pas vrasjes
21 së tij atë e ka zëvendësuar Isuf Krasniqi, Mësuesi. Kurse në
22 sektorin e kundërzbulimit, ka qenë Nezir Çoçaj. Unë kam qenë
23 shef i zbulim-kundërzbulimit, të dyve.

24 PY. Përveç personave që ju sapo përmendët, a ishte ndonjë
25 person tjetër që ka punuar ose ka qenë anëtar i njësitit G2 në

Dëshmitari: Halil Qadraku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 61

1 zonën operative të Pashtrikut?

2 PË. Po. Që nga marsi, që nga shkurti i 1999, ka qenë edhe
3 Shefkije Gashi apo Peka Gashi, pjesë e zyrës tonë.

4 PY. Në çfarë roli?

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Përpara se të vazhdoni më
6 tej, z. Pace, mendoj që ka një gabim te transkripti. Është
7 shkruar keq emri i shefit të sektorit të zbulim-
8 kundërzbulimit, që ishte Nezir Çoçaj. A mund të pyesni
9 dëshmitarin që ta sqarojë një çikë këtë gjë?

10 Z. PACE: [Përkthim]

11 PY. Dëshmitar, më parë, pak më përpara kur ju thatë që ishit
12 shefi i kundërzbulimit, ky person ishte Nezir Çoçaj, apo jo?
13 Sa për sqarim për procesverbal, se nuk është shkruar mirë. A
14 është kështu?

15 PË. Po.

16 PY. Faleminderit. Më pas unë ju bëra pyetje se çfarë roli
17 kishte Shefkije ose Peka Gashi në njësitin tuaj në vitin 1999,
18 në shkurt të këtij viti?

19 PË. Peka në atë kohë kishte rolin e analizave edhe të
20 përshkrimit të situatave apo të formave që ne kishim nevojë të
21 raportonim, apo të mësonim.

22 PY. A mund t'i thoni Gjykatësve se çfarë roli keni pasur ju
23 si shef i G2 në zonën operative të Pashtrikut, domethënë,
24 çfarë detyrash kishit ju në këtë rol si shef i G2?

25 PË. Detyra ime, që nga janari kur e kam marrë, kur e kam

1 pranuar këtë detyrë, ka qenë ruajtja, mbrojtja e të gjitha
2 formacioneve tona ushtarake dhe territorit sado të lirë që ku
3 ne operonim, që ta ruajmë dhe ta mbrojmë nga armiqtë dhe ata
4 që duan të na bënë dëm neve.

5 PY. A mund t'u thoni anëtarëve të Trupit Gjykues se si keni
6 përmbushur ose si i keni plotësuar ju këto detyra ose rolin
7 tuaj, sikurse na e përshkruat deri tani?

8 PË. Po. Fillimisht, zotëri Gjykatës, kur unë e mora këtë
9 detyrë, kam ardh në Kosovë edhe asgjë, asgjë nga ky sektor nuk
10 ishte i formuar mbrenda, mbrenda zonës operative të Pashtrikut
11 ku unë isha emëruar. Mbrenda të gjithë atyre brigadave që
12 operonin brenda vendit, sepse ishin përafërsisht pesë brigada
13 që operonin brenda vendit. Edhe kam tentuar shumicën e kohës
14 që të bëjmë organizimin, plotësimin, emërim, e sektorëve nga
15 lart teposhtë. Nuk kishim kohë të mjaftueshme për të realizuar
16 këtë, sepse ndodhën shumë gjëra, ndodhën shumë luftime,
17 ndodhën shumë operacione.

18 Por detyra ime ka qenë në atë kohë përafërsisht
19 konsolidimi dhe organizimi i sektorit tim nga zona operative e
20 Pashtrikut e teposhtë ndër brigada e batalione e kompani.

21 PY. Roli juaj si drejtues i G2 në zonën operative të
22 Pashtrikut a përfshinte dhe mbledhjen e informacionit,
23 Dëshmitar?

24 PË. Roli im ka qenë grumbullimi i secilit informacion që të
25 kemi të qartë me çfarë, me çfarë disponojmë, si në njerëz, si

1 me ata me çfarë ishim të rrethuar, sepse ne ishim të rrethuar
2 me shumë forca armiqësore. Prandaj, në këtë aspekt roli im ka
3 qenë grumbullimi, analizimi edhe raportimi apo njoftimi i
4 komandantit tim, komandantit tim që atëherë ishte Drini, e më
5 vonë Tahir Sinani, për situatën që na rrethonte në secilin
6 vend, në secilën brigadë, aty ku kam arritur të veproj edhe të
7 manovroj.

8 PY. Më herët ju përmendët zëvendësin tuaj. Në fillim ishte
9 Xhavit Bajraktari i zëvendësuar nga Jusuf Krasniqi që ju thatë
10 që ishte përgjegjës i zbulimit. Dhe përveç kësaj, përmendët
11 edhe Nezir Çoçajn i cili ishte përgjegjës për kundërzbulimin.
12 A mund të na thoni se çfarë dallimi kishte roli i këtyre
13 personave, domethënë, çfarë roli kishte personi që ishte
14 përgjegjës për zbulimin dhe çfarë roli kishte personi që ishte
15 përgjegjës për kundërzbulimin, dhe që të dy ishin nën
16 hierarkinë tuaj, ose nën drejtimin tuaj? Mund të na e
17 shpjegoni këtë, Dëshmitar?

18 PË. Në kushtet normale, sektori i zbulimit bën zbulimin e
19 forcave të armikut nga të cilat ishim të rrethuar. Bën
20 vlerësimin e armikut, bën vlerësimin e rrezikshmërisë nga mund
21 të na vijë ndonjë rrezik nga mund të na vijë ndonjë fatkeqësi.
22 E cila ndër vete përfshin tashti shumë gjëra në këto.

23 Kurse sipas mendimit tim, simbas asaj që më ka folur vetë
24 komandant Drini se çfarë është detyra ime e këtij sektorit, në
25 atë kohë, ishte që, domethënë, kundërzbulimi kishte detyrë që

1 të ruante territorin tonë, që të ruante vendet ku ishim ne,
2 nga elementë jo të uniformuar, por që ishin ndoshta edhe më të
3 dëmshëm se forcat ushtarake të armikut.

4 PY. A mund të na e sqaroni se çfarë doni të thoni që edhe
5 këto më të rrezikshme që ju thoni jo nga elementë me uniforma,
6 por me uniformë, elementë jo me uniforma, dhe që mund të ishin
7 edhe më të rrezikshëm. Na e shpjegoni pak kush mund të ishin
8 këta elementë që mund të ishin edhe më të rrezikshëm?

9 PË. Do të mundohem t'ju sqaroj pak në disa pika të shkurtra,
10 por elementi jo i uniformuar që i shërben kundërshtarit ose që
11 i shërben armikut kanë mund të jenë vetë punëtorët e atyne
12 shërbimeve që operonin në Kosovë. Se deri në atë kohë kishte,
13 domethënë, shumë shërbime edhe brenda okupatorit serb, i cili
14 ishte shumë i sofistikuar, i cili ka përdor të gjitha mjetet e
15 mundshme, të gjitha mjetet e mundshme, e edhe civilen, për të
16 zbuluar apo për të ditur çfarë force ka, për shembull, UÇK-ja
17 në fshatrat ku ishim ne të stacionuar. Kanë mund të dërgojnë
18 vëzhgues në formë të, civile, që të na numërojnë sa veta jemi,
19 kah i kemi të pozicionuar forcat tona, kah i kem fjetoret,
20 pjesën e armatimit. Ne nuk kishim ndonjë njohuri paraprakisht
21 se kënd do ta dërgonin, por ruheshim nga ata që veç ishin të
22 potencuar, që punonin dhe që ishin në shërbim të forcave
23 jugosllave edhe pse ishin shqiptarë. E që kishte shumë.

24 E në këtë drejtim, mendoj që kundërzbulimi ka qenë dasht,
25 ka qenë dasht të dijë edhe informohet për këto, për këto

1 njohuri.

2 PY. Ju sapo deklaruat që:

3 "Elementët pa uniformë që i shërbenin armikut ose forcës
4 kundërshtare, mund të përfshinin punonjësit brenda atyre
5 forcave që funksiononin në Kosovë në atë kohë. Dhe kishte
6 shumë shërbime të tilla të ngjashme brenda forcës okupuese
7 serbe ..."

8 A mund të na jepni disa shembuj të këtyre shërbimeve ku
9 punonin ose me të cilët bashkëpunonin persona të tillë?

10 PË. Brenda strukturave të organizuara të shtetit serb ka pas
11 shumë struktura ilegale, shumë struktura të hapura që ishin
12 pjesë e UDB-së, që ishin pjesë e sigurimit shtetëror që ishin
13 pjesë e milicisë serbe, ose ish-pjesëtarë të milicisë serbe,
14 sepse ata kanë shfrytëzuar të gjitha resurset e tyre, ose me
15 dëshirë, ose edhe me shantazh dikujt kanë mujt me i, që t'i
16 shantazhojnë, por ka pas elemente, ka pas elemente shqiptare
17 brenda tyre, edhe pse ishin, edhe pse ishin strukturë serbe,
18 strukturë okupatore.

19 PY. Nga e dinit ju këtë, pra që ka pasur elementë shqiptarë
20 brenda këtyre strukturave?

21 PË. Zotëri Gjykatës, ata sigurimi shtetëror në ato vende ku
22 kam jetuar unë, Rahovec, Prizren, edhe qytete të tjera, të
23 gjithë pjesëtarët e UDB-së kanë qenë shqiptarë. Brenda UDB-së
24 ka pas disa, për shembull nja, veç Prizreni ka pas 10 apo 12,
25 edhe të gjithë ishin turpërisht shqiptarë. Për të cilët më

1 vjen turp, mua për ta, e ata sot edhe pse sot ndihen krenarë
2 për atë punë që kanë bërë, por kanë qenë pjesë e UDB-së deri
3 vonë. E ashtu kishte edhe Rahoveci, e ashtu kishte edhe qytete
4 të tjera. Ata janë me emra e mbiemra, i njeh bota, i njeh
5 Kosova. I njihni edhe ju, ndoshta.

6 PY. A mund ta sqaroni nëse këta elemente shqiptarë, brenda
7 këtyre strukturave, ishin personat që ju i njihnit në vitin
8 1998 dhe 1999?

9 PË. Ata ishin persona që ne i njihnim me emër, por jo me, jo
10 me figurë, jo me miqësi, jo me shoqëri, jo me asi -- por emra
11 kishin sepse ishin persona të deklaruar në të gjitha, në të
12 gjitha, ata nuk e kanë fshehur veten kurrë, për atë që ishin.

13 PY. Këtyre personave ua dinit emrat në 1998 dhe 1999?

14 PË. Atyre personave ua kemi ditur emrin, emrat edhe para
15 1998, edhe para 1999, gjatë aktiviteteve tona politike që kemi
16 bërë në Kosovë e jashtë vendit.

17 Z. PACE: [Përkthim] Do kërkoja që të vendoset në ekran
18 materiali me numër SPOE00052989-00053037, dhe do shohim faqen
19 e parë që për momentin është vetëm në shqip.

20 PY. Dëshmitar, a e keni parë ndonjëherë më përpara këtë
21 dokument, pra përpara se t'jua tregoja unë gjatë seancës
22 përgatitore?

23 PË. Jo, nuk e kam parë.

24 Z. PACE: [Përkthim] Shkojmë në faqen SPOE00053011, dhe
25 përbri të shfaqet dhe anglishtja, që është me numër

Dëshmitari: Halil Qadraku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 67

1 SPOE00052992-SPOE00053035-ET Revised, dhe këtu do të shohim të
2 njëjtën faqe. Nuk jam i sigurt a është siç duhet dokumenti në
3 të djathtë. A mund ta shikojmë edhe një herë anglishten që
4 përfundon me -ET Revised? Dhe një herë, numri është
5 SPOE00052992-SPOE00053035-ET Revised. Shqipja me të njëjtin
6 numër, ju lutem, që përfundon me 53011.
7 PY. Dëshmitar, do t'ju lexoj pyetjen e tretë dhe përgjigjen
8 dhe më pas unë do t'ju bëj disa pyetje.

9 "Baton Haxhiu: Cilat kanë qenë përgjegjësitë e SHIK-ut
10 dhe qëllimet e SHIK-ut në atë kohë?

11 "Kadri Veseli: Qëllimi i G2 ka qenë marrja e
12 informacioneve nga lëvizjet e armikut. Njëkohësisht G2 ka
13 pasur strukturën e vet të ndarë në njësi, brigada, batalione,
14 kompani, e deri te njësitë zbuluese të cilat kanë pasur për
15 detyrë të marrin informacione për lëvizjet e armikut, kanë
16 pasur për detyrë që të bëjnë veprime konkrete në shërbim të
17 luftës çlirimtare siç është mbrojtja, por edhe atakimi."

18 Dëshmitar, përgjigjja që sapo lexova, a përputhet dhe me
19 dijeninë që keni pasur ju sa i takon detyrave të G2 dhe të
20 strukturës së zbulimit të UÇK-së gjatë kohës kur keni qenë dhe
21 ju anëtar në 1998 -- në 1999, më falni?

22 PË. Po.

23 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë
24 pranimin e faqes që sapo pamë, që është me numër 52989 në
25 shqip vetëm, dhe më pas 53011 në shqip bashkë me përkthimin në

1 anglisht.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
3 kundërshtime?

4 Z. DIXON: [Përkthim] Të njëjtin kundërshtim. Është
5 çështje peshe, ju e thatë. Por ne mendojmë që kësaj duhet t'i
6 jepet shumë pak peshë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
8 Ka gjë tjetër?

9 Pranohet.

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faqja me numër, faqet me
11 numër SPOE00052989 në shqip dhe SPOE00053011 si në anglisht
12 dhe në shqip do të marrin numrin e provës P01859, dhe
13 klasifikimi është publik. Faleminderit.

14 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, mund ta heqim
15 dokumentin nga ekrani.

16 PY. Dëshmitar, anëtarët e UÇK-së, a e kishin për detyrim të
17 raportnin informata që lidheshin për shembull me pozicionet
18 dhe lëvizjet e armikut?

19 PË. Po. Të gjithë ata që rrethoheshin, që ishin,
20 gjeografikisht qëndronin pranë, pranë vendeve nga mund të na
21 vijë rreziku, ishin të obliguar të raportnin në, tek eprorët
22 e tyre më të afërt.

23 PY. Në intervistën me ZPS-në thatë që zbulimi i
24 bashkëpunëtorëve për të kuptuar dëmin që i kishin bërë
25 ushtrisë gjatë luftës, normalisht ka qenë një prej detyrave

1 tuaja në sektorin e G2. Po ashtu përmendët disa nga detyrat që
2 keni pasur lidhur me personat që thatë se ishin zëvendës.

3 Tani, a mund t'ju tregoni Gjykatësve se si i keni kryer
4 ju detyrat sa i takon zbulimit të bashkëpunëtorëve?

5 PË. Neve nuk kem mundur t'i kryejmë detyrat, se nuk është ajo
6 një detyrë shtëpie, mirëpo ne kemi jetuar së bashku me
7 popullin. Ne aty ku kemi qenë ne të stacionuar përreth kishim
8 përafërsisht 30-40 fshatra që bashkëjetonin me ne, që kishim
9 të njëjtin fat, që ishim të rrezikuar nga i njëjti armik.

10 Kështu që vetë popullata civile, vetë njerëzit me të
11 cilët ne rrethoheshin, ata na ndihmonin duke ndihmuar edhe
12 veten, me ndonjë, me ndonjë -- na ndihmonin ata, edhe
13 ndihmonin edhe veten, duke kërkuar nga ne që të kemi kujdes që
14 mos të hyjnë në territoret tona ndonjë që ata mendonin se
15 ishte në -- i orientuar kundër nesh, për ata njerëz si
16 bashkëpunëtorë që po i quani ju, unë ata njerëz nuk kam mundur
17 nëse i kam njohur si emra, që e thashë më parë, por nuk kam
18 mundur t'i njoh njerëzit tjerë sa që i ka njoftur populli.
19 Kështu që të gjitha informacionet ne i kemi pasur, i kemi
20 pasur nga, edhe nga popullata civile që bashkëjetonte dhe
21 jetonte me ne, por dhe nga njerëzit tanë si ushtarë që ishin
22 në bazë të atyre që kishin parë, apo çka dinin. Secilin
23 informacion na e kemi grumbullu, e kemi analizuar, edhe i kemi
24 dhanë një peshë apo s'e kemi dhanë fare asnjë peshë sepse nëse
25 nuk ka qenë, nuk ka qenë e vlefshme për ne.

1 PY. A mund t'u tregoni Gjykatësve si apo në çfarë formati ua
2 raportonin civilët këtë informacion ju personalisht apo
3 njësitit tuaj?

4 PË. Po unë mund t'ju them që ka pas mundësi që të, të na e
5 sjellë me shkrim, me shkrim dore. Ka pas mundësi kur ishim ne,
6 kur isha unë, në fakt, ose ata vartësit e mi, kur ishin në
7 zyrë, kanë pas mundësi të vinin personalisht edhe të na
8 tregojnë se kanë parë një njeri që ishte, që simbas mendimit
9 të tyre, që ishte një bashkëpunëtor i një pjese të udb-së
10 nëpër qytete. Ka mund ta sjellë atë informacion ose fizikisht
11 ose me shkrim.

12 Domethënë, këtu tani nuk di çfarë t'ju them, por ka pas
13 mënyra shumë të ndryshme të sjelljes së atyne informacioneve
14 që ata kanë menduar që janë të vlefshme dhe që ne duhet t'i
15 dimë.

16 PY. A mund t'u tregoni Gjykatësve lidhur me këto informacione
17 që u jepnin civilët me shkrim, çfarë informacionesh, çfarë
18 hollësish përmbanin këto dokumente për personat në fjalë?

19 PË. Sot në këtë kohë, nuk mund t'ju them diçka specifikisht,
20 mirëpo, unë z. Gjykatës, kur jam arrestuar unë e kam pas një
21 dokumentacion shumë të madh. Është me mua bashkë është
22 arrestuar edhe ai dokumentacioni për afërsisht 300-400 kg
23 dokumentesh të organizuara në regjistra, në të cilat e kam pas
24 përshkruar përçdoditshmërinë e punës time gjatë luftës.

25 Ato dokumente gjatë arrestimit tim të vitit 2001 janë

1 përkthyer nga të gjithë përkthyesit për policinë e UNMIK-ut
2 edhe EULEX-it. Janë të analizuara të gjithë nga ata hetues e
3 gjykatës që kanë qenë të instaluar në Kosovë nga viti 2000
4 deri në vitin 2008. Kështu që sot unë jam hendikep para jush,
5 hendikap pa ato dokumente, se po të ishin ato dokumente do t'i
6 kishim të gjithë bashkë, do t'i kishim lexuar të gjithë
7 bashkë. Do t'i kishim analizuar të gjitha bashkë.

8 Edhe kështu që sot, sot nuk di çfarë t'ju them z.
9 Prokuror, për atë çfarë më pyetët që çfarë specifikisht.
10 Specifikisht kam shkruar, kam marrë secilin informacion që më
11 është ofruar, që kam menduar se do të na bëjë dëm.
12 PY. A mund t'i tregoni Trupit Gjykses, por në terma më të
13 përgjithshëm, kur vinte një person civil dhe ju jepte ju
14 informata për një person që dyshohej se ishte bashkëpunëtor,
15 çfarë shkruanin, a shkruanin vetëm emrin e personit a
16 shkruanin diçka më shumë? Çfarë thonin?

17 PË. Po kur vinte dikush për shembull, tash, sikur ju po thoni
18 si shembull, që do ta marr një shembull. Në qoftë se vinte
19 dikush edhe më thonte se "filan njeri unë e di që është
20 bashkëpunëtor i UDB-së, unë e di që takohet edhe punon për
21 filan fistekin, filan fistekin, në Prizren, ose në Rahovec,
22 ose në Suharekë", unë e kam marrë atë emër e kam diskutu
23 ndoshta edhe me dikënd tjetër edhe atë emër jau kam dhanë
24 rojeve tona ku qëndronin në vija të para të armikut, që
25 kufizoheshim ne me ta, që atë njeri mos ta lejojnë të hyjnë në

1 ato territore ku ishim ne që ai mos të na zbulojë apo mos të
2 na, mos të na i identifikojë forcat edhe vendndodhjet tona.

3 Qe një shembull specifik është ky, por jo
4 domosdoshmërisht secilin emër që ma kanë sjellë e kam bërë në
5 këtë mënyrë. Duhet të ketë pak më shumë, pak më shumë biografi
6 edhe veprimtari ai njeri, që unë ta jap atë emër te rojet që,
7 i cili duhej të ruajë territorin tonë.

8 PY. Kur u përgjigjët po diskutonit një situatë për shembull,
9 unë e kuptoj kur dikush ju thoshte me gojë për një person,
10 mund të ishte bashkëpunëtor. Por pak më përpara ju thatë që
11 këto raportime bëheshin ndonjëherë me gojë, ndonjëherë me
12 shkrim. Unë doja të dija më konkretisht për këto raportet me
13 shkrim. Kur një person ju raportonte ju me shkrim, lidhur me
14 një person që dyshohej se ishte bashkëpunëtor, çfarë lloj
15 informacioni përfshinte ky raport?

16 PË. Nuk di tash specifikisht ta them, mirëpo në përgjithësi
17 ishte për punën e tij, për historikun e tij, për punën e
18 deriatëhershme çka ai kishte njohuri apo nuk, nuk jam në
19 mundësi sot t'ju them diçka specifikisht për këtë. Mirëpo
20 secili informacion i, mendoj se duhej analizuar, duhej
21 rishikuar, duhej marrë me një përgjegjësi shumë të madhe sepse
22 rrezikshmëria ishte e lartë, shumë afër i kishim armiqtë.
23 Ishim të rrethuar ngado me armiq. Kështu që secili informacion
24 në këtë aspekt për neve ishte i mirë, ishte i mirë që të na
25 ndihmonte në ruajtjen e radhëve tona.

1 PY. Tani po flasim për civilët që jepnin informacione për
2 personat të dyshuar si bashkëpunëtorë. Tani do të doja të
3 flisnim për anëtarët e UÇK-së që po ashtu jepnin informacione
4 të tilla. Dhe pyetja ime konkretisht është kjo, këta anëtarë
5 të UÇK-së si ua jepnin informacionin ju personalisht apo
6 njësitit tuaj për personat të dyshuar si bashkëpunëtorë?
7 PË. Nuk e -- ushtarët si na jepnin? Ju thamë më parë se
8 ushtarët, ata që ishin në vijat e para kanë pas për detyrë që
9 t'i raportonin komandantëve të tyre të kompanisë apo të
10 batalioneve. Nëse edhe pse nuk kanë arritur kurrë të formojnë
11 sektorin e zbulim-kundërzbulimit në kompani, në batalion, e në
12 disa brigada vetëm, vetëm S1 apo vetëm shefi i sektorit të G2.
13 Kështu që ne nuk kemi pasur hapësirë, z. Gjykatës, se nga
14 8 janari kur e kam marrë unë këtë detyrë, deri më 12 qershor
15 kur ka përfundu lufta, janë pesë muaj e katër ditë. Dhe për
16 pesë muaj e katër ditë ne brenda këtyre pesë muajve e katër
17 ditëve kemi pas shumë, gjysma ma tepër e kohës ka shkuar nëpër
18 ofensiva dhe luftime. Kështu që ne nuk kemi arritur as të
19 konsolidohemi e as të veprojmë si një strukturë e organizuar
20 mirë në këtë sektor. Dhe shumë më vjen keq që nuk e kemi pasur
21 kohën e mjaftueshme për ta konsoliduar këtë sektor.
22 PY. Dëshmitar, nuk jam i sigurt a u përgjigjët tamam, por unë
23 do ta zbërthej pyetjen time. Ju pak më herët thatë se përveç
24 civilëve dhe vetë ushtarët të UÇK-së na jepnin informata për
25 persona të dyshuar si bashkëpunëtorë, kështu?

1 PË. Po.

2 PY. Tani, folëm për civilët se si e merrnit informacionin,
3 thatë herë me gojë e herë me shkrim. Tani, përqendrohemi vetëm
4 tek ushtarët e UÇK-së. Ushtarët e UÇK-së, informacionin ua
5 jepnin me gojë, ua jepnin me shkrim, apo ua jepnin në ndonjë
6 formë tjetër?

7 PË. Varësisht. Nëse unë shkoja t'i vizitoja atje ku ata
8 ishin, kanë mundur të ma japin informacionin me gojë. Mirëpo
9 nëse ka ardhur nga poshtë përmes batalionit, përmes brigadës,
10 ka ardh te shefi i shtabit në zonë, atëherë shefi i shtabit në
11 zonë na ka treguar komplet neve zonën, edhe ne kemi marrë atë
12 informacion.

13 Domethënë, ka mund të vijë në shumë mënyra informacioni
14 nga ushtari deri te ne. Nuk ka qenë vetëm dy mënyra, gojore
15 edhe me shkrim. Ka mujt edhe përmes dikujt apo si, kështu siç
16 e shpjegova unë.

17 PY. UÇK-ja, kishte postblloqe në zonën operative të
18 Pashtrikut?

19 PË. UÇK-ja ka pasur postoblloqe, pasur postoblloqe në ato
20 vende ku dyshohej, ku dyshohej që mund të hynin njerëzit të
21 paautorizuar në vendet ku operonim edhe ku ne ishim të
22 stacionuar. Këto postoblloqe kanë qenë për legjitimim edhe për
23 ta ruajtur territorin tonë për aq kohë sa ne kemi qëndruar në
24 ato. Pra, përgjigja është, po.

25 PY. Me sa ju kujtohet ju, këto postoblloqe, këto pika

1 kontrolli, kur janë ngritur për herë të parë në zonën tuaj të
2 Pashtrikut?

3 PË. Për herë të parë janë ngritur në hyrje të fshatit
4 Drenovc, më 26 prill 1998. Ka qenë postoblloku i parë që mos
5 të lejohen forcat serbe të hyjnë në fshatin Drenovc. Aty kemi
6 dalë ne për të parë, meqë e përmendët më herët atë aksionin ku
7 kanë ra në pritë shokët. Kështu që, postoblloku i parë në
8 zonën operative të Pashtrikut ka qenë në fshatin Drenovc më 26
9 prill 1998.

10 PY. Në anglisht është përkthyer, të paktën në anglisht këtu
11 është përkthyer sikur keni thënë që:

12 "Këto postoblloqe ishin për të identifikuar personat dhe
13 për të mbrojtur apo për të ruajtur territorin tonë ..."

14 A mund t'u shpjegoni Gjykatësve se çfarë ishte ky
15 identifikim në praktikë? Çfarë bënin personat në këto
16 postoblloqe? Kontrollonin ata që hynin e dilnin, apo si, çfarë

17 PË. Ata persona në ato postoblloqe për shembull tashti, meqë
18 e mora shembull postobllokun e parë të fshatit Drenovc, ata
19 çdokënd që e kanë parë që do të hyjë në fshatin e tyre në
20 Drenovc, do ta kishin ndaluar, do ta kishin legjitimuar. Nëse
21 do të ishte i fshatit të tyre do ta kishin njohur, do ta
22 kishin përcjellur. Por nëse do të ishte i huaj, duhej të
23 pyetej ku do shkosh, ku po shkon, kah. Në kohë lufte, ku shkon
24 ti në këtë territor, domethënë, që kishte, që ishte i atakuar
25 nga forcat serbe. Po kështu që këtë detyrë ka pas postoblloku.

1 Ruajtjen, ruajtjen e informacioneve tona, por ruajtjen edhe të
2 fshatit në tërësi aty, sepse ishte plot me civilë.

3 PY. U jepej ndonjë informacion personave që ruanin
4 postblloqet. Për shembull, u thuhej kë duhej të lejonin e kë
5 nuk duhej të lejonin që të kalonte?

6 PË. Me zhvillimin e luftës, domethënë, që ditën e parë mund
7 të them, ditën e parë asnjë roje në Drenovc nuk ka pas asnjë
8 emër, sepse ishte dita e parë, nuk dinim as nga kush të
9 ruheshim as si të ruheshim, por vetëm e dinim që duhet ruajtur
10 nga armiku. Ditën e parë nuk ka pas asnjë emër. Por me
11 zhvillimin e kohës, varësisht nga situata që ka ndodh në
12 rrethin tonë, me njerëz tanë, me popullatën tonë, normalisht
13 që do ta kishim shkruar edhe në ndonjë emër të padëshiruar të
14 cilin s'do ta kishim qejf, ta kishim në mesin tonë në ato
15 kohëra lufte, në ato kohëra të rrezikshme.

16 PY. Çfarë ndodhte me këto emra? U jepeshin personave që bënin
17 roje në postbllok apo çfarë?

18 PË. Po, mendoj që, mendoj që u jepeshin atyre që, ata emrat
19 qëndronin aty në postbllok, pavarësisht se sa roje do të
20 ndërroheshin. Edhe pse rrallë ndonjë postobllok ka arrit që të
21 mbijetojë sepse kudo që ishim forcat serbe kanë ndërmarre
22 shumë ofensiva kundër nesh, shumë sulme kundër nesh. Shumë
23 shpesh i ndërronim ato postblloqe, shumë shpesh ndërronim
24 territore, shumë shpesh ndërronim fshatra. Mirëpo, aty ku
25 ishin ata me çdo kusht janë munduar që të mbrohen, të mbrojnë

1 popullatën civile edhe veten nga elementët që ishin të
2 përcaktuara si kundërshtarët tanë.

3 PY. A mund ta sqaroni kush ua jepte këto emra personave që
4 bënë roje në postbllok?

5 PË. Po sot të flasësh në vitin 2024 për atë që kush ua jepte
6 emrat, nuk mund ta gjesh një njeri apo një grup njerëzish kush
7 jepte emra. Mirëpo, duke e ditur se atëherë, për shembull, do
8 të flas, po e marr gjithmonë fshatin Drenovc, se ishte fshati
9 i parë që kemi dalë aty në, duke e ditur se Drenovci ishte
10 bërë tashti si një lloj, si një lloj qendre e Ushtrisë
11 Çlirimtare të Kosovës për komunën tonë, të gjithë njerëzit
12 liridashës, të gjithë njerëzit që donin lirinë, mundoheshin me
13 forma të ndryshme të na vinin, të na vizitonin, të na
14 tregonin, të na thonin çka po ndodh në ato vende ku ne nuk
15 ishim prezentë. Për shembull, vinin në Drenovc, na tregonin çka
16 ka ndodh në Rahovec, çka ka ndodh në Prizren, çka kanë parë ata
17 me sytë e vet. Të gjitha këto informacione bënë mandej një
18 tërësi, nga ajo tërësi e nxirrje një lloj, një lloj
19 përmbledhje të atyre gjërave. Kështu që me kohën, me kohën
20 dilshin edhe ndonjë emër, dilke edhe ndonjë ngjarje çka pas.

21 PY. Që të jemi të qartë, ju personalisht apo anëtarët e G2 në
22 zonën tuaj të Pashtrikut, nga janari 1999 u kanë dhënë emra të
23 personave që nuk duhet të kalonin postblloqet, rojeve që ishin
24 në postbllok?

25 PË. Po, besoj që po. Besoj që po.

1 Z. PACE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit që të
2 paraqesë në ekran provën P00500 përbri provës P00500-ET.
3 PY. Dëshmitar, do kalojmë në një temë tjetër tani. Do t'ju
4 tregoj një dokument, besoj që e shikoni versionin në shqip
5 përpara në ekranin që keni. Kemi dhe versionin në anglisht
6 tani.

7 Z. PACE: [Përkthim] Kështu që do i kërkoja Sekretarit që
8 ta zvogëlojë dimensionin e deklaratës në mënyrë të tillë që të
9 shikojmë të gjithë faqen si në shqip ashtu dhe në anglisht.
10 PY. Për momentin, Dëshmitar, do ju kërkoja që të shikonit
11 faqen që keni në ekran.

12 Z. PACE: [Përkthim] Dhe Sekretarit do i lutesha që të
13 kalonim tek faqja e dytë e të njëjtit dokumenti. Në shqip kemi
14 dy faqe gjithsej, ndërkohë që në anglisht kemi tre faqe. Ju
15 lutem të shikojmë të gjithë versionin. Dhe po ashtu do të doja
16 që të kalojmë tek faqja e tretë në versionin në anglisht në
17 mënyrë të tillë që të shikojmë fundin e dokumentit. Qëndrojmë
18 këtu për një çast.

19 PY. A e njihni dokumentin në ekran që keni në të majtën tuaj,
20 Dëshmitar?

21 PË. Po.

22 Z. PACE: [Përkthim] Të zmadhojmë dokumentin në të djathtë
23 të dokumentit që është në të majtë ku është nënshkrimi.

24 PY. Dëshmitar, a është nënshkrim i juaj ky nënshkrimi që
25 shikoni në dokumentin në të majtë?

1 PË. Po.

2 PY. A jeni ju personi që e keni shtypur këtë dokument në
3 shqip?

4 PË. Unë jam personi që e kam shtypur këtë se unë e kisha
5 kompjuter edhe printer në zyrën time. Por, përpilimin siç
6 shifet këtu që e kemi bërë së bashku me zëvendëskomandantin e
7 zonës operative të Pashtrikut, z. Sadik Halitjahën.

8 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim këto dokumente dhe në
9 vende të tyre do kërkoja që të paraqitet dokumenti P00650, së
10 bashku me P00650-ET. Të fillojmë me dy faqet e para të këtyre
11 dy dokumenteve. Njëri në shqip tjetri në anglisht. Përsëri, do
12 i kërkoja Sekretarit që ta zvogëlojë faqen në mënyrë të tillë
13 që të shikojmë të gjithë faqet në shqip dhe në anglisht.

14 PY. Dëshmitar, kemi një dokument tjetër. Në të majtë është në
15 shqip, në të djathtë është në anglisht.

16 Z. PACE: [Përkthim] Tani do i kërkoj Sekretarit që të
17 kalojmë te faqja e dytë e secilit prej dokumenteve. Po ashtu
18 zvogëlojeni dokumentet për të parë të gjithë faqen.

19 PY. Ndërkohë që tani, Dëshmitar --

20 Z. PACE: [Përkthim] Do i kërkoj Sekretarit që të kalojmë
21 te faqja e tretë dhe e fundit e secilit prej këtyre
22 dokumenteve.

23 PY. Dëshmitar, a e njihni dokumentin në të majtë të ekranit
24 që është versioni në shqip i tij?

25 PË. Po, zotëri.

1 PY. A e keni shtypur ju këtë dokument, Dëshmitar?

2 PË. Po.

3 PY. Tani do ju pyes lidhur me pjesë të caktuara të tij.

4 Z. PACE: [Përkthim] Kështu që do i kërkoja Sekretarit për
5 këtë arsye që të kalojmë tek faqja e parë në versionin në
6 shqip dhe në versionin në anglisht. Faleminderit.

7 PY. Dëshmitar, do filloj që të lexoj nga fjalët në paragrafin
8 e dytë, "Pikërisht më 1 mars ..." dhe pastaj do ju bëj disa
9 pyetje. Më ndiqni ju lutem.

10 "Pikërisht më 1 mars 1999 kërkoja nga komandant Drini që
11 të më lejojë të shkoj bashkë me eprorin Sadik Halitjahën në
12 atë brigadë dhe t'i rregullojmë të gjitha problemet e atyre
13 fshatrave. Duke bërë pastaj propozimet për ndërrimet kadrovike
14 me anë të të cilave do të tejkaloheshin mosmarrëveshjet dhe
15 pakënaqësitë në ato fshatra. Por prapë përgjigjja ishte
16 negative. Dhe unë hoqa dorë nga kjo. Sepse pashë sepse asnjëri
17 nuk kishte interes që të zgjidheshin këto çështje.

18 "Për këtë kam kontaktuar edhe në Shtabin e Përgjithshëm
19 me Feratin, dhe i kam treguar për këto probleme dhe nga vijnë
20 ata, dhe se si duhet të tejkalohen ato."

21 Do ndalojmë këtu për një çast, Dëshmitar. Pyetja që kam
22 për ju është kjo, a ju kujtohet kjo bisedë që përshkruhet
23 këtu, kjo bisedë që keni pasur me Drinin më 1 mars 1999?

24 PË. Më kujtohen shumë prej bisedave, por ndër to ishte
25 normalisht edhe kjo. Po, më kujtohet.

1 PY. Të përqendrohemi te kjo bisedë konkrete. Ku ka ndodhur
2 kjo bisedë? Domethënë, në aspektin gjeografik, ku ka ndodhur
3 kjo bisedë?

4 PË. Z. Gjykatës, ne si eprorë të zonës, si ndihmës-komandant
5 të Drinit në zonën operative të Pashtrikut, sa herë që kishim
6 mundësi, sa herë që kishim mundësi çdo javë bënim takime,
7 *briefing* i thojshim atëherë, për të raportuar secili nga
8 sektorët për problemet e tyre. Edhe unë të gjitha këto
9 probleme që i kam cekur këtu i kam biseduar me komandant
10 Drinin në takimet tona aty që i kishim të përjavshme, por
11 sigurisht meqë nuk na ka pranuar atë ankesë apo kërkesë, edhe
12 jam munduar të gjej mënyra të tjera që të informoj Shtabin e
13 Përgjithshëm për këto, për këto mendime që mua atëherë m'u
14 kanë dukur negative dhe që kanë qenë opinionimi im i asaj kohës.
15 Kështu që, kjo ka ndodhur në Nishor, saktësisht.

16 PY. Në pjesën e fundit të asaj çfarë ju lexova, thuhet si më
17 poshtë:

18 "Kam kontaktuar gjithashtu edhe me Shtabin e
19 Përgjithshëm, me Feratin, dhe i kam treguar për të gjitha këto
20 probleme, nga vijnë këto probleme dhe se si duhet të
21 tejkalohen ato."

22 A mund t'i tregoni Gjykatësit se kush është Ferati që
23 keni përmendur këtu?

24 PË. Mendoj se jemi sqaruar gjatë javës së kaluar, që me në
25 ato përpjekjet e mia për të kontaktuar jam i bindur këtu që e

1 kam biseduar me, jo biseduar, por i kam dhënë një letër, apo
2 ndoshta këtë letër, Ferat Ademajt, që ishte shoferi i shefit
3 të Shtabit të Përgjithshëm në UÇK, shoferit të Bislim Zyrapit.
4 PY. Dëshmitar, a mund të shpjegoni ose a mund t'i sqaroni se
5 si ju thoni që këtë letër ia keni dhënë Feratit, por që vetë
6 letra thotë që unë kam kontaktuar edhe në Shtabin e
7 Përgjithshëm me Feratin. Na e shpjegoni se si mund të ndodhë
8 kjo, si ka rastisur që të ndodhë kjo, Dëshmitar?

9 PË. Ndoshta e thashë gabim, këtë letër. E thashë që shumë
10 herë, shumë herë jam munduar të lajmëroj Shtabin e
11 Përgjithshëm për ato që mua në atë kohë më është dukur si
12 dukuri negative apo si mospunë apo si diçka, mungesë e
13 iniciativës apo si mungesë e aksioneve, mungesë e luftimeve.
14 Unë të gjitha këto shpeshherë jam munduar që t'i them, ndoshta
15 njëri nga ato tentimet e mia ka qenë edhe kjo përmes shoferit
16 të shefit të Shtabit të Përgjithshëm.

17 Por, domethënë këtu ishte fjala vetëm për atë, për atë se
18 nuk, po ta kisha kontaktuar dikënd nga Shtabi i Përgjithshëm
19 nuk kam nevojë më të shkruaj edhe një herë këtë raport, këtë
20 ankesë edhe këto çka po i lexoni sot.

21 PY. Në përpjekje të tilla ose orvatje për të kontaktuar me
22 Shtabin e Përgjithshëm, të mëhershmet ose të më përparshme,
23 çfarë keni thënë ju lidhur me problemet që ju trajtoni në këtë
24 letër dhe mënyrën se si duhet të tejkaloheshin këto probleme.

25 PË. Shife, mendimi i, perceptimi im i luftës dhe perceptimi i

1 eprorëve që ishin me karrierë ndoshta ka ndryshuar pak. Unë
2 isha më shumë një, kisha një shpirt, shpirt iniciative, shpirt
3 aktiv. Mospuna apo mënyra defensive e atyne eprorëve që ishin
4 me ne, ndoshta më pengonte, nuk e adhuroja atë lloj punës,
5 kështu që në vazhden e asaj unë kam kërkuar nga Shtabi i
6 Përgjithshëm që të ndikojnë për ta përsheptuar edhe për të
7 arritur cilësinë e punës, cilësinë e luftimeve, cilësinë e
8 organizimeve. Në këtë aspekt, domethënë, është krejt ky, krejt
9 këto shkrimet që deri tash, deri tash po i analizojmë.

10 PY. A ishte kjo një qasje normale për ju sa i takon dhënies
11 së informacionit për Shtabin e Përgjithshëm? Domethënë që t'ia
12 jepnit informacionit Feratit ose dikujt tjetër në mënyrë që
13 Ferati ose dikush tjetër t'ia jepte atë Shtabit të
14 Përgjithshëm?

15 PË. Po ne gjithmonë, gjithmonë jemi munduar disi t'i dërgojmë
16 informacionet deri në Shtab të Përgjithshëm. Nëse dikënd e
17 kemi parë që na ka thanë po shkoj në Shtabin e Përgjithshëm, i
18 kemi thanë merre këtë, çoja, dërgoja atje. Domethënë, është
19 një mënyrë e kuptueshme edhe kjo që të flasësh me shoferin e
20 shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Ndoshta jo për secilin
21 problem që e kam cekur, por që ka probleme edhe që kemi nevojë
22 për ta kontaktuar, po.

23 PY. Do të vazhdoj që të lexoj aty ku e lamë, Dëshmitar. E
24 kemi akoma në ekran.

25 Z. PACE: [Përkthim] Ndoshta do ishte mirë që ta ulim pak

1 faqen në anglisht dhe në shqip. "Ka të bëjë me Nasim
2 Mullabazin ..." në shqip dhe në anglisht.
3 PY. Edhe një herë, Dëshmitar, do ju lexoj një pjesë tjetër
4 dhe pastaj do ju bëj një pyetje, disa pyetje të tjera.
5 "Kur themi për Nasim Mullabazin, kemi parasysh se ai deri
6 vonë ka punuar në policinë serbe dhe se është përjashtuar nga
7 SPB-ja ... vetëm atëherë kur ... ata e gjuajtën si leckë të
8 përdorur dhe erdhi tek ne. Mirëpo, atij i kishte mbetur
9 shprehi që t'i ndjekë veprimtarët e hershëm dhe prapë vazhdoi
10 me avazin e vjetër duke bërë përcjelljen time, të Selim Gashit
11 dhe të shokëve të tjerë. Me futjen e tij në sektorin e SHIK-ut
12 nuk kishim mundësi të shkëmbejmë informata mes veti për arsye
13 se ai nuk bashkëpunon me mua, dhe edhe më e keqja, nuk ka
14 raportuar asnjëherë mbi këto çështje dhe probleme që sot po
15 ndodhin. Domethënë, se nuk ka bërë as evitimin e këtyre
16 dukurive negative."

17 Pyetja që kam për ju, Dëshmitar, është kjo. Kush është
18 Nasim Mullabazi?

19 PË. Nasim Mullabazi është siç përshkruhet këtu. Dhe këtu
20 është një ish-pjesëtar i policisë serbe. Kur kam ardh në
21 Kosovë, kur kam shkuar në Brigadën 124, kam kuptuar se ai
22 është emëruar nga, apo nga dikush aty si shef i S1, që ishte
23 pjesë e sektorit tim. Dhe natyrisht se në këtë drejtim unë e
24 kam kundërshtuar një gjë të tillë, sepse nuk mendoja atëherë
25 edhe sot, edhe sot në këtë datë nuk mendoj se pjesëtarë të

1 policisë serbe dhe familjarët e tyre që duhet të jenë në
2 ndonjë sektor të rëndësisë së veçantë për shtetin e Kosovës.

3 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin, dhe në vend
4 të këtij dokumenti do i kërkoja Sekretarit që të paraqesë në
5 ekran dokumentin SPOE00328676-00328733. Ky është dokument në
6 shqip dhe në këtë dokument do fillojmë nga faqja SPOE00328723.
7 Përkthimi në anglisht i këtij dokumenti mban numrin 108011-
8 108040-ET. Te dokumenti në anglisht do i kërkoja Sekretarit që
9 të shkojmë në faqen 108035. Faleminderit. Ta zmadhojmë
10 versionin në shqip në të djathtë të dokumentit, nëse është e
11 mundur. Po, faleminderit. Të kalojmë pak më anash.

12 PY. Dëshmitar, sikurse mund ta shikoni bëhet fjalë për një
13 artikull që mban datën 9 mars 2017. Dhe këtu thuhet që autori
14 jeni ju dhe është një artikull që është ndarë në profilin e
15 Facebook-ut të Sadik Halitjahës.

16 Pyetja e parë është kjo, a e keni shkruar ju këtë
17 artikull, Dëshmitar?

18 PË. Po.

19 PY. A ju kujtohet se çfarë përmban ky artikull?

20 PË. Në përgjithësi, po.

21 PY. A i qëndroni asaj që keni shkruar këtu, në këtë artikull?

22 PË. Në çdo pikë, në çdo presje.

23 Z. PACE: [Përkthim] Do filloj me leximin e artikullit, që
24 është dhënë në tërësinë e vet në anglisht. Ndërkohë që në
25 shqip fillon këtu dhe pastaj vazhdon në dy faqe të tjera.

1 PY. Atëherë, ndërkohë që po lexoj, do lexoj dhe pastaj do ju
2 bëj disa pyetje.

3 "Marsi i shqiptarëve, marsi i Jasharëve, marsi i
4 demonstratave. Marsi i kuq, marsi i ushtrisë. Marsi, marsi,
5 marsi!

6 "Sot do të shkruaj për marsin e vitit 1999. Ishte marsi
7 më i përgjakshëm në historinë e shtetit dhe popullit tonë. Më
8 18 mars në Rambuje nënshkruhet marrëveshja e Rambujesë. Më 25
9 mars filluan bombardimet e NATO-s. Por, sot do të shkruaj për
10 një dezertim të një FARK-isti, Sulejman Kollqakut, i cili
11 ishte zëvendëskomandant në zonën e Pashtrikut. Në atë kohë
12 komandant kishim Ekrem Rexhën, Drinin. Ishte një ngjarje si
13 një njollë historike e cila i dha udhë FARK-ut dhe qëllimi
14 kryesor i 'institucioneve' ishte sabotimi i luftës. Kjo ishte
15 e dyta për nga pesha e rëndësisë menjëherë pas ikjes së
16 komandantit, të z. Tahir Zemajt."

17 Do ndaloj këtu për momentin. Pyetja që kam për ju është
18 kjo, Dëshmitar. Pse keni shkruar që "FARK-u dhe
19 'institucionet' e Kosovës kishin qëllim sabotimin e luftës",
20 pse e keni shkruar këtë, pse e keni menduar këtë?

21 PË. E kam shkruar atëherë, edhe sot e mendoj se kanë qenë të
22 tillë, sepse mungesa e tyre, mungesa e punës së tyre, mungesa
23 e ndihmës së tyre, mungesa e angazhimeve të tyre operacionale
24 në drejtim të luftës, në drejtim të ndihmës ndaj nesh, që neve
25 kishim nevojë. Neve kishim nevojë edhe për një qen, ne kishim

1 nevojë edhe për një kalë, ne kishim nevojë edhe për një gomar
2 që ne t'i transportonim armët. Edhe në ato vite ata qëndronin
3 në Tiranë. Mbi 5000 pjesëtarë të forcave të FARK-ut ishin të
4 instaluar në Tiranë e nëpër Shqipëri e nuk e shihnin të
5 arsyeshme të hynin të na ndihmonin apo të na armatosnin. Vetëm
6 të na armatosnin të sillnin armë deri në kufi të cilat --
7 kështu që në këtë aspekt, edhe sot mendoj, se ata kanë lindur
8 për të na sabotuar luftën. Është mendimi im personal. Është
9 opinionimi im personal që unë mendoj, kam menduar edhe mendoj
10 sot.

11 PY. Do të vazhdoj të lexoj:

12 "Ishte 11 marsi dhe nuk donim që ky përvjetor i
13 demonstratave të 1981 të kalonte pa festim, edhe pse ishin në
14 mes të luftës. Me që nga veprimtarët e hershëm të ilegales
15 ishim pak, Sadik Halitjaha, atëherë si shef i sektorit për
16 moral dhe politikë, dhe unë, u morëm vesh që ta festonim siç
17 duhej këtë ngjarje historike e cila bëri kthesë të madhe në
18 historinë tonë kombëtare.

19 "Morëm të gjitha masat e nevojshme, lajmëruam Shtabin e
20 Përgjithshëm, përforcuam të gjitha pikat vrojtuese dhe
21 ndaluese. U kujdesëm edhe për aspektet kulturore duke ftuar
22 shumë artistë. Unë si shef i ZKZ-së apo shërbimit informativ
23 të UÇK-së, në ZOP, isha i përkushtuar për sigurinë dhe
24 mbarëvajtjen e këtij përvjetori të lavdisë."

25 Do ndaloj këtu, Dëshmitar, dhe do t'ju bëj këtë pyetje.

1 Për çfarë e lajmëruat Shtabin e Përgjithshëm sa i takon
2 festimit të përvjetorit të 11 marsit?
3 PË. Shtabin e Përgjithshëm e kemi lajmëruar si, për këtë
4 manifest, sepse ky ka qenë një manifest i madh, ku ishin
5 prezentë mbi 35,000 banorë. E kemi lajmëruar për të qenë, për
6 të qenë më syçelë në atë pjesën andej asfaltit apo andej,
7 andej zonës që lidheshim ne me ta. Edhe kemi, e kemi lajmëruar
8 se ishte një ngjarje për neve madhështore, shumë e dashur edhe
9 e respektuar për ne.

10 PY. Ku ka qenë i stacionuar Shtabi i Përgjithshëm në këtë
11 kohë, domethënë në mars të 1999?

12 PË. Shtabi i Përgjithshëm ka qenë i stacionuar në malet e
13 Berishës, në Kleçkë, Berishës, Divjakë. Nuk di ta,
14 domethënë -- në Kleçkë, zakonisht thuhet në Kleçkë.

15 PY. A ju kujtohet se kush në Shtabin e Përgjithshëm është
16 lajmëruar për këtë temën, për këtë çështjen që sapo diskutuam?

17 PË. Jo. Jo, se edhe këtu e kam shkruar që unë këto fshatra që
18 festuan atë ditë përvjetorin e demonstratave rrethoheshin në
19 të gjitha anët me territore nga ku mund të na sulmonin serbët.
20 Kështu që atë ditë nga mëngjesi deri në fund kam qenë i
21 angazhuar në kontrollimin e të gjitha atyne, atyne vendeve që
22 mos po e shfrytëzon rastin, mos disi do ta kuptojnë forcat
23 serbe që po e bëjmë këtë festim, edhe nëse do ta granatonin
24 nga Suhareka, nga Duhla, apo nga cilado pjesë atë vend, në atë
25 mori njerëzish do të kishte shumë gjakderdhje.

1 Kështu që atë ditë unë nuk mbaj mend që të kem parë diçka
2 nga ky manifest, mbaj mend vetëm që kam qenë në lëvizje tërë
3 ditën për ta siguruar edhe për të ruajtur sigurinë e këtyne
4 qytetarëve që ishin grumbulluar atë ditë aty.

5 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të
6 pranohen provat që i treguam dëshmitarit. Parashtrojmë që
7 duhet që të shtohen në provën P719 dhe P719-ET, të cilat kanë
8 të bëjnë me të njëjtin dokument. Sa për sqarim, faqet që
9 tregova në versionin në shqip janë ato që përfundojnë me
10 328723, 724, dhe 725. Ndërkohë që në anglisht është vetëm
11 faqja 108035.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
13 kundërshtime?

14 Z. DIXON: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës, nuk kemi
15 kundërshtim.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përderisa nuk
17 dëgjuam asnjë kundërshtim, dokumenti SPOE00328723, 72 [Sipas
18 përkthimit] dhe 724 si dhe 725 pranohen dhe marrim numrin, dhe
19 duhet t'i bashkohen provës ekzistuese P719.

20 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
21 Gjykatës. Po ashtu edhe dokumenti me ERN 108035 do t'i shtohet
22 provës ekzistuese P00719-ET. Faleminderit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
24 ju.

25 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta hiqni dokumentin nga ekrani.

1 PY. Dëshmitar, a e njihni një person që quhet Ismet Tara?

2 PË. Po, e njof.

3 PY. A ka qenë anëtar i UÇK-së ai?

4 PË. Ismet Tara ishte anëtar i UÇK-së që nga fillimi deri në
5 fund të luftës.

6 PY. A e dini se çfarë roli ose çfarë rolesh ka luajtur ai në
7 UÇK gjatë gjithë luftës?

8 PË. Unë mendoj se në fillim të luftës ai ishte pjesë e
9 komandës së njësimit Arti, njësiti i qytetit të Rahovecit.
10 Kishte pseudonim apo kishte emrin Arti. Edhe Ismet Tara ka
11 qenë pjesë e asaj komandës ku kanë qenë Toni, Mici, komandant
12 Toni ka qenë komandanti, Mici. Sabajdin Cena, Ismet Tara kanë
13 qenë pjesë e asaj komandës.

14 PY. Po pas këtij roli, a e dini në qoftë se Ismet Tara ka
15 luajtur ndonjë rol tjetër brenda UÇK-së?

16 PË. Unë kujtoj, kujtoj kur kam filluar detyrën time në G2, e
17 kam gjetur Ismet Tarën, më duket ka qenë shef i sektorit të
18 financave. Më duket se është G6. Edhe ka qenë për një periudhë
19 derisa mandej në vetë, me vetë dëshirë ka shkuar te shokët e
20 vet, te shokët e komunës së Rahovecit. Kaq.

21 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, shoh që do
22 përfundojmë së shpejti sepse e shikoj që ka vajtur thujse ora
23 për pushimin. Megjithatë, do ishte mirë që të përfundojmë me
24 një dokument tjetër që ka të bëjë me të njëjtën temë. Ndoshta
25 do më duhen dy ose tre minuta për ta bërë këtë, në qoftë se më

1 jepni leje.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 Z. PACE: [Përkthim] Në rregull. Dua që të paraqitet në
4 ekran tani dokumenti SPOE00226524-SPOE00226526, së bashku me
5 versionin e tij në anglisht. Faleminderit.

6 PY. Dëshmitar, a e keni parë dokumentin që keni në të majtë
7 në ekranin tuaj, në versionin në shqip, përpara se sa unë
8 t'jua tregoja gjatë seancës përgatitore me Prokurorinë?

9 PË. Jo, nuk e kam parë përpara. Ju ma keni treguar për herë
10 të parë.

11 Z. PACE: [Përkthim] Në qoftë se do e zmadhojmë dokumentin
12 tek pika e parë, si në versionin në shqip dhe në anglisht. Ju
13 lutem, bëni të njëjtën gjë edhe për anglishten, se në shqip
14 është e qartë.

15 PY. Dëshmitar, mund ta shikoni te kjo pjesë që përmendeni ju
16 personalisht këtu që keni marrë para nga ushtarët e Rahovecit
17 për armatim. A ju kujtohet të ketë ndodhur kjo, Dëshmitar?

18 PË. Po, zotëri. Në, ka qenë 14 apo 15 korriku i vitit 1998,
19 kur unë kam marrë nga pika Arti 55,000 marka gjermane për të
20 blerë armatim apo për të blerë një armatim më të sofistikuar
21 në Shqipëri për ta. [E pakuptueshme].

22 PY. Në qoftë se do shikojmë pikën e katërt të të njëjtit
23 dokument, këtu përmendet komandant Toni. A është e saktë,
24 Dëshmitar, që komandant Toni ka qenë komandant i njësitit ku
25 ka shërbyer Ismet Tara përpara se sa t'i bashkohej zonës në

1 Pashtrik, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

2 PË. Po, është e saktë.

3 Z. PACE: [Përkthim] Tani, të kalojmë në faqen e dytë të
4 dy dokumenteve. Dhe këtu dua që të zmadhoni paragrafin e
5 parafundit në shqip dhe në anglisht. Besoj që është e qartë në
6 shqip.

7 PY. Dëshmitar --

8 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, edhe në anglisht është
9 e qartë.

10 PY. Në këtë pikë, në këtë paragraf, përmendeni ju që i keni
11 dhënë armatimet që keni blerë nga paratë e marra në Rahovec në
12 njësitet e UÇK-së. Pra, në disa shtabe të tjera lokale të
13 UÇK-së. A është e saktë, me aq sa ju kujtohet ju, kjo gjë,
14 Dëshmitar?

15 PË. Ju thashë se ai udhëtim i imi ka pas ndodhur më 15
16 korrik. Mbaj mend se ishte ditëlindja ime kjo. Edhe me ato
17 armët e para menjëherë në Rahovec filloi ofensiva, më 17
18 korrik, domethënë, dy ditë mbasi shkova unë në Shqipëri në
19 Rahovec filloi ofensiva 4-5 ditore, më e madhja që ka ndodhur
20 ndonjëherë.

21 Dhe atëherë në Shqipëri jam takuar me Azem Sylën, dhe
22 Xheladin Gashin ku prezent aty në Cahan, në Cahan edhe në
23 shtabin ku ishte Xheladini kishte një grup shumë i madh i,
24 ushtarësh e që nuk ishin të armatosur. Atëherë, Azem Sylë më
25 tha që ato armë t'i jepja atyre që po prisnin që të hynin në

1 Kosovë. Kurse për, sepse ai e dinte se këto armë ishin për
2 pikën Arti, për Rahovecin, kurse për Rahovecin atje është vonë
3 tani, se veç ofensiva kishte filluar. Do të kujdesemi që më
4 vonë të blejmë armë të tjera. Edhe kështu kam vepruar,
5 domethënë, iu kam dhanë armët atyne që ishin në Cahan. Mandej,
6 i kam grumbulluar të tjera armët, por në ndërkohë kam vajtur e
7 ardhur, por më, kur i kanë sjellur ato armët e Rahovecit, më
8 23 gusht unë kam ra në pritë në mes fshatit Lipovec edhe
9 Goden, quajtur diçka, në Has. Në atë pritë është asgjësuar ai,
10 është asgjësuar një qerre me plot armatim, kështu që kaq mund
11 të them.

12 Kjo çka ka shkru Ismet Tara është shumë e vërtetë, por
13 edhe ajo çka them unë, nga ana tjetër, është shumë e vërtetë.
14 Kështu që nuk e kundërshtoj fare atë çfarë ka thënë Ismeti.
15 PY. Atëherë, të kalojmë tek faqja e tretë, në versionin në
16 shqip dhe në anglisht. Dhe shohim që ndërmjet të tjerëve ky
17 është, kjo një letër që i është dërguar Shtabit të
18 Përgjithshëm, ZKZ-së pranë Shtabit të Përgjithshëm,
19 Inspektorit të Përgjithshëm të UÇK-së. A jeni i, në dijeni të
20 faktit në qoftë se Ismet Tara i ka informuar ata lidhur me
21 përmbajtjen e kësaj letre, Dëshmitar?

22 PË. Nuk jam në dijeni, edhe nuk e kam kuptuar kurrë këtë nga
23 dikush tjetër përpos nga ju javën e kaluar.

24 Z. PACE: [Përkthim] Edhe një pyetje shumë të shkurtër,
25 përpara se sa të përfundojmë me këtë.

1 PY. Në qoftë se do kalojmë tek faqja e parë, në të majtë, e
2 shikojmë datën. Pra, data është 16 mars 1999, dhe thuhet
3 Kasterc përpara datës. A jeni në dijeni në qoftë se zona
4 operative ka përdorur ndonjë ndërtesë në Kasterc në atë kohë?
5 E kam fjalën për Kasterc, pra është përdorur ndonjë objekt nga
6 Shtabi i Përgjithshëm në atë kohë?

7 PË. Jo nga Shtabi i Përgjithshëm, por ka qenë, Kasterci dhe
8 Nishori janë ngjitur. Nuk dallohet dallimi, është njëjtë.
9 Kështu që ishte Ismet Tara banonte me një objekt që ishte
10 pjesë e zonës operative të Pashtrikut.

11 PY. E kuptoj. Pra, këtu në transkript thotë "Shtabi i
12 Përgjithshëm", ndoshta e thashë unë gabim, por unë e kisha në
13 fakt fjalën për shtabin e zonës së Pashtrikut, jo për Shtabin
14 e Përgjithshëm.

15 Atëherë, këtu përfundojnë pyetjet që kam unë lidhur me
16 këtë dokument, dhe kërkoj që të pranohet në provë gjyqësore,
17 në qoftë se është e mundur.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
19 kundërshtim?

20 Z. DIXON: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës. Për të
21 njëjtat arsye që kam thënë dhe më përpara ne kundërshtojmë që
22 ky dokument të pranohet si provë gjyqësore.

23 Z. PACE: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni, mund të
24 përgjigjem, i nderuar Gjykatës.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

1 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshmitari ka
2 vërtetuar përmbajtjen e saj në veçanti sa i takon
3 informacionit që lidhet me të. Ai na tha çfarë pozicioni ka
4 pas z. Tara, po ashtu bëri komente sa i takon nënshkrimeve,
5 vendit, personave të tjerë që përmenden aty, si dhe bëri
6 parashtrime të tjera të cilat i shërbejnë relevancës së këtij
7 dokumenti. Besoj që kaq janë të mjaftueshme.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, u
9 vërtetua origjina e këtij dokumenti. Kështu që dokumenti
10 SPOE00226527 -- kam përshtypjen që ishte dhe një faqe tjetër,
11 pra, z. Pace.

12 Z. PACE: [Përkthim] Po, është i gjithë dokumenti. Dhe
13 numri i plotë është nga 224, 226, domethënë janë tre faqe.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
15 Këto tre faqe pranohen si prova gjyqësore.

16 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do i caktojme numrin e
17 provës P01860, klasifikimi është konfidencial. Faleminderit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ka
19 ardhur koha për pushimin e drekës. Do bëjmë një orë e gjysmë
20 pushim, dhe do kthehemi në orën 14.30 përsëri. Do ju lutesha
21 të mos flisnit me askënd jashtë sallës së gjyqit për dëshminë
22 tuaj. Mund të largoheni nga salla tani. Faleminderit.

23 Z. PACE: [Përkthim] Për t'ju informuar, më duhen rreth
24 1.5 orë të tjera që është pak a shumë në të njëjtën linjë me
25 kohën që kisha kërkuar.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pak a shumë.

2 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë

4 pushim deri në orën 14.30.

5 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.09

6 --- Seanca rifillon në orën 14.30

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,

8 sillni dëshmitarin në sallë.

9 [Dëshmitari vijon dëshminë]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita,

11 Dëshmitar.

12 DËSHMITARI: Mirëdita.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të

14 vazhdojmë tani me pyetjet. Prokuroria ka ende pyetje për ju.

15 Dëgjojeni me vëmendje.

16 Z. Pace, fjala është për ju.

17 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

18 Ju lutem, të vendoset në ekran materiali P01856 që u

19 pranua sot gjatë paradites. Mjafton shqipja për momentin.

20 Faleminderit.

21 PY. Dëshmitar, në ekran është një skicë që e vizatuat ju në

22 fakt, gjatë intervistës me ZPS-në. Kjo ishte struktura e zonës

23 operative të Pashtrikut dhe shtabit, të njëjtën gjë që

24 diskutuam ne gjatë intervistës.

25 Z. PACE: [Përkthim] E tani do doja që përbri të vendoset

1 materiali me numër P712. Më konkretisht faqja e parë me numër
2 209321. Faleminderit.

3 PY. Ju lutem, mos e merrni parasysh dokumentin në të majtë
4 për momentin. Këtë kopertinë që po shohim në të djathtë të
5 ekranit, librin konkret, e keni lexuar ndonjëherë?

6 U përgjigjët, u përgjigjët se nuk doli për procesverbal?
7 E keni lexuar?

8 PË. E kam lexuar.

9 Z. PACE: [Përkthim] Në faqen, në anë të djathtë të
10 ekranit, ju lutem, të shkojmë te faqja që përfundon me numrin
11 209330. Jo kjo. Edhe një herë, numri është SPOE00209330. Faqja
12 tjetër, kjo.

13 PY. Dëshmitar, në të majtë është dokumenti, skica që keni
14 vizatuar ju, dhe në të djathtë është një faqe e librit të
15 Sadik Halitjahës që sapa pamë. Fokusohu te niveli i zonës dhe
16 këtu mund të shihni që ju dhe z. Halitjaha keni pasur disa
17 persona, për shembull, shohim këtu Tahir Sinanin, z.
18 Halitjaha, shohim emrin tuaj që jeni tek G2-shi, shohim G1-
19 shin Vesel Maliqin, tek G4 Skënder Krasniqi dhe G5 Sabahudin
20 Cena. Shohim që z. Halitjaha ka thënë që drejtori - më falni -
21 kryesit i policisë ushtarake ka qenë Nexhmi Krasniqi në librin
22 e tij. Me sa ju kujtohet ju, kështu ka qenë?

23 PË. Po.

24 PY. Kur e ka ushtruar këtë detyrë?

25 PË. Nexhmi Krasniqi mendoj që e ka ushtruar këtë detyrë nga

1 janari apo shkurti i '99-s. Nuk më kujtohet data e saktë.

2 PY. Deri kur, nëse ju kujtohet?

3 PË. Deri në përfundim të luftës.

4 PY. Po ashtu z. Halitjaha ka vendosur emrin e Nuredin Abazit
5 si këshilltar juridik. Me sa ju kujtohet ju, kështu ka qenë?

6 PË. Unë në atë kohë nuk e kam ditur që ai ka këshilltar
7 juridik z. Nuredin Abazi, mirëpo nëse ai e ka shkruar këtë unë
8 e pranoj si të mirëqenë.

9 PY. Shohim që z. Halitjaha ka vendosur dhe Nezir Kryeziun
10 këtu tek njësia speciale Syri i Shqiponjës. A ka qenë vërtet
11 Nezir Kryeziu komandant i këtij njësiti?

12 PË. Po, Nezir Kryeziu ka qenë komandant i njësimit
13 diversanto-vëzhgues Syri i Shqiponjës në kuadër të zonës
14 operative të Pashtrikut.

15 PY. Kur e ka ushtruar këtë detyrë?

16 PË. Mendoj se nga formimi që do të jetë fillimi i marsit të
17 vitit 1999.

18 PY. Dhe G3-shi ju keni vendosur Bajram Bekteshin, ndërsa z.
19 Halitjaha ka vendosur emrin e Nexhmedin Kastratit. Si mund ta
20 shpjegoni këtë dallim?

21 PË. Unë mendoj se që të dyja janë të vërteta, sepse Nexhmedin
22 Kastrati ka qenë pjesë e operativës një kohë, pastaj është
23 përzgjedhur nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm z. Bislim
24 Zyrapit që së bashku të shkojnë në Shqipëri për të organizuar
25 atje operacionin Shigjeta apo nuk e di çka, por pas tij në

1 sektorin e operativës ka qenë z. Bajram Bekteshi, e deri në
2 përfundim të luftës - kërkoj falje.

3 Z. PACE: [Përkthim] Shohim të plotë skicën, ju lutem. Të
4 shkojmë te G7. Po, G7.

5 PY. Ju keni vendosur Sami Sejdën, ndërsa z. Halitjaha, z. Sami
6 Sejda e ka vendosur te G6-ta. Pse kjo mospërputhje?

7 PË. Unë mendoj se këtu ka qenë ndoshta një vetëm plotësimi i
8 këtyre kuadrateve sepse te Komandant Sadik Halitjaha mungon
9 G7-ta. Unë mendoj se G7-ta është sektori i ndërlidhjes, kurse
10 G6-ta është sektori i financave ku ka qenë z. Ismet Tara.

11 PY. Që të jemi të qartë, me sa ju kujtohet ju Ismet Tara ka
12 qenë te G6-ta dhe Sami Sejda ka qenë te G7-ta?

13 PË. Ashtu është.

14 PY. Në skicën e z. Halitjaha shohim që ka vendosur dhe
15 brigadat dhe emrat përkatës. Me sa ju kujtohet ju, çfarë
16 pozite kishin personat që ka vendosur z. Halitjaha për secilën
17 brigade? Çfarë pozite kishin këta emra?

18 PË. Për secilin këtë pozitë, siç e ka potencuar komandanti
19 Sadik Halitjaha është shumë e vërtetë se në Brigadën 121 ka
20 qenë komandant Haxhi Shala; 122, Vllanzim Kryeziu; 123 Gëzim
21 Hazrolli me "H"; në Brigadën 124, Skënder Hoxha; në Brigadën
22 125, Nehat Basha; në Brigadën 126, Safet Gashi; në Brigadën
23 127 ka qenë i emëruar Shefkat Halimi. Po kjo brigadë ka qenë
24 fiktive, nuk ka arritur kurrë të organizohet me strukturat e
25 saja dhe në Brigadën 128, e cila operonte në majat e

1 Pashtrikut, në Pashtrik, në Operacionin Shigjeta ka qenë z.

2 Ruzhdi Saramati.

3 PY. Me sa keni ju dijeni personat që ka vendosur z. Halitjaha
4 ish-in vërtet komandantët e secilës brigadë siç e shohim këtu?

5 PË. Po.

6 Z. PACE: [Përkthim] Shkojmë në faqen e dytë të dokumentit
7 në të majtë.

8 PY. Dëshmitar, kjo është faqja e dytë e skicës suaj gjatë
9 intervistës shohim që ju keni vendosur brigadat këtu, nga 121
10 deri te 128, por emrat që keni vendosur ju nuk përputhem me
11 emrat që ka vendosur Sadik Halitjaha. A mund të na sqaroni
12 atëherë çfarë roli kanë pasur personat që keni shkruar ju
13 lidhur me brigadat?

14 PË. Më falni. Personat që i kam shënuar unë janë të sektorit
15 të G2-shit, brenda brigadave të caktuara. Kurse në anën e
16 djathtë, komandant Sadik Halitjaha nuk i ka cekur emrat e 2-
17 shave apo sektorit të G2-shit ku unë isha përgjegjës.

18 PY. Thuhet, të paktën sipas përkthimit, keni thënë që kanë
19 qenë shefat e sektorit G2 të brigadave. A mos njihej ky sektor
20 me akronimin S2; brigada e kishte S2 akronimin?

21 PË. Po. Në kuadër të brigadës, sektori ynë kishte akronimin
22 S2.

23 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin.

24 PY. Dëshmitar, para një çasti kur përmendët Syrin e
25 Shqiponjës dhe thatë që ishte Nezir Kryeziu komandant, më

1 duket se thatë që kjo njësi është krijuar rreth marsit të
2 1999. A mund të na tregoni kush e krijoi njësitin Syri i
3 Shqiponjës?

4 PË. Po. Njësitin Syrin e Shqiponjës më shumë iniciativë për
5 ta formuar kemi pasur unë edhe Sadik Halitjaha. E kemi parë të
6 nevojshme se zonës operative të Pashtrikut i duhet një njësit
7 i cili do të intervenonte me shpejtësi aty ku do të ketë
8 nevojë dhe i cili do t'i mënjanonte rreziqet nëse na kanosej
9 nga secili anë që vinin prej anëve të armikut. Domethënë është
10 formuar me iniciativën tonë, i pranuar nga Komandant Drini dhe
11 nga Komandant Tahir Sinani. Nuk e di më lart a kanë qenë të
12 njoftuar në Shtabin e Përgjithshëm, por për neve ka qenë një
13 njësit elitare, një njësit shumë i nevojshëm, një njësit shumë
14 që ka vepruar shumë mirë në zonën tonë.

15 PY. A mund t'i shpjegoni Trupit Gjykses pse në cilësinë e
16 shefit të G2-shit në zonën operative të Pashtrikut, keni qenë
17 një prej dy personave, të paktën siç e thatë ju, që keni
18 filluar krijimin e këtij njësi?

19 PË. Po, mund të tentojmë t'ju sqarojmë. Siç e dini edhe vetë se
20 dhe sektori im është marrë më shumë me burimin e
21 rrezikshmërisë, burimin e trevave nga na vjen rreziku dhe e
22 kemi parë të arsyeshme që në atë territor të gjerë, zonës tonë
23 të Pashtrikut i nevojitet një njësit i cili mund të
24 intervenojë në mënyrë më të shpejtë, më të saktë për të
25 mbrojtur popullatën edhe vendqëndrimet tona nga sulmet e

1 befasishme të armikut.

2 Kështu që unë kam menduar që po veprojmë mirë. Ishte
3 iniciativë e jona, pa ndonjë urdhër nga askush. Kemi menduar
4 se po e bëjmë më të mirën dhe besoj nëse e shtjellojmë edhe më
5 tutje do të dalim tek ajo se edhe kemi bërë mirë që e kemi
6 vepruar këtë njësit, sepse ka qenë shumë i suksesshëm.

7 PY. Sa pjesëtarë kishte ky njësit?

8 PË. Varësisht, varësisht unë mund të aludoj tani, por deri në
9 50 ka mund të shkojë numri i tyre, sepse pak më vonë e kemi
10 edhe Brigada 124, në kuadër të Brigadës 124 e ka formuar një
11 pjesë më të vogël, por e cila edhe ajo quhej Syri i Shqiponjës
12 dhe që ishte pjesë e kësaj, pjesë përbërëse. Mendoj se aty
13 sillej nga 50 deri në 70 anëtarë në të gjithë territorin e
14 zonës operative të Pashtrikut.

15 PY. Këto njësitet më të vogla në Brigadën 124, a kishin
16 komandant Nezir Kryeziu apo kishin ndonjë komandant tjetër?

17 PË. Njësit Syri i Shqiponjës në kuadër të Brigadës 124 kishte
18 komandant Xhavit Elshanin e jo, jo Nezir -- Nezir Kryeziu
19 ishte këtu në zonë, por që kanë mundur të kenë edhe mes veti
20 koordinime apo kontakte.

21 PY. Kush e caktoi Nezir Kryeziun si komandant të Syrit të
22 Shqiponjës në atë zonë?

23 PË. Unë mendoj se Nezir Kryeziun në atë vend e ka strukturuar
24 vetë trimëria e tij, vetë gjindshmëria e tij, sepse ai edhe,
25 domethënë, para se të formohej ky grup ka qenë pjesë e UÇK-së

1 dhe ka treguar veten si një njeri shumë të suksesshëm, shumë
2 luftuar edhe mendoj unë s'e kam njohur, por ata që e kanë
3 njohur aty përreth propozimi i tyre ka qenë edhe që i kanë
4 thënë Komandant Sadikut apo edhe mua që në krye të këtij grupi
5 - më fal tash se e hupa edhe atë mendimin - por në krye të
6 këtij grupi të jetë Nezir Kryeziu, njësit, njësitit.

7 PY. Nezir Kryeziu a kishte ndonjë zëvendës?

8 PË. Kujtoj se Nezir Kryeziu për zëvendës kishte Ilaz
9 Kadollin, një, po ashtu një luftëtar të mirë.

10 PY. A keni dijeni çfarë studimesh ka kryer z. Kadolli përpara
11 luftës?

12 PË. Unë z. Kadollin nuk e kam njohur para luftës. E kam
13 njohur në atë kohë kur po i formonim këtë njësite. Atëherë e
14 kam kuptuar se ai kishte të kryer juridikun, fakultetin e
15 drejtësisë, domethënë, kaq di për të.

16 Z. PACE: [Përkthim] Do kërkoja të vendosej në ekran
17 materiali me numër 057924-058024 bashkë me përkthimin në
18 anglisht që përfundon me *-ET Revised*; faqen e parë në të dyja
19 materialet, ju lutem.

20 PY. Dëshmitar, në të majtë të ekranit mund ta shihni besoj që
21 është pjesë e një libri. A e keni parë ndonjëherë këtë libër
22 më përpara?

23 PË. Nuk e kam lexuar këtë libër përpara.

24 PY. Po a keni dëgjuar diçka për këtë libër?

25 PË. Po.

1 Z. PACE: [Përkthim] Shkojmë në faqen 057971 në të dyja
2 gjuhët.

3 PY. Po lexoj paragrafin e dytë në të majtë të faqes në
4 anglisht dhe në shqip. Do ta lexoj dhe pastaj do t'ju bëj disa
5 pyetje.

6 "Për shkak të masivizimit të luftës, zgjerime të fronteve
7 të betejave dhe raportit të pabarabartë të forcave, lindi
8 nevoja e formimit të njësiteve të veçantë elitë me ushtarë
9 trima që kishin një përvojë të ndeshjes me serbët. Këto
10 njësite kishin një numër më të vogël ushtarësh që goditin me
11 sulme të befasishme nga të gjitha anët dhe në prita në mënyrë
12 që t'i shkaktoheshin armikut sa më shumë dëme teknike dhe me
13 efektiv ushtarak.

14 "Për këtë qëllim u formua edhe njësitë diversant-sulmues
15 Syri i Shqiponjës. Të gjithë ishin dakord që njësitë të merrte
16 emrin e simbolit tonë kombëtar, shqiponjës. Arsyetimi im që
17 tipar themelor i shqiponjës ishin sytë e saj të mprehtë që
18 piketonin gjahun në largësi dhe u pëlqye nga të gjithë.

19 Njësitë vepronte në kuadër të zonës operative të Pashtrikut,
20 ndërsa terreni i luftimit ishte zona e Suharekës, Malishevës,
21 Rahovecit dhe disa pjesë të Prizrenit. Njësitë operonte aty ku
22 ishte nevoja dhe atje ku e gjykonte të nevojshme komanda e
23 njësitit.

24 "Suksesi në luftimin kundër serbëve e ndihmoi këtë njësitë
25 që të fitonte autoritet, të krijonte autoritet në Zonën

1 Operative të Pashtrikut ...”

2 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem, edhe te shqipja të kalojmë
3 nga ana tjetër.

4 PY. “... pra, në Zonën Operative të Pashtrikut dhe në tërë
5 UÇK-në. Ky njësit shkaktonte tmerr dhe panik në radhët e
6 ushtrisë e policisë serbe.

7 “Njësitit Syri i Shqiponjës vetëm në muajin mars, prill,
8 maj dhe qershor '99 kreu mbi 30 aksione të suksesshme kundër
9 forcave pushtuese serbe.

10 “Sulmet e njësitit Syri i Shqiponjës në shumicën e
11 rasteve u ngjanin sulmeve kamikaze dhe ishin shumë efektive
12 për arsye se asgjësonin tërësisht forca pushtuese serbe,
13 ndërsa dëmet në radhët e njësitit ishin minimale, shpesh dhe
14 pa pasoja. Parimi kryesor i njësitit gjatë tërë luftës ka qenë
15 sulm dhe vetëm sulm. Kësisoj dëshmonim në praktikë thënien se
16 sulmi është mbrojtja më e mirë. Numri i ushtarëve të njësitit
17 asnjëherë nuk ka kaluar shifrën 30 duke përfshirë logjistikën
18 dhe personelin mjekësor.

19 “Asnjëherë njësitit nuk ka pasur vështirësi për efektivin
20 e tij, sepse aty paraqiteshin vazhdimisht ushtarë vullnetarë
21 zakonisht më të mirët. Vetëm ata që kishin në gjak e në shpirt
22 artin e luftës gjenin vetëm në këtë formacion elitare të UÇK-
23 së.

24 “Ndonëse UÇK-ja nuk kishte armë të mjaftueshme,
25 gjendeshin armët për ata që luftonin me përkushtim. Furnizimi

1 me armët bëhej nga vetë ushtarët të cilët shpesh kalonin
2 kufirin me Shqipërinë, përpara se të kyçeshin në UÇK që të
3 sillnin furnizime me armë. Në shumicën e rasteve, armët
4 mbaheshin në shpinë dhe duke përdorur ndonjëherë edhe kuaj, të
5 cilët ua jepnin banorët e fshatrave kufitar Kosovë - Shqipëri.

6 "Zona -- komandanti i Zonës Operative të Pashtrikut,
7 Tahir Sinani, po ashtu mori pjesë dhe kujdesej që njësit të
8 kishte armët edhe kishte një urdhër të posaçëm që të
9 furnizonte këtë njësit me armë."

10 Dëshmitar, kjo që sapo lexuam me sa ju kujtohet ju, a
11 është e saktë?

12 PË. Po, mendoj se kjo i përgjigjej asaj që edhe unë e thashë
13 deri tani. Përpos në numrin e pjesëtarëve të saj ai ka caktuar
14 se nuk ka kaluar shifrën 30, meqë ai ka shkruar kështu. Mirëpo
15 unë kam menduar se me ata të Brigadës 124 mund të jenë 50 deri
16 në 70. Sepse edhe ky e thotë që vazhdimisht paraqiteshin
17 vullnetarët të hynë në këtë listë, kështu që kjo listë kurrë
18 nuk ka qenë ekzakte, por ka qenë gjithmonë relative.

19 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem, shkojmë në faqen 058022 në
20 të njëjtin dokument në anglisht dhe në shqip. Ju lutem, do
21 zmadhojmë pjesën e djathtë, anën e djathtë të të dyja faqeve
22 në të dyja gjuhët. Edhe një herë për sekretarinë, bëhet fjalë
23 për materialin me numër 058022. Ju lutem të zmadhojmë të
24 djathtën në të dyja versionet, pjesën e djathtë. Faleminderit.
25 Zvogëlojeni pak që ta shohim faqen të plotë.

1 PY. Dëshmitar, kjo është një faqe tjetër e të njëjtit libër.

2 Ju lutem, shikoni pak emrat që radhiten këtu, pasi t'i shikoni
3 na thoni, sepse kam disa pyetje.

4 PË. Unë jam i pajtimit me këtë listë edhe pse jo të gjithë i
5 njoh, por nëse ai i ka shkruar ai i njeh më mirë.

6 Z. PACE: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër në të dyja
7 gjuhët.

8 PY. Ky është thjesht vazhdim i faqes pararendëse. Këtu ka
9 disa emra të tjerë. Lexojini emrat, më pas na thoni a kanë
10 qenë vërtet këta pjesëtarë të njësitit Syri i Shqiponjës, me
11 sa ju kujtohet ju?

12 PË. Për dy-tre emra më kujtohen, por jo të gjithë.

13 PY. A ju kujtohet ku ka qenë i stacionuar apo i vendosur
14 njësitit Syri i Shqiponjës, njësitit që ishte pranë zonës?

15 PË. Unë mendoj se Nezir Kryeziu edhe Ilaz Kadolli me një
16 pjesë të njësitit kanë qenë të stacionuar në Nishor, Kasterc,
17 Kravasari te fshatrat përreth. Por disa nga ta, domethënë kanë
18 qenë të shpërndarë në disa shtëpi se s'kanë mundur të flenë,
19 të qëndrojnë të gjithë me një. Po kryesisht këta që ishin në
20 kuadër të zonës kanë qëndruar në këto tri fshatra, Nishor,
21 Kasterc dhe Kravasari.

22 PY. Po në qershor dhe në korrik të '99-s? Ku kanë qenë të
23 vendosur pjesëtarët e njësitit Syri i Shqiponjës?

24 PË. Unë mendoj se me përfundimin e luftës më 12, 13 qershor
25 nuk ka pasur më mundësi të ekzistojë, as nuk ka pasur nevojë

1 të ekzistojë më njësiti Syri i Shqiponjës dhe në atë kohë që
2 ju e thoni unë më nuk kam njohuri për vazhdimin e jetës
3 luftarake të këtij njësiti.

4 PY. Të përqendrohemi te komandanti atëherë, te Nezir Kryeziu.
5 A e dini se ku gjendej ose ku ishte i stacionuar ai në qershor
6 dhe korrik të '99-s, Dëshmitar?

7 PË. Nezir Kryeziu mendoj se ka qenë i stacionuar në Prizren.
8 Unë kur kam vajtur nga Rahoveci pas një muaji, Nezir Kryeziun
9 e kam gjetur si zëvendëskomandant i policisë në Prizren.

10 PY. A ju kujtohet se në cilën ndërtesë ose në cilën zyrë ka
11 qenë z. Kryeziu kur keni qenë juve aty në Prizren? Vetëm për
12 të qenë i qartë aty ku ka qenë i stacionuar, për atë e kam
13 fjalën.

14 PË. Unë kur kam shkuar në Prizren, domethënë një muaj pas
15 çlirimit, të gjithë pjesëtarët e komandës, përfshirë Tahir
16 Sinanin, Sadik Halitjahën, Nexhmi Krasniqin, Nezir Kryeziun të
17 gjithë i kam takuar te konvikti apo tek universiteti sot që
18 është i Prizrenit, atëherë ishte konvikti i vajzave.

19 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të
20 pranohet në provë këtë faqen që ia treguam dëshmitarit dhe
21 kërkojmë që ky dokument të mund t'i shtohet një prove
22 ekzistuese tashmë që është P12 dhe P12-ET. Për të qenë të
23 qartë unë kërkoj që të pranohet faqja që përfundon me 057
24 [Sipas përkthimit] dhe 058023.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka

1 kundërshtime?

2 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kemi të njëjtin
3 kundërshtim që përsëritëm dhe më herët. Kështu që dua që ta
4 them këtë për procesverbal.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shumë
6 faleminderit.

7 Të tjerët?

8 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Ne mbështesim qëndrimin e z.
9 Dixon.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
11 [Përkthim] Dokumenti 057971, 058022 dhe 058023 pranohen
12 në prova gjyqësore dhe do t'i bashkohen provës P12.

13 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
14 Gjykatës.

15 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.
16 PY. Dëshmitar, në intervistën me ZPS-në keni thënë që më datë
17 9 ose 10 qershor 1999 u urdhëruat që t'i afroheshit më shumë
18 qyteteve, fshatrave dhe që komandanti i zonës që ju dërgoi në
19 Rahovec ku ju qëndruat për një muaj përpara sesa të shkonit në
20 Prizren diku nga korrik '99-s. Në fakt sapo e përmendët që
21 keni shkuar në Prizren në korrik të '99-s. Ju gjithashtu
22 konfirmuat këtë informacion në seancën përgatitore dhe thatë
23 që ka qenë situata e qetë kur jeni futur herën e parë në
24 Rahovec në lagjet e Rahovecit.

25 Pyetje ime është kjo: Kur ka qenë ekzaktësisht ose në

1 çfarë date konkretisht që jeni futur ju në Rahovec? Ju
2 kujtohet?

3 PË. Unë mendoj, unë mendoj që ka qenë data 11 qershor kur ne
4 jemi futur në një lagjet e para të Rahovecit.

5 PY. Dhe përpara sesa të futeshit në lagjet e para të
6 Rahovecit që ju mendoni që ka qenë me 11 qershor, a nga ku
7 keni shkuar nga Rahoveci? Domethënë ku shkuat mbasi ishit në
8 Rahovec?

9 PË. Mbase ishim në Rahovec? Nuk e kuptova, më fal. A ka
10 mundësi pak me e specifikue pyetjen?

11 PY. Po, patjetër. Përpara sesa të shkonit në Rahovec më 11
12 qershor, ku ishit ju, ku keni qenë i stacionuar ju vetë?

13 PË. Para se të shkonim në Rahovec, ne kemi qenë gjithmonë të
14 stacionuar apo të -- në Nishor dhe pas Marrëveshjes së
15 Kumanovës mendoj që e kemi mbajtur një takim mes Tahir Sinanit,
16 Sadik Halitjahës edhe pjesëtarëve të tjerë edhe aty kemi ndarë
17 rolet që ka do të shkojmë secili nga ne për të qenë afër
18 ushtarëve të tjerë për të qenë në ngjarje, çfarë po ndodh
19 nëpër këto komunat tona që i përkisnin zonës operative të
20 Pashtrikut.

21 Aty mua m'u ka ashtu tash s'mund të them edhe urdhër edhe
22 më ka ra shorti kur në bisedime mes Tahir Sinanit edhe Sadik
23 Halitjahës edhe komandës, unë të shkoj në Rahovec, Tahir
24 Sinani të shkojë në Suharekë, Sadik Halitjaha të shkojë në
25 drejtimin e Prizrenit. Dikush nga aty sigurisht të shkojë në

1 drejtimin e Malishevës këtu. Kështu i kemi ndarë detyrat atë
2 ditë.

3 Edhe unë mendoj se ndoshta me datën 10 jemi nisur këtej
4 poshtë nga komuna e Rahovecit, nga fshatrat e Rahovecit. Aty
5 jam takuar me ushtarët e Rahovecit edhe me 11-in besoj që me
6 ta së bashku kemi hyrë në qytetin e Rahovecit.

7 PY. Keni thënë më përpara që më pas jeni futur në Prizren
8 dikur në korrik, a ju kujtohet data në korrik se kur jeni
9 futur në Prizren më konkretisht, Dëshmitar?

10 PË. Nuk më kujtohet data e saktë kur kam -- jam shkuar në
11 Prizren se në Prizren unë edhe nga Rahoveci kam shkuar për ta
12 ndihmuar atë mbledhjen e pestë të përgjithshme që ishte e LPK-
13 së. Në Prizren kam shkuar edhe një herë, edhe pse kam qenë në
14 Rahovec kam shkuar se më ka ftuar Komandant Sadik Halitjaha që
15 ju kam treguar atë rastin kur 18, 18 maune të armatosura nga
16 Shqipëria tentuan të hynin në Kosovë.

17 Gjë me të cilën edhe ne aty jemi marrë. Kështu që data e
18 saktë kur kam shkuar të vendosem në Prizren nuk më kujtohet.

19 PY. Më herët keni dhënë dëshmi që kur keni shkuar në Prizren
20 të gjithë anëtarët e komandës së zonës kanë qenë në konviktin
21 e studenteve femra. Aty e keni pasur dhe ju zyrën, Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 PY. A e keni vizituar shkollën e shurdhmemecëve në Prizren në
24 qershor ose korrik të '99-s juve vetë?

25 PË. Jo.

1 PY. A e dini se kush nga UÇK-ja ka qenë i stacionu në atë
2 vend në qershor apo në korrik të '99-s, Dëshmitar?

3 PË. Mendoj që aty ka qenë e stacionuar Brigada 125 me
4 komandant Nehat Bashën.

5 PY. A e dini se ku ka qenë e stacionuar Brigada 128 në
6 qershor apo korrik të '99-s?

7 PË. Me aq sa mbaj mend, Brigada 128, meqë ka ardhur nga
8 Operacioni Shigjeta, unë e mbaj mend që kanë qenë në dy
9 lokacione, por cili ka qenë i pari e cili i dytë nuk mund tani
10 të flas, por e di që kanë qenë edhe në Nashec, që është një
11 fshat i afër Prizrenit, por edhe në Zym, në Zym të Opojës afër
12 Dragashit. Kështu që këto dy vendqëndrime kanë qenë vendete ku
13 Brigada 128 ka qenë më shumë e stacionuar.

14 PY. Po Kimete Krasniqin e njihni?

15 PË. E njoh nga paslufta.

16 PY. Kur e keni njohur për herë të parë Kimete Krasniqin, kur
17 e keni takuar për herë të parë?

18 PË. Përafërsisht mund të jetë korriku, mesi i korrikut,
19 fillimi i korrikut, aty tek ato ditë kur kam shkuar në
20 Prizren.

21 PY. Si ndodhi që të takoheshit me Kimete Krasniqin në atë
22 kohë ose të vendosnit një lloj kontakti me të?

23 PË. Kimete Krasniqi kishte ardhur te ne me disa, me disa
24 eprorë edhe ushtarakë të zonës operative të Drenicës, ndoshta
25 me sugjerim timin, por jo për atë personalisht, por që kisha

1 nevojë për një njeri nga Drenica që të na zbulonte një rast,
2 një rast të kriminalitetit në që kishte ndodhur në Drenicë.
3 Por që ishin fshehur në rrethinat e Prizrenit e kështu që
4 mendoj tani mendoj se kjo mos ka qenë si rezultat i atyne
5 përpjekjeve tona në kontakt me shokët e me luftëtarët e
6 Drenicës. Mendoj që e kanë sjellë atë si më të përshtatshme
7 për atë punë çfarë na duhej neve atje.

8 PY. Në atë kohë, a e keni kuptuar që Kimete Krasniqi ishte
9 ushtarë brenda zonës operative të Drenicës; kështu e keni
10 kuptuar, apo jo?

11 PË. Po unë mendoj se ajo përderisa aty ka ardhur me ata edhe
12 është -- ma kanë prezantuar si ish-ushtarë, si ushtarë e
13 Drenicës edhe e kanë besuar sepse unë s'e kam njohur. Mirëpo
14 ishin ata që e kanë njohur, ata që e kanë sjellë.

15 PY. Kush kanë qenë personat që ju thoni jua kanë sjellë juve
16 atë? Kush ishin këta persona?

17 PY. Tani nuk më kujtohet më kush e ka sjellë, por e di që
18 dikush nga shtabi i Drenicës e ka sjellë. Nuk më kujtohen më
19 emrat e saktë. S'do ta kisha kujtuar ndoshta edhe Kimeten mos
20 të përflitej kaq shumë e kaq shpesh për të.

21 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do kërkoj që të
22 kalojmë në seancë private për mbrojtjen e palëve të treta për
23 ndoshta rreth pesë minuta.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë
25 në seancë private.

1 [Seancë private]

2 [Seancë private teksti i fshirë]

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5 [Seancë e hapur]

6 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
7 jemi në seancë të hapur.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
9 Mund të vazhdoni, z. Pace.

10 Z. PACE: [Përkthim] Dëshiroj që të paraqitet në ekran
11 dokumenti 123452 deri në 123453. Dua që të dyja faqet të jenë
12 përbri njëra-tjetrës; e para është në shqip dhe e dyta është
13 në anglisht. Faleminderit.

14 PY. Dëshmitar, në të majtë të ekranit kemi një dokument në
15 shqip.

16 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta zvogëlojmë pak në mënyrë të
17 tillë që mund ta shohim të plotë dokumentin.

18 PY. Ndërkohë që në të djathtë është në versionin në anglisht.
19 A e njihni dokumentin që keni në të majtë të ekranit që mban
20 datën 6 korrik 1999, Dëshmitar?

21 PË. Po.

22 PY. A e njihni nënshkrimin që është poshtë emrit tuaj? A
23 është nënshkrimi juaj ky, Dëshmitar?

24 PË. Po, ky është nënshkrimi im.

25 PY. A e njihni nënshkrimin që është poshtë emrit Isuf

1 Krasniqi dhe a është nënshkrimi i Isuf Krasniqit ky?

2 PË. Po, mendoj që ky është nënshkrimi i Isuf Krasniqit.

3 PY. Kush e ka shkruar këtë dokument?

4 PË. Unë mendoj që ka qenë një raport i Isuf Krasniqit që ose
5 ma ka rekomanduar mua ose që e kemi përpiluar bashkë. Por
6 përderisa qëndron emri i tij këtu mendoj se duhet ta kishte
7 iniciuar ai për mua. Po unë e pranoj se kjo ka qenë pjesë e
8 dokumenteve të mia; e pranoj që ky problem ka qenë apo kjo
9 çështje ka qenë çështje që jemi marrë edhe me këtë. Kështu që
10 e pranoj në tërësi këtë dokument.

11 PY. A mund të sqaroni se kush ka qenë eprori i ZKZ-së që ka
12 bërë kërkesën për angazhimin e Kimete Krasniqit në zonën
13 operative të Pashtrikut si PU e më pas është angazhuar në ZKZ
14 të ZOP-së? Kush është ky epror?

15 PË. Ju thashë pak më parë, në takimin e G2-shave të zonave
16 operative të Pashtrikut në tërë Kosovën, unë mund të kem
17 kërkuar ndihmë nga Drenica. Edhe kjo mund të sugjestoj se në
18 bazë të kërkesë së eprorit të ZKZ-së që jam unë, mirëpo unë
19 s'kam kërkuar të angazhohet personalisht ajo, por kam kërkuar
20 një ndihmë që ata e shohin të arsyeshme kë të ma dërgojnë e
21 unë këtë personin në fjalë nuk e kam njohur me emër e mbiemër
22 dhe personalisht.

23 PY. Në paragrafin e katërt të këtij dokumenti përmendet Sadik
24 Halitjaha që i jep Kimete Krasniqit mundësinë që të zgjedhë se
25 ku do të punojë dhe që ajo ka zgjedhur sektorin e ZKZ-së. Me

1 sa kujtoni ju, a është e saktë kjo?

2 PË. Po, unë mendoj se është shumë e saktë, sepse me ardhjen e
3 saj unë e kam informuar edhe Komandant Tahir Sinanin dhe
4 Komandant Sadik Halitjahën. I kam informuar edhe për arsyen
5 përse e kam ftuar një nga Drenica që të na ndihmojë edhe ata e
6 kanë pa të arsyeshme që ajo të qëndrojë në Prizren. Mirëpo
7 duhej të sistemohej dikun. Kështu që me propozimet e tyre i
8 kanë dhënë asaj me zgjedh ku ajo ka zgjedh.

9 Se ndoshta ne kemi pas mundësi ta rendisim te policia
10 ushtarake, mirëpo ajo andej e paska zgjedhur ZKZ-në edhe ka
11 qenë pjesë e saj. Ishte në interes tonin, ishte në interes
12 tonin edhe e kemi bërë këtë.

13 PY. Në paragrafin e pestë përmendët Ferati që sipas këtij
14 paragrafi Kimetja i referohet Feratit. Sipas jush, kush është
15 ky Ferati që përmendët te ky paragraf?

16 PË. Unë edhe javën e kaluar ju kam treguar se ky dokument
17 vjen me sugjerimin e zëvendësimit tim apo Isuf Krasniqit. Mirëpo
18 duke e parë se nga vjen personi në fjalë gjeografikisht besoj
19 që ka pas fjalën për Ferat Shalën se kanë qenë të dy të
20 angazhuar në një njësit, meqë të dy vijnë nga një fshat.

21 PY. A e dini se çfarë mosmarrëveshje kanë pas Kimete Krasniqi
22 dhe Ferat Shala, duke qenë që ka pas që -- thuhet këtu që ka
23 pas disa mosmarrëveshje midis të dyve? Për çfarë bëhet fjalë
24 këtu?

25 PË. Unë nuk e di mosmarrëveshjen e tyre as nuk kam mundur të

Dëshmitari: Halil Qadraku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 118

1 hyjë në ato -- se ato janë konë -- kanë qenë më shumë
2 privatësi e tyre.

3 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të
4 pranohet ky dokument si provë gjyqësore.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
6 kundërshtim?

7 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në këtë rast
8 nuk kam kundërshtim.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përderisa nuk
10 ka kundërshtim dokumenti 123452 deri në 123453 pranohet në
11 shqip dhe në anglisht.

12 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do t'i caktohet numri i
13 provës P01861, klasifikohet si konfidencial. Faleminderit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Pace, përpara sesa të
16 kërkon heqjen e dokumentit mbase e keni vënë re dhe vetë që
17 në versionin në anglisht nuk reflektohet data e raportit që
18 besoj që në shqip është 6 korrik 1999. Do ishte mirë që të na
19 jepnit një rishikim të përkthimit të këtij dokumenti. Pra, të
20 pasqyrohet data dhe në anglisht.

21 Z. PACE: [Përkthim] Po, patjetër do ta bëjmë këtë gjë.

22 Ta heqim këtë dokument nga ekрани dhe tani kërkoj që të
23 kaloj përsëri në seancë private për mbrojtjen e palëve të
24 treta.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar,

1 le të kalojmë në seancë private për mbrojtjen e dëshmitarit.

2 [Seancë private]

3 [Seancë private teksti i fshirë]

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Halil Qadraku (Seancë private)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 124

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24 [Seancë e hapur]

25 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë dhjetë
2 minuta pushim.

3 --- Seanca ndërpritet në orën 15.33

4 --- Seanca rifillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
6 uleni.

7 Ju lutem silleni dëshmitarin, ju lutem, në sallë.

8 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem, të kalojmë në seancë
9 private, për të njëjtat arsye që citova më përpara.

10 [Dëshmitari vijon dëshminë]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: Z. Qadraku, do të
12 vazhdojë Prokuroria me pyetjet. Dëgjojini me vëmendje.

13 Ndërkohë kalojmë në seancë private për mbrojtje të
14 dëshmitarit.

15 [Seancë private]

16 [Seancë private teksti i fshirë]

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11 [Seancë e hapur]

12 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

13 jemi në seancë publike.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

15 Vazhdoni, z. Paçe.

16 Z. PACE: [Përkthim] Heqim nga ekрани, ju lutem,

17 dokumentin dhe vendosim dokumentin me numër P01445 dhe P01445-

18 ET.

19 PY. Dëshmitar, në të majtë të ekranit është një dokument me

20 shkrim, dhe shkrim dore, dhe në të djathtë është i përkthyer

21 në anglisht.

22 Dokumenti në të majtë a është ai dokumenti që keni parë

23 ju në Gjilan gjatë një gjykimi, por që nuk e kishit lexuar

24 para gjyqimit? Ky dokument është?

25 PË. Po, ky dokument është.

1 PY. Shohim që në krye lexon: "Deklarate e Kimete Krasniqit"
2 dhe fjalia e fundit thotë:

3 "Por më pas u informova që ai ..." shohim paragrafin e
4 fundit:

5 "Sidoqoftë, ndonëse operacioni ishte i mirëpërgatitur dhe
6 ai mbërriti në kohë, dhe pavarësisht se u dhanë shumë armë
7 automatike dhe pati shumë plagë, personi me emrin Hamëz
8 Shtutica, ja doli që të arratisej. Kam dëgjuar më pas që ka
9 shkuar në Maqedoni rreth majit dhe se ishte rrëmbyer nga UÇK-
10 ja. Më pas u informova sërish se u lirua në qytezën e
11 Gllogovcit dhe se ky person ishte një rrezik për ne, sepse unë
12 e di -- sepse ai e dinte që unë kisha përgatitur aksionin
13 kundër tij. Për këtë arsye, unë nuk mund të veproja në këtë
14 zonë operative. Në zonën operative të Drenicës."

15 Dëshmitar, me sa keni ju dijeni, a mos është kjo
16 deklarata që i keni dhënë Tahir Sinanit, në një zarf, por të
17 cilën ju s'e kishit lexuar asnjëherë?

18 PË. Mund të jetë, se nuk e kam lexuar dhe nuk e dija, mirëpo
19 një e di, se Gjykata Ndërkombëtare e UNMIK-ut në Kosovë është
20 marrë edhe me këtë problem, është marrë edhe me Kimete
21 Krasniqin, është marrë edhe me njerëz që këtu janë të cekur,
22 dhe besoj që ju e keni më lehtë t'i merrni të gjitha aktet
23 përcjellëse të asaj Gjykatës dhe të njoftoheni, por mua ky
24 nivel, Kimete Krasniqi me Fehmi Lladrovcin, nuk më duket
25 niveli i njëjtë.

1 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Pace, a mund ta pyesni
3 dëshmitarin ta konfirmojë nëse Gllogovci është pjesë e zonës
4 operative të Drenicës?

5 Z. PACE: [Përkthim]

6 PY. Fillimisht, Dëshmitar, Gllogovci a ka ndonjë emër tjetër?

7 PË. Gllogovc, i kanë thënë në gjuhën serbe, kurse në gjuhën
8 shqipe, është Drenac. Është në zonën operative të Drenicës,
9 figuron në atë zonë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

11 Z. PACE: [Përkthim] Mund të hiqet dokumenti nga ekrani
12 dhe mund të vendosim në ekran materialin me numër P709, P709-
13 ET përbri. Mund ta zmadhojmë shqipen, që ta shohim faqen të
14 plotë ju lutem.

15 PY. Dëshmitar, dokumenti në të majtë në shqip, është një
16 dokument të cilin me njihni?

17 PË. Dokumenti në fjalë i përngjan atij dokumentit që e pamë
18 pak më parë, mirëpo ky mban datën e 19 gushtit të vitit 1999,
19 kurse ai e kishte 18 gushtit të vitit 1999. Domethënë, këto dy
20 njoftimet e njëjta, me të gjitha fjalët e njëjta, po
21 përsëriten në dy ditë vetëm që këtu ka edhe një shtojcë me
22 shkrimin me dorë dhe një vulë të zonës operative të
23 Pashtrikut. Ky dokument nuk më kujtohet mua, që ëh -- këto
24 shkronja poshtë nuk më kujtohen mua. A dokumentin pak më parë
25 e pranova që ishte i imi, komplet.

1 PY. Për ta sqaruar, kur thoni "nuk më kujtohet ky dokument",
2 e keni fjalën për dokumentin aktualisht në ekran?

3 PË. E ceka, shkrimi me dorë poshtë dokumentit tim për mua
4 është i panjohur.

5 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem, ta mbajmë dokumentin në
6 shqip në të majtë, dhe heqim përkthimin në anglisht, dhe të
7 vendosim dokumentin me numër 123451-1123451. Ju kërkoh ndjesë
8 se nuk e kam numrin e provës materiale.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, është
10 dokumenti me numër P01862.

11 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

12 PY. Dëshmitar, siç mund ta shihni te dokumenti në të djathtë
13 -- pra mund ta shihni në të majtë, është dokumenti që mban
14 numrin e provës gjyqësore P709. Në të djathtë është dokumenti
15 që ka marrë numrin e provës P10862 [Sipas përkthimit]. Ai më
16 të majtë ka datën 19 gusht, siç thatë edhe ju, ndërsa
17 dokumenti në të djathtë e ka datën 18 gusht.

18 Tani, me përjashtim të datës dhe të shënimeve me shkrim
19 dore në fund të faqes, a pajtoheni ju me mua që dokumenti ka
20 të njëjtat fjalë sa i takon, për shembull, termit "Njoftim
21 Zyrtar" dhe më pas dhe vendndodhja e dokumentit është e
22 ndryshme. E shihni këtë? Pajtoheni me mua?

23 PË. Po.

24 PY. Te paragrafi i dytë, në të dyja dokumentet dhe te
25 dokumenti në të majtë në shqip, shohim fjalën - ju kërkoh

1 ndjesë për shqiptimin paraprakisht, shoh fjalën "hakmarrjeje",
2 ndërsa në të djathtë, në vend të fjalës "hakmarrje", është
3 fjala "fatkeqësi". Ne e kemi të përkthyer sigurisht sipas
4 kuptimit që ka, dhe "hakmarrje" ka kuptimin e saj. Domethënë,
5 të dyja këto fjalët sigurisht që kanë kuptim të ndryshëm. A e
6 shihni ju këtë dallim?

7 PË. Po, e shoh këtë dallim, mirëpo prapë po ju them,
8 përmbajtja është e njëjtë, shkrimi është i njëjtë, veçse,
9 domethënë, dallojnë ndoshta në sfond ato-këto. Nuk di pse
10 duhet të krahasohen këto, por këto, shkrimi i dorës poshtë, që
11 shkruan, nuk më kujtohet mua. Kurse përmbajtja e njoftimit
12 zyrtar e krejt këto janë fjalët e njëjta. Janë të gjitha të
13 njëjta. Nuk e shof - më fal, nuk e shof edhe arsyen pse t'i
14 kem shkruar të dy raportet, me të njëjtat fjalë, me të njëjtën
15 përmbajtje, të njëjtëve njerëz iu kam drejtuar. Njëra mban
16 datën 18 nga një anë, njëra mban datën 19. Kjo më duket pakëz
17 pak e paarsyeshme për mua, se nuk kam pas nevojë të bëj këto,
18 as nuk kam ndryshuar gjë, kështu që mendoj se fjalët e mia
19 janë këto të shkruara me kompjuter.

20 PY. Për të qenë të qartë, Dëshmitar, a po thoni që fjalët në
21 kompjuter në të dyja dokumentet janë fjalët tuaja, apo po
22 thoni që janë vetëm fjalët tuaja ato në dokumentin që ka datën
23 18 gusht?

24 PË. Unë po them se të dy njoftimet, të dy faqet, fjalët e
25 shkruara me kompjuter janë të miat, janë të njëjta.

1 PY. E përmendëm që bëhet fjalë për një njoftim me shkrim dore
2 në dokumentin në të majtë, që është P0 -- 709 dhe gjithashtu
3 edhe vulën.

4 Z. PACE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit që ta
5 zmadhojë pak vulën.

6 PY. Së pari, Dëshmitar, a e njihni vulën këtu?

7 PË. Vula, edhe pse është pak e dukshme, por i përngjan vulës
8 së zonës së dytë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Ushtria
9 Çlirimtare e Kosovës, edhe nënshkrimi poshtë është i Tahir
10 Sinanit. Thotë "T. Sinani", por --

11 PY. A e njihni nënshkrimin e Tahir Sinanit? Këtë nënshkrimin
12 që është poshtë emrit?

13 PË. Po, mendoj se ky është nënshkrimi i Tahir Sinanit.

14 PY. Po shkrimi i dorës që thotë që:

15 "Të pranohet në detyrë vetëm pasi të ketë marrë urdhrin
16 me shkrim nga shef Luli."

17 Pyetja që kam për ju, Dëshmitar, është kjo: Kush është
18 shef Luli?

19 PË. Tani, unë këtë dokument për herë të parë e ka parë këtu,
20 para një jave. E di komandant Tahir Sinani ka qenë një njeri
21 që i ka ditur disa gjëra, domethënë, apo hierarkinë tonë
22 ushtarake, dhe besoj se edhe ai e ka dit se në këtë kohë, kur
23 është shkruar ky shkrim që i bie më 18 apo 19 gusht të vitit
24 1999, që i bie përafërsisht dy muaj pas luftës, unë besoj se
25 ai e ka ditur se shef Luli, shef Luli -- kjo me siguri që iu

1 ka adresuar Kadri Veslit me atë, mirëpo në atë kohë zotni
2 Kadri Veseli nuk ka qenë në G2-shin ushtarak. Aty në Shtabin e
3 Përgjithshëm e kemi pasur Fadil Kodrën, e jo --

4 Mirëpo tash krejt këto, ju e keni parë zotëri Gjykatës,
5 që shumë dokumente që mu më janë konfiskuar gjatë arrestimit
6 tim, shumë dokumente juve ju kanë ardhur këtu edhe nga Serbia.
7 Tashti, se si kanë shkuar nga Prizreni në Serbi, e nga Serbia
8 te kjo Gjykatë, unë nuk e di rrugëtimin. Mirëpo, kjo më lë të
9 dyshoj pak që dikush ka mundur të bëjë ndonjë [E pakuptueshme]
10 dhe ndonjë asojne, prandaj nuk e kuptoj dhe nuk e kam parë
11 këtë shkrimin me dorë që ai e ka shkruar këtu, por edhe po të
12 jetë ashtu, ndoshta nuk është, nuk besoj që ka diçka këtu
13 kontestuese.

14 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekрани.
15 PY. Tani do të kalojmë te një temë tjetër, Dëshmitar. A ju
16 kujtohet që jeni shfaqur në televizion në një emision me datën
17 11 prill të vitit 2023, dhe keni diskutuar çështje që kanë të
18 bëjnë luftën? Ju kujtohet kjo?

19 PË. Po, më kujtohet.

20 PY. A keni thënë të vërtetën sa i takon informacionit që keni
21 dhënë gjatë intervistës në këtë program?

22 PË. Gjithmonë gjatë jetës time jam munduar të flas të
23 vërtetën, sikur në shkrimet e rrjeteve sociale, sikur para
24 Gjykatës, gjykatave të ndryshme ku jam ballafaquar deri tani,
25 sikur sot që jam këtu para jush, unë mendoj se çdo herë, çdo

1 kund e kam folur të vërtetën.

2 Z. PACE: [Përkthim] Tani dëshiroj që t'i kërkoj
3 Sekretarit që të paraqesë në ekran dokumentin 113623-02. Kur
4 të shohim videon së bashku, do kërkoja që të fillohet që
5 transmetohet videoja nga minuta 32, sekonda 58, me zë. Është
6 videoja e cila mund të transmetohet për publikun, duhet ta
7 transmetoni deri në minutën 34, sekondën e 6. Transkriptimi në
8 shqip është dokumenti 113623-02-TR Revised. Dhe fillon nga
9 faqja 4, dhe do fillojmë që nga gazetari, deri te rreshti 4,
10 te faqja 5. Kjo është për përkthyesit.

11 Ndërkohë që kur të shfaqet videoja, do ndajmë me ju
12 ekranin në përkthimin në anglisht që është 113626-02-TR-ET e
13 rishikuar, dhe fillon nga faqja 4, duke filluar nga pjesa ku
14 thotë "Gazetari, në fakt..." dhe vazhdon më tej.

15 "Përshëndetje të nderuar sh..."

16 Për ta përsëritur, bëhet fjalë për minutën 34, sekonda e
17 6 deri në -- jo, minuta 32, sekonda 58, deri në minutën 34,
18 sekonda 6. Faleminderit. Sa i takon versionit në anglisht, na
19 duhet që të shkojmë te gjysma e dytë e faqes, këtu. Atëherë,
20 do ju kërkoja që të transmetohej video me zë, dhe më pas do
21 lexoj një pjesë të shkurtër nga transkriptimi në anglisht, në
22 mënyrë të tillë që atë çfarë ë -- ajo çfarë është thënë, të
23 jetë e qartë për të gjithë. Edhe një herë, do i kërkoja
24 Sekretarit që të përfundoni në minutën e 34.06.

25 [Luhet videoincizimi]

1 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Pra, sikurse e thashë,
2 do e lexoj përsëri nga anglishtja.

3 PY. Edhe një herë, mund të dëgjoni përkthimin në shqip.

4 "Gazetari: Por, në fakt kjo drejtësia që ju e konsideroni
5 si të padrejtë, ka filluar që të funksionojë. Ka një javë që
6 ka filluar gjykimi kundër ish-udhëheqësve kryesorë të UÇK-së.
7 Mbështetur në pozicionin që keni pasur ju, Kadri Veseli ka
8 qenë shefi juaj.

9 "Halil Qadraku: Po, deri më prill, kur ai është zgjedhur.

10 "Gazetari: Besoj se po ndiqni disa fotografi, që ju
11 tregojnë ju së bashku me z. Veseli gjatë luftës.

12 "Halil Qadraku: Po. Kjo është një fotografi që është bërë
13 në Nishor. Ka qenë marsi i vitit 1999.

14 "Gazetari: Ai...

15 "Halil Qadraku: Kur kemi pas biseda, që këtu përfshinin
16 nënshkrimin ose mos nënshkrimin e Marrëveshjes së Rambouillet.
17 Kadri Veseli është sipër, ngjitur me të është Mensur Zyberaj,
18 që është hero, nga Drenovci, Adem Grabovci është poshtë.

19 "Gazetari: Po."

20 Z. PACE: [Përkthim] Ndërkohë do i kërkoja Sekretarit që
21 të kalojë te faqja tjetër.

22 PY. "Halil Qadraku: Më poshtë është ky hoxha, ky profesori që
23 nuk më kujtohet emri.

24 "Gazetari: Dhe ju.

25 "Halil Qadraku: Po, edhe unë, sigurisht. Këtu kemi qenë

1 duke diskutuar për atë temë.

2 "Gazetari: Pra, temën në qoftë se duhej të nënshkruanit
3 apo jo."

4 Pyetja që kam për ju tani, Dëshmitar, është kjo: A është
5 kjo intervista që ju e keni dhënë në prill të vitit 2023, për
6 të cilën ju thatë që keni thënë të vërtetën?

7 PË. Po.

8 PY. A është e saktë ajo çfarë thatë në këtë pjesën që ju
9 lexova dhe që dëgjuat edhe vetë?

10 PË. Mendoj që po.

11 Z. PACE: [Përkthim] Në video, do i kërkoja Sekretarit që
12 të kalojmë në minutën 35:10. Thjesht të shikojmë pamjen nga
13 kjo minutë dhe kjo sekondë që sapo thashë.

14 PY. Dëshmitar, keni një fotografi këtu përpara. A është kjo
15 fotografia të cilën ju e përshkruat te pjesa që e dëgjuat me
16 audio më përpara, që ua lexuam edhe një herë në transkriptim,
17 në zbardhje? Për këtë fotografi komentuat?

18 PË. Po, për këtë fotografi komentova.

19 Z. PACE: [Përkthim] Në video, le të kalojmë te minuta
20 36:00 dhe do kërkoja që të transmetohej deri në minutën 36:18.
21 Përsëri, nuk do të paraqes në ekran transkriptimin në shqip,
22 por për përkthyesit, ne do të lexojmë nga faqja 6, rreshtat
23 nga 13 deri në 15. Ndërkohë që nuk kemi numra, por përkthimin
24 në anglisht dua që të vazhdojmë që të qëndrojmë në faqen 6,
25 dhe bëhet fjalë për rreshtat 17 dhe 19, në mes të faqes.

1 Edhe një herë, pasi ta dëgjojmë, do ua lexoj edhe një
2 herë tekstin, në mënyrë të tillë që të gjitha palët ta kenë të
3 qartë.

4 [Luhet videoincizimi]

5 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

6 PY. Atëherë, në këtë pjesë ju thoni:

7 "Halil Qadraku: Hashim Thaçi është gjigand. Hashim Thaçi,
8 nëse ka zot nalt për Kosovën, ai është poshtë, çfarëdo që të
9 thonë njerëzit për ta ulur atë. Po të mos të kishte qenë për
10 Hashim Thaçin, ajo çfarë i ka ndodhur Kosovës sot, nuk kishte
11 ndodhur fare."

12 A mund t'i shpjegoni Gjykatëseve, Dëshmitar, se çfarë ju
13 ka shtyrë, ose çfarë ju ka bërë ju ta thoni këtë gjë për
14 Hashim Thaçin?

15 PË. Po. Unë edhe atëherë edhe që 25 vite mendoj se Hashim
16 Thaçi është i tillë. Kosova e jonë, shteti jonë, që me
17 mileniume jemi të okupuar, që 3000 vjet, dhe gjithmonë ka pas
18 luftëtarë, kurrë Kosova nuk ka pasur mangët luftëtarë për të
19 luftuar për atdhe. Por gjithmonë kemi -- lufta e fundit --
20 lufta e fundit, unë mendoj që është, ka qenë shumë e
21 mirëorientuar falë politikave, falë drejtimit politik që ka
22 dit ta udhëheqë kjo strukturë politike, në krye me Hashim
23 Thaçin dhe ata shokët të tjerë që kanë qenë jashtë, si Xhavit
24 Haliti, si Bardhyl Mahmuti, si -- i kam përmendur disa.
25 Prandaj mendoj se në kurorëzimin e çlirimit të Kosovës më

1 shumë ka ndikuar drejtimi politik, marrëveshjet politike me
2 NATO-n, me të gjitha mekanizmat ndërkombëtarë. Ne e dimë se
3 asnjë shtet nuk është çliruar pa aleatë, kështu që edhe ne nuk
4 do të ishim në mundësi ta fitonim luftën pa aleatë. Mirëpo, në
5 atë drejtim mendoj se Hashim Thaçi e ka meritat më të mëdha,
6 edhe unë e falënderoj në emër tim dhe të familjes time, një
7 herë, dhe të popullit, për atë punë që ka bërë, sepse ishte
8 një punë gjigante.

9 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam edhe një
10 fragment tjetër nga e njëjta intervistë që do të doja që ta
11 transmetoja për Dëshmitarin, por kjo do më çonte diçka tjetër.
12 dhe duke e lënë këtë mënjane, dua që të bëj një kërkesë, dhe e
13 kam kaluar atë kohën që kam kërkuar, katër orë. Nëse më
14 lejoni, do kërkoja që ta zgjas me një orë nesër marrjen në
15 pyetje të këtij dëshmitari, sepse nuk kam përfunduar ende me
16 pyetjet për të.

17 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E miratojmë
19 kërkesën për kohë shtesë për një orë nesër.

20 Z. PACE: [Përkthim] Do mundohem që të jem më i shkurtër
21 se sa kaq. Megjithatë, mendoj që do ishte mirë që të
22 përfundojmë sot. Do vazhdojmë me videon nesër.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përfunduar
24 këtu me dëshminë tuaj, Dëshmitar, për sot. Shpresoj që t'ia
25 kaloni mirë pasditen dhe mbrëmjen. Duhet që të ktheheni

1 përsëri këtu nesër në mëngjes në orën 09.00.

2 Faleminderit që ishit me ne sot dhe shihemi nesër bashkë.
3 Mund të dilni bashkë me Sekretarin.

4 Faleminderit, gjithashtu, edhe ju z. Koçi.

5 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
7 gjë tjetër përpara se sa të mbyllim për sot.

8 Atëherë përderisa nuk ka ndonjë gjë për të thënë, do e
9 mbyllim sot këtu dhe fillojmë përsëri nesër në orën 09.00.

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të gjithë në këmbë.

11 --- Seanca mbyllet në orën 16.27

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25